

# Organizohu! Kundërshtu! Tejkalo

paradigmat



Ky botim u publikua në kuadër të “Kartës për qytetet inteligjente II”, e organizuar nga Fondacioni European i të Gjelbërve (GEF) me mbështetjen e Rrjetit për Bashkëpunim e Zhvillim të Europës Lindore (CDN) dhe Organizata e të Gjelbërve të Majtë<sup>1</sup>

Sqarim: Këto shkrime pasqyrojnë mendimet e autorëve individualë dhe/ose të intervistuarëve, dhe jo domosdoshmërisht atë të GEF dhe CDN.

Fondacioni i Gjelbër European (GEF) është një fondacion politik në nivel European, misioni i të cilit është të ndihmojë për një sferë debati të gjallë europian dhe të nxisë përfshirje më të madhe të qytetarëve në politikat europiane. GEF përpiqet të përfshijë diskutimet kryesore mbi politikat dhe politikën europiane si brenda ashtu edhe përtej familjes së politikës së Gjelbër. Fondacioni vepron si një laborator për ide të reja, ofron edukim politik ndërkufitar dhe një platformë për bashkëpunim dhe shkëmbim në nivel European.

Fondacioni i Gjelbër European Rue du Fossé – 1536 Luxembourg  
Zyrat në Bruksel: Mundo Madou – Avenue des Arts 7-8, 1210  
Bruksel Tel: +32 2 329 00 50  
E-mail: [info@gef.eu](mailto:info@gef.eu)  
Faqja e internetit: [www.gef.eu](http://www.gef.eu)  
Mund të porosisni kopje të publikimit duke dërguar një e-mail tek: [info@gef.eu](mailto:info@gef.eu)

Ekipi organizator i projektit:  
Bianca Creutz, Justine Pantelejeva, Erisa Nesimi, Hanna Pischyk, Luka Gudek dhe Masha Pashkova-Dzneladze

Ekipi i redaksionit:  
Hanna Pischyk, Luka Gudek, Elena Petrovska dhe Masha Pashkova-Dzneladze

Koordinatorë e Projektit të GEF: Sien Hasker

Dizajner: Haris Begic

**Organizohu!  
Kundërshto!  
Tejkalo paradigmata!**



WETENSCHAPPELIJK  
BUREAU GROENLINKS

Bureau de Helling  
Democracy Development Abroad

Botuar në Beograd, në Dhjetor 2020

<sup>1</sup> Wetenschappelijk Bureau Groen Links

# TRYEZA E

Hyrje.....	1
Manifestoja e qyteteve digjitale të Europës Lindore .....	3
Qeverisja e një qyteti inteligjent .....	11
Përfshirja në qytetet inteligjente .....	16
Kriza e COVID dhe digjitalizimi .....	27
Realiteti virtual për qytetin inteligjent.....	36
Duke përparuar drejt arritjes së barazisë digjitale dhe përfshirjes në qytetet inteligjente: Rasti i portalit qeveritar e-Albania.....	49

# LËNDËS

Mendimi Praktik .....	55
Transport inteligjent për një qytet inteligjent.....	81
Pyetësi për qytetet inteligjente.....	89
Si mund të organizohemi përreth një qyteti inteligjent? .....	95
PËRMBAJTJA E SESIONEVE.....	102
Kuiz- Sa inteligjent është qyteti juaj? .....	157

# Hyrje

I dashur lexues,

Tendencat e popullsisë globale tregojnë se njerzit po migrojnë shumë e më shumë drejt hapësirave urbane, duke i kthyer qytetet në qendra të grumbullimeve multikulturale, aktiviteti ekonomik, dhe të risive politike. Këto qytete në rritje janë gjithashtu vende të zbatimit të shumë teknologjive të reja. Premtimi i këtyre teknologjive të reja digjitale është rritja ekonomike, evolucioni i demokracisë dhe një standard më i mirë i të jetuarit. Në fakt, shumë qytete po përpiqen të përshtasin identitetin e një qyteti inteligjent<sup>2</sup> për të treguar zotësinë e tyre në përdorimin e teknologjive që mund të trajtojnë trendet sfiduese të shekullit të 21.

Gjithsesi, qëllimet e qeverive lokale për zbatimin e këtyre teknologjive në qytet e tyre janë të ndryshme. Në kontekste tejet politike, ku demokracia nuk është shumë e zhvilluar dhe elitat e korruptuara sundojnë nëpërmjet metodave autoritare, vlerat pas zbatimit të teknologjisë digjitale në këto qytete janë tjetërsuar për të promovuar interesa të caktuara, më shumë sesa interesa publikë. Prandaj, ne, të rinjtë e Gjelbër të Europës Lindore jemi mbledhur për të denoncuar praktikën e dëmshme që po zbatohen dhe për të rimenduar konceptin e qyteteve inteligjente nga një këndvështrim i gjelbër në kontekstin e Europës Lindore.

Për ta arritur këtë, ne organizuam projektin: Tejkalmi i paradigmeve: zbatimi i teknologjive të reja në qytete<sup>3</sup>. Ky projekt ishte planifikuar të zbatohet në Riga të Letonisë në Maj 2020, por, si rrjedhojë e rrethanëve sfiduese të krijuara nga pandemia globale, ky format u përshtat në mënyrë që projekti të mund të zhvillohet krejtësisht nëpërmjet internetit.

Si pjesë e këtij formati të ri, ekipi organizator ka regjistruar një podcast që prezanton qytetin digjital nëpërmjet këndvështrimeve të ndryshme të dy qytetarëve mbi qytetin e tyre inteligjent, dhe dy seminare në internet mbi "Përfshirjen dhe të drejtat e qytetarëve"<sup>4</sup>, dhe mbi "Sistemin e pikëzimit të qytetarëve"<sup>5</sup>

Ky publikim është hapi i fundit i këtij projekti, dhe përmbledh produktet politike, teorike dhe praktike të këtij projekti. Më specifikisht, është një përmbledhje e manifestos së qyteteve inteligjente të Europës Lindore, intervista me ekspertë, artikuj mbi aspekte të ndryshme të qytetit inteligjent, kuize dhe këshilla fushate për t'u organizuar mbi çështjet e qyteteve inteligjente.

Ky projekt ndërtohet mbi punë të mëparshme të CDN dhe Fondacionit European të të Gjelbërve në një projekt ndërkombëtar i quajtur "Te rinjtë dhe qyteti-të rinjtë për qytete të gjelbra e të drejta"<sup>6</sup>, si dhe projekti ndërkombëtar Karta e qyteteve Inteligjente<sup>6</sup>. Ky projekt po zbatohet si pjesë e Një kartë për qytetet inteligjente II, e organizuar nga Fondacionit European i të Gjelbërve me mbështetjen e CDN and Organizatës të të Gjelbërve të Majtë.

Shpresojmë së ky publikim do t'ju pëlqejë dhe do të mund ta përdorni për të mësuar mbi qytetet inteligjente me këndvështrimin e qyteteve të Europës Lindore, të kënaqeni gjatë rrugës, dhe të ndiheni mjaftueshëm të fuqizuar për të promovuar zgjidhje vendimtare për zbatimin e qyteteve inteligjente në qytetin tuaj!

Ekipi i redaksionit,  
Elena, Hanna, Luka and Masha

1 <sup>2</sup> Smart city  
<sup>3</sup> Outsmarting the paradigm: Implementation of new technologies in cities


<sup>4</sup> Inclusion and Citizen rights  
<sup>5</sup> Citizen Scoring  
<sup>6</sup> A Charter for a Smart City

## Manifestoja e qyteteve digjitale të Europës Lindore

Ne, të rinjtë e qyteteve të Europës Lindore vëmë re se teknologjitë digjitale po bëhen një veçori e rëndësishme e qyteteve tona, dhe përqafojmë mundësitë e tyre transformuese ndaj mjediseve tona urbane. Ne e pranojmë se zbatimi i teknologjive të reja në qytetet tona mund të jetë i dobishëm nëse drejtohet në përmirësimin e jetës së të gjithëve në qytete. Sidoqoftë, ne jemi të shqetësuar se për momentin, digjitalizimi dhe teknologjitë po përdoren për të rritur më tej pabarazinë, racizmin, burokracinë, korrupsionin, krizën klimaterike e sociale, nën pretendimin e narrativave të zhvillimit neoliberal. Ne duam t'i japim fund këtij lloj abuzimi të teknologjive të reja dhe të marrim zotërimin për zbatimin e tyre transparent në qytetet tona, duke bërë të mundur që ato të përdoren për të arritur vlerat e gjelbra.

### Ekonomia digjitale

Aktualisht, qytetet po japin subvencione të konsiderueshme tak-sash, duke rimenduar hapësirat urbane, dhe duke marrë kredi për të siguruar infrastrukturë për bizneset e reja të bazuara në teknologji me shpresë se ato do të sjellin zhvillim ekonomik dhe rritje të punësimit. Sidoqoftë, këto lloj praktikash mund të krijojnë fenomenin e garës deri në fund<sup>7</sup> mes qyteteve, dhe t'i bëjë qytetet të varura nga korporatat e mëdha dhe kërcënimet e tyre për të zhvendosur veprimtarinë e tyre diku tjetër. Për më tepër, pavarësisht përpjekjes për të treguar një pamje miqësore ndaj publikut, këto korporata kanë treguar se janë tepër armiqësore ndaj sindikatave të punëtorëve, shpesh duke i ndaluar ato, si dhe duke patur një normë të madhe lëvizjeje të fuqisë së tyre



punëtore. Edhe kur këto kompani sigurojnë zhvillim ekonomik, gjë e cila nuk është e lidhur me mirëqënien e përgjithshme ekonomike të pjesës më të madhe, kjo është e bazuar në ekstraktimin e metaleve të çmuara dhe konsumit të lartë të energjisë, gjë e cila është veçanërisht problematike në shtetet e Europës Lindore të cilat janë ende në pjesën më të madhe të varura nga lëndët djegëse, si dhe në varësinë nga trendet ekonomike globale.

Kur këto të fundit shkojnë për keq, si në rastin e pandemisë COVID19, të parët që ndikohen janë punëtorët dhe familjet e tyre. Prandaj, korporatat teknologjike shumëkombëshe shpesh i mbajnë selitë e tyre qendrore në vendet e tyre të origjinës, ndërsa industrinë prodhuese dhe sektorin e mbështetjes ndaj klientit e transferojnë në vendet e Europës Lindore, duke përfituar nga standardet e tyre të ulëta të punës dhe duke e lënë forcën punëtore të kualifikuar të këtyre shteteve vetëm me zgjedhjen e emigrimit në vendet e pasura.

Ne kërkojmë rregullim në nivel European të kompanive të teknologjisë për të ndaluar konkurrimin mes qyteteve. Ne kërkojmë ndalimin e vëzhgimit në nivele ekstreme që i shtyn punonjësit për të patur efikasitet maksimal duke patur një ndikim negativ në shëndetin e tyre mendor. Ne kërkojmë që kompanitë teknologjike të detyrohen të krijojnë më shumë punë të qëndrueshme të cilat krijojnë vlera për komunitetin lokal urban në të cilin janë të bazuara. Ne kërkojmë një ndalim të narrativave neoliberalë të lidhura me zbatimin e rritjes ekonomike, të cilat shtyjnë rritjen ekonomike me çdo çmim, si dhe konsumerizmin ekstrem. Në vend të kësaj ne duam të bëjmë trysni për standarde më të larta në ligjet e punës dhe zbatimin e tyre në mënyrë që të krijojmë kushte të përshtatshme pune, të qëndrueshme, si shoqërore dhe mjedisore.

Ekonomia e re digjitale në qytetet tona duhet të sigurojë përfitime të qarta për të gjithë qytetarët. Përfitimet që u jepen kompanive të teknologjisë, duhet gjithashtu t'i detyrojnë këto kompani të ndihmojnë në uljen e pabarazive dhe promovimin e një standardi më të mirë të jetesës në qytete në një mënyrë më gjithëpërfshirëse, duke përfshirë dialogun me qeveritë vendore dhe organizatat e qytetarëve.

Ata duhet të marrin përgjegjësinë për ndikimin që shkaktojnë mjedis dhe të investojnë në projekte për qëndrueshmëri, duke përfshirë ruajtjen e energjisë, prodhimin e energjisë së rinovueshme dhe një përdorim të kursyer, qarkullues të metaleve dhe materialeve të tjera.

### Mjedisi dhe teknologjitë

Teksa zhytemi më thellë në krizën klimaterike, ekonomia liberale po përpiqet të përshtatet, në vend që të ndryshojë. Kjo po krijon një zgjidhje false të ekonomisë së "gjelbër" dhe teknologjisë së "gjelbër" që më shumë sesa të japë zgjidhje, shmang hapat re-

aliste të klimës dhe vazhdon qasjen ekzistuese të konsumit e cila nuk është e realizueshme për të ardhmen. Ne kërkojmë që teknologjitë e reja dhe inovacioni të përdoren për të arritur në mënyrë sistematike qëllimet tona klimatike. Ndryshimi i klimës nuk mund të trajtohet pa ristrukturuar ekonominë tonë, prandaj ne kërkojmë që teknologjia e gjelbër të mos përdoret për të avancuar konsumin. Teknologjia e gjelbër duhet të na ndihmojë të zvogëlojmë emetimet e gazeve serrë, të nxisim demokracinë, dhe të zvogëlojmë pabarazitë sociale dhe ekonomike. Qyteti ynë inteligjent nuk duhet të bëhet lufta civile apo katastrofa mjedisore e dikujt tjetër.

Ne duhet të ndalojmë narrativat e automjeteve autonome, elektrike dhe / ose private si një zgjidhje për ndikimin mjedisor të një qyteti. Këto mjete transporti janë individualiste, dhe bazuar në konsum, rrisin nevojën për zona të asfaltuara, rrisin temperaturën e qyteteve dhe prodhojnë rezultate negative mjedisore në vendet ku minohet litium, kobalt dhe metale të tjera të nevojshme.



Ne duam që bashkitë të bëjnë proceset e instalimit të zgjidhjeve të reja energjetike që janë me kosto efikase dhe zgjidhje alternative të energjisë miqësore me mjedisin më të zakonshme. Siç përshkruhet në Kartën për Qytetin Inteligjent, gjenerimi lokal i energjisë së rinovueshme ofron një mundësi unike për të krijuar bashkësi të reja. Panelet diellore kolektive, pompa nxehtësie të lagjes, bateri kolektive, dhe rrjetet zgjuara të shpërndara, të menaxhuara nga kompanitë energjitike mund të përshpejtojnë tranzicionin e energjisë, të demokratizojë sistemin e energjisë, të krijojë lidhje të reja mes komshinjve, dhe të parandalojë të dhënat e ndjeshme të përdorimit të energjisë nga banesat të bjerë në duart e korporatave energjitike të mëdha. Kooperativat energjitike të rinovueshme meritojnë mbështetje bashkiake.

### **Përfshirja digjitale dhe sociale**

Në ditët e sotme, ne shohim zbatimin e teknologjive të reja digjitale në qytetet e Evropës Qëndrore dhe Lindore si përqendrim të hierarkive të pushtetit si dhe shkak për përjashtimin e grupeve më të prekshme nga jeta shoqërore. Zbatimi i teknologjive të reja është i prirur të mbahet në zonat e pasura dhe të dukshme të qytetit dhe aksesit ndaj tyre është shpesh i rezervuar vetëm për individët më të pasur dhe më të privilegjuar. Për më tepër, zhvillimi i lagjeve të reja të “qyteteve të zgjuara” nuk duhet të kthehet thjesht në një mënyrë për të privatizuar tokë, dhe një mënyrë që të gjenfriktojë më tej pjesë të qyteteve tona. Ne duhet të bëjmë të mundur që hapësirat publike në qytetet tona të qendrojnë të tilla. Zbatimi i teknologjive të reja duhet bërë në një mënyrë që të barazojë standardet e jetesës së pjesëve të ndryshme të qytetit.

Zbatimi i mjeteve të reja digjitale në qeveritë vendore, pa një pamje të qartë se sa kjo është miqësore për përdoruesit e të gjitha grupeve në shoqëri, mund të çojë në përjashtimin e të moshuarve, emigrantëve, njerëzve me aftësi ndryshe dhe grupeve të tjera të cënueshme. Zbatimi i këtyre llojve teknologjive pa konsulta dhe studime të gjera publike mund të rezultojë në krijimin e deficiteve demokratike në një qytet, dhe për këtë arsye, këto lloj praktikash duhet të shmangen.

Prokurimi i teknologjive digjitale duhet bërë në një mënyrë transparente, duke lejuar tendera publikë të drejtë dhe objektivë, si dhe debat mes qytetarëve për sa i përket përfitimeve të një teknologjie të caktuar. Të dhënat e mbledhura prej këtyre teknologjive duhet të qëndrojnë në duart e publikut dhe transferimi në kompani private duhet të jetë transparent dhe për interesin e publikut, si dhe të bazohet në kushte të qarta. Ne kërkojmë që dobitë e zbatimit të teknologjive të reja t'i komunikohet qartësisht publikut, që avantazhet të jenë të gatshme dhe të aksesueshme nga të gjithë në qytet, dhe në tërë zonat e qytetit, në vend se të mbahet në duart e grupeve më të pasura.

### **Pjesëmarrja digjitale**

Mjetet digjitale mund të forcojnë demokracinë në mënyra të shumta, nga lehtësimi i aksesit në informacionin e sektorit publik e deri në zgjerimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Platformat digjitale dhe mediat sociale paraqesin një forum për debat publik dhe për kontakt mes zgjedhësve dhe të zgjedhurit. Ka shumë shembuj të mirë, veçanërisht në nivel vendor, të politikanëve të cilët jo vetëm japin, por edhe marrin. Ata i përgjigjen pyetjeve në internet, japin llogari për vendimet e tyre, dhe mbledhin ide, siç është e përshkruar edhe në Kartën e Qyteteve Inteligjente.

Ne duam që qytetet në Europën Lindore të garantojnë edukim digjital të lirë dhe të aksesueshëm, dhe t'i pajisë qytetarët me njohuritë sesi të përdorë çfarëdolloj mjet digjital të ri në dispozicion të bashkive. Digjitalizimi dhe transformimi digjital duhet të kthehet në një forcë fuqizuese për të gjithë qytetarët që të bëjnë qytetet inteligjente më demokratike.

Aktualisht, shumë qytete të Europës Lindore përdorin mjete digjitale të pjesëmarrjes të arritshme vetëm për individët që mund të blejnë pajisjet e tyre dhe kanë njohuri teknike dhe ligjore për t'u përfshirë në debat. Ne duam që qeveritë lokale të sigurojnë që mjetet digjitale po përdoren për të ndihmuar të gjithë palët e interesuara për të pasur një bisedë më të mirë në debatet publike për sa i përket projekteve të ardhshme në lidhje me ndërhyrjet e planifikuara dhe që procesi i pjesëmarrjes në projektim të jetë më gjithëpërfshirës, i zhdërvjellët, dhe i hapur. Kjo duhet të realizohet duke i bërë këto mjete digjitale të disponueshme në hapësira publike siç janë bibliotekat, me zyrtarë të ngarkuar për të lehtësuar pjesëmarrjen e qytetarëve.



**I N T E R**

**V I S T A T**

## QEVERISJA E NJË QYTETI INTELIGJENT

nga Luka Gudek

Rishtazi, është vënë re së qeverisja e qytetit inteligjent është një çështje tejet e spikatur në debatin publik. Kjo temë mund të sjellë së bashku qasjet ekonomike, sociale, politike, dhe mjedisore në analizimin e qyteteve inteligjente në një metodë kuptimplotë. Në këtë intervistë do të diskutojmë çështjet kryesore të qeverisjes së qyteteve inteligjente me Giorgia Nesti, një asistent-profesore në universitetin e Padovas, autore që ka publikuar në botimin më të fundit special të Rishikimit të menaxhimit publik<sup>8</sup>, mbi menaxhimin, qeverisjen dhe përgjegjësinë për qytetet dhe komunitetet inteligjente. Puna e saj kërkimore aktuale është në fushën e qyteteve inteligjente si një mënyrë e re për të imagjinuar qeverisjen lokale dhe politikëbërjen përmes ideve dhe mjeteve inovative.


*Çfarë e bën një qytet inteligjent të suksesshëm sot, dhe a ka ndryshuar ky koncept që kur koncepti doli për herë të parë?*

Në ditët e sotme, një qytet i suksesshëm inteligjent është një qytet që promovon jo vetëm qëndrueshmërinë dhe përshtatjen e teknologjive në vetvete, por disi më shumë, rezistencën dhe një përdorim të përgjegjshëm të teknologjive për qytetarët. Kur diskutimi për qytetet inteligjente u shfaq për herë të parë në diskutimet e politikave, vëmendje e veçantë iu kushtua kapacitetit të “inteligjencës”, për të nxitur zhvillimin ekonomik, duke lënë pas dore aspekte të tjera vendimtare si për shembull pabarazitë sociale e digjitale. Ky diskutim, për mendimin tim, hapi rrugën ndaj

një “veprimtarie kontradiktore” si për shembull krijimin e qyteteve utopike ose gara teknologjike që ka filluar mes disa bashkive. Më parë, shumë prej kryetarëve të bashkive e shihnin TIK (teknologjia e informacionit e komunikimit) si një qëllim në vetvete, dhe jo si mjet për të arritur diçka tjetër. Tashmë, shumica e kryetarëve të bashkive po përshtasin një qasje pak më të kujdesshme, dhe koncepti i qyteteve inteligjente është përqëndruar sërish ndaj nevojave të qytetarëve.

*Koncepti i qyteteve inteligjente paraqitet shpesh si një mënyrë për t’iu qasur një sërë problemesh “të çuditshme”<sup>10</sup>, që qeveritë lokale po përpiqen të zgjidhin. A kanë teknologjitë e qyteteve inteligjente vërtet potencialin për të rajtuar këto çështje dhe a ka shembuj konkretë të kësaj nga Europa?*

Po, qytetet inteligjente kanë potencialin për të trajtuar një sërë problemesh “të çuditshme”, si për shembull, ndryshimet klimaterike, rimëkëmbja ekonomike, pabarazitë, dhe probleme të përgjithshme politikash të lidhura me levizshmërinë e qëndrueshme, dhe e-qeverisja si rrjedhojë e qasjes gjithëpërfshirëse



të qeverisjes që duhet të nxisin. Gjithashtu, emergjenca e Koronavirusit mund të përfitojë prej qasjes së qytetit inteligjent-mendonit për shembull për potencialin e Datave të Mëdha<sup>11</sup>, Intelligjencës Artificiale, Interneti i Gjërave (IoT)<sup>12</sup> dhe TIK (teknologjia informacionit e komunikimit) në mbështetjen e parandalimit të sëmundjeve. Por thelbi, gjithsesi, është si të projektosh dhe zbatosh këtë lloj qasjeje në mënyrë që të jetë e dobishme për qytetarët, në njërin anë, dhe në anën tjetër të jetë e realizueshme për administratën publike. Kjo është tejet sfiduese, sepse administrata publike është një strukturë e ndërlikuar dhe shpesh nuk ka burime të mjaftueshme politike, dhe/ose aftësi për t'i bërë ballë risive në nivel qendror. Ekzistojnë disa shembuj të mirë qytetesh të cilat po shkojnë në këtë drejtim, si për shembull Barcelona, Viena, dhe Milano në Europë si edhe Boston në SHBA.

*Në shkrimin tënd mbi natyrën shndërruese të qeverisjes së qyteteve zgjuara, ti ke shkruar mbi si qeverisja inteligjente duket në qytete të ndryshme. Pse është i rëndësishëm përdorimi i koncepteve të qeverisjes inteligjente dhe qeverisjes së qyteteve inteligjente? A është mënyra sesi qytetet zhvillojnë modelet e tyre inteligjente një proces politik?*

Për mendimin tim, koncepti i qeverisjes është thelbësor. Qasja inteligjente është e dobishme vetëm nëse zgjidh probleme dhe prodhon vlera publike. Kjo do të thotë se, qyteti inteligjent duhet të nxitet dhe drejtohet nga publiku. Administrate vendore (politikanët dhe nënpunësit civil) duhet të orientojnë procesin dhe duhet të jenë përgjegjës për zgjedhjet që kanë bërë – në këtë mënyrë zhvillimi i një modeli të qeverisjes inteligjente është pa dyshim një proces politik. Aktorë të tjerë – si për shembull aktorë privatë, qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, dhe/ose qendrat kërkimore – mund të marrin pjesë në zhvillimin e strategjive inteligjente por përkufizimi i synimit dhe i rezultateve të pritshme në terma të vlerave publike që një qytet inteligjent duhet të arrijë janë një përgjegjësi politike.

*A i ndryshon zbatimi i teknologjive inteligjente dinamikat e qyteteve, apo a i përforcon dinamikat ekzistuese?*



Kjo varet nga mënyra si strategjia e një qyteti inteligjent është përkufizuar dhe zbatuar. Kjo problematikë ka disa aspekte. Së pari, detyrimisht, teknologjitë inteligjente krijojnë pabarazi ashtu si çdo teknologji. Ndarja digjitale, mungesa e aftësive digjitale, mungesa e infrastrukturës janë pengesa tashmë të ditura për aksesin në teknologji, gjë e cila krijon pabarazi. Këto pabarazi mbivendosen me pabarazitë ekzistuese ekonomike, sociale e gjinore dhe pengojnë qytetarët që të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga qyteti inteligjent. Së dyti, qeverisja inteligjente duhet të promovojë pjesëmarrjen, por nëse nuk ka një strategji ose vullnet të qartë për përfshirjen e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në procesin qeverisës – veçanërisht grupet shoqërore të marginalizuara – ekziston rreziku se pjesëmarrja i jepet vetëm të njëjtëve individë, “anëtarë të grupeve shoqërore me më shumë mundësi”.

*A promovon shembulli i qeverisjes së qyteteve inteligjente vlera të caktuara, dhe a ndryshojnë ato nga qyteti në qytet, apo janë të njëjta?*

Literatura mbi qeverisjen e qytetit inteligjent na thotë se duhet të promovojë qëndrueshmërinë, zhvillimin ekonomik, risitë, dhe mirëqenien. Por, çdo qytet inteligjent përqëndrohet më shumë në një aspekt të caktuar sesa të gjithë në tërësi. Pjesa më e madhe e qyteteve inteligjente ende vendos vëmendje të madhe mbi çështjet si zvogëlimi i përdorimit të energjisë, promovimi i e-mobilitetit, ose mbështetja ndaj bizneseve. Tashmë, vlera të tjera publike si përfshirja, pjesëmarrja, fuqizimi, të drejtat digjitale, dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (SDGs) janë në programin e qytetit inteligjent.

*Disa strategji të qyteteve zgjuara si për shembull Strategjia Digjitale e Mançesterit paraqet balancën gjinore si një objektivi që duhet trajtuar. A janë përfshirë në mënyrë të kënaqshme çështjet e barazisë gjinore në debatin akademik mbi qeverisjen dhe strategjitë e qyteteve inteligjente? Cilat janë ndryshimet që duhen përfshirë në modelet qeverisëse për të trajtuar këtë*

Fatkeqësisht, ky nuk është rasti. Pabarazitë gjinore nuk janë trajtuar mjaftueshëm nga qytetet inteligjente pasi ligjërimi (ose retorika) që i rrethon është e verbër ndaj gjinisë – TIK dhe objektivat inteligjentë janë menduar si asnjëanëse për çështjet gjinore. E kam përmendur këtë çështje edhe në një artikull që kam shkruar. Për ta çuar debatin më tej, në qeverisjen e qyteteve inteligjente duhet të zbatohet një qasje e integritetit gjinor: na nevojiten mjete, të dhëna, aftësi, dhe procese të afta për të mbështetur politikë-bërësit në promovimin e mundësive të njëjta dhe përhapjen e një mendësie të re.

## PËRFSHIRJA NË QYTETET INTELIGJENTE


*Nga Hanna Pischyk*

Ekziston një rrjet kompleks dimensionesh që e bëjnë një qytet “inteligjent”, p.sh. mjedis inteligjent, mobiliteti dhe ekonomia inteligjente, që sigurojnë zgjidhje të qëndrueshme, të arritshme, dhe efikase ndaj qytetarëve, që lehtësojnë jetën e tyre. Një përberës po aq i rëndësishëm është dimensionin njerëzor, që nënkupton krijimin një qytet që nxit përfshirjen, përqafon shumëllojshmërinë, dhe siguron që të gjitha grupet kanë mundësinë të përfshihen dhe t’i japin formë qytetit. Kjo çështje është veçanërisht e vërtetë për komunitetin LGBT+, të cilët janë shpesh të lënë pas dore në procesin e zhvillimit urban.

Ne këtë pjesë do të diskutojmë këtë çështje me përfaqësues të dy organizatave që punojnë në fushën e përfshirjes së komunitetit LGBT+ përkatësisht në nivele kombëtare e ndërkombëtare: Danilova, drejtoresha ekzekutive e qendrës së informacionit GENDERDOC-M dhe Manuel Rosas Vázquez, koordinatori i Rrjetit të Qyteteve të Ylberit<sup>13</sup>).

Manuel Rosas Vázquez është koordinatori në Rrjetin e Qyteteve të Ylberit<sup>14</sup>. Në këtë kapacitet, ai punon me bordin drejtues për të vendosur strategjinë dhe drejtimin e rrjetit. Menaxhon marrëdhëniet me anëtarët tanë dhe organet e tjera ndërkombëtare, dhe përfaqëson rrjetin në platformat të ndryshme në të gjithë botën. Ai është një specialist në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe strategji politikave LGBT+. Ai ka një master në Politikën Publike.

Anastasia Danilova është Drejtore Ekzekutive e Qendrës së Informacionit GENDERDOC-M, me vendndodhje në Kishinau, Moldavi. Para se të bëhej Drejtore Ekzekutive në Prill 2010, ajo ishte koordinatore e Programit të Grave GENDERDOC-M. Ajo ishte gjithashtu e përfshirë si vullnetare në botimin e një reviste për lezbiket, Theme. Ajo ndau historinë e saj personale dhe motivi anëtarët e tjerë të komunitetit për të mbrojtur të drejtat e tyre në shoqërinë homofobe të Moldavisë. Anastasia është një nga të paktët njerëz të hapur LGBT + në Moldavi që përfaqëson GENDERDOC-M në të dy nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare, flet publikisht për çështjet LGBT + dhe organizon aktivitete publike përfshirë marshimet e Krenarisë<sup>15</sup>.



*Na flit pak për organizatën tuaj. Me çfarë merreni?*

Anastasia Danilova: Qendra e informacionit „GENDERDOC-M“ është OJQ-ja e vetme që promovon në mënyrë të vazhdueshme të drejtat e komunitetit LGBT në Moldavi. GENDERDOC-M ka ndërmarrë më shumë se 50 projekte në nivele të ndryshme për të rritur ndërgjegjësimin publik mbi orientimin seksual dhe identitetin gjinor, duke lobuar në institucionet shtetërore e organizatat ndërkombëtare për interesat e të drejtat e LGBT. Qendra jonë gjithashtu synon të parandalojë HIV/AIDS dhe SST-të, duke promovuar një jetë të shëndetshme, duke ofruar ndihmë ligjore e psikologjike si dhe grupe mbështetjeje (për individë transgjinorë, individë homoseksualë zeropozitivë, individë homoseksualë në moshë, të afërm të komunitetit LGBT), si dhe udhëheqja e aktiviteteve me grupe profesionistë si për shembull psikologë, sociologë, gazetarë, policë dhe doktorë.


Manuel Rosas Vázquez: Unë do doja të filloja duke vënë në pah se njerëzimi është i larmishëm, kompleks, dhe shumëngjyrësh, ndërsa identiteti, kultura dhe shprehitë tona janë të gërshetuara në mënyrë të ndërlikuar në qenien tonë. Kjo larmi duhet të ngjallë krenari dhe dashuri dhe jo të jetë shkak për të qënë të frikësuar dhe ta fshehim këtë. Por, komuniteti LGBT nëpër botë ende përballet me stigmatizim, diskriminim, përjashtime, dhe në raste edhe më të skajshme, dhunë. Rrjeti i Qyteteve të Ylberit dhe 33 anëtarët e saj punojnë për të siguruar të drejtat seksuale të çdo individit, me ndihmën e risive në politika publike në qytetet e tyre përkatëse, të cilat nxisin individë të komunitetit LGBT të gëzojnë seksualitetin e tyre dhe të ushtrojnë kontroll mbi trupin e tyre. Rrjeti i Qyteteve të Ylberit është në jetë që prej 2012, fillimisht si një rrjet informal i subvencionuar nga qeveria hollandeze. Sidoqoftë, subvencionimi përfundoi në 2018 dhe anëtarët vendosën të mbajnë këtë rrjet të mrekullshëm dhe në korrik të 2019 RCN-ja u regjistrua në Amsterdam si një organizatë jo fitim-prurëse.

*Manuel, si mund një qytet të bëhet anëtar i këtij rrjeti? Dhe cilat janë mundësitë që kjo anëtarësi krijon për një qytet?*

Bashkitë, rajonet, qytetet e vogla e të mëdha që praktikojnë politika aktive të përfshirjes së komunitetit LGBT në administratën e tyre vendore mund të bëhen anëtare të organizatës tonë. Për sa i përket rregulloreve tona, të gjithë qytetet e interesuara duhet të dërgojnë një aplikim, i cili përbëhet nga një marrëveshje bashkëpunimi e shoqëruar prej dy të ashtuquajtura nje-fletëshe. Njëra prej këtyre fletëve duhet të përshkruajë politikën LGBTI të qytetit dhe tjetra duhet të përmbajë tri praktika të mira të ndërmarra nga qyteti në të njëjtin vit që bëhet aplikimi. Me miratimin e aplikimit nga të gjithë anëtarët, qyteti kandidat duhet të paguajë dhe tarifën vjetore. Mundësitë janë të pafundme, bashkëpunime mes anëtarësh, aktivitete e organizime të përbashkëta, si dhe kontributi në publikimin vjetor të praktikave të mira.

*Përse është përfshirja e komunitetit LGBT+ kyçe për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e qytetit?*

Manuel Rosas Vázquez: Qytetarët e komunitetit LGBTI+ janë pjesë tërësore e çdo shoqërie. Si pasojë, shoqëritë modern dhe qytetet e suksesshme nuk mund të përfytyrohen pa përfshirjen e plotë të individëve LGBTI. Ekzistojnë shembuj që tregojnë se qytetet gjithëpërfshirës tërheqin njerëz të talentuar dhe disa prej këtyre njerëzve të talentuar mund të marrin në konsideratë të migrojnë drejt qyteteve që mirëpresin në mënyrë të hapur dhe të qartë individë prej komunitetit LGBTI. Kjo i bën qytetet edhe më konkurruese. Së fundmi, organizata e hapur për biznes<sup>16</sup> ka publikuar një studim që tregon një renditje të qyteteve që janë konkurruese në nivel botëror dhe jam i lumtur të ndaj me ju se ndër këto qytete, nëntë prej tyre janë në rrjetin tonë, Amsterdami, Berlina, Parisi, Barcelona, Frankfurti, Hamburgu, Mynihu, Qyteti i Meksikos, dhe San Paolo.



Anastasia Danilova: Pjesëmarrje e të gjithë qytetarëve në zhvillimin e infrastrukturës së qytetit është element kyç, pasi larmishmëria ndihmon në marrjen e vendimeve që janë të përshtatshme për të gjithë banorët e qytetit dhe e bën atë një hapësirë ku të gjithë ndihen të sigurt e të përfshirë

*Si mundet që planifikimi urban të ndikojë në bërjen e qyteteve më të sigurt dhe gjithëpërfshirëse për njerëzit e diskriminuar prej seksualitetit të tyre?*

Manuel Rosas Vázquez: Përreth gjithë botës dhe në Europë, individët LGBTI përbëjnë një numër të konsiderueshëm të të varfërve, gratë transgjimore dhe meshkujt homoseksualë ende përfaqësojnë numrin më të madh të individëve në komunitetin tonë që jetojnë me HIV, gjë e cila mund të sjellë zhvillimin e simptomave të renda për shkak të COVID19. Për këtë arsye, qeveritë vendore duhet të trajtojnë këtë problem nëpërmjet një qasjeje ndër-sektoriale dhe planifikimi urban luan një rol të rëndësishëm për të parandaluar izolimin e këtij komuniteti në strategjitë për ndërtimin e qyteteve.

*Anastasia, organizata jote ndërvepron në nivel kombëtar. Cilat janë sfidat kryesore me të cilat ju përballeni në punën tuaj komunitare dhe të përkrahjes??*

Komuniteti LGBT në Moldavi përballlet me një sërë pengesash. Pikë së pari, mungesa e tolerancës dhe nivelet tejet të larta të homofobisë, transfobia, dhe bifobia në shoqëri. Si rrjedhojë, shumë individë LGBT, veçanërisht nga zonat rurale, kanë frikë të shprehin orientimin e tyre seksual ose identitetin gjinor, si dhe të bëjnë kallëzim në polici apo të ndërmarrin çfarëdo veprimi ligjor kur përballen me abuzime. Njëkohësisht, krimet ndaj individëve të komunitetit LGBT nuk njihen si krime urretjeje. Një tjetër problem me të cilin ne përballemi është gjuha e urretjes dhe retorika diskriminuese e përdorur nga politikanët lokalë, kishat, si dhe figurat publike. Në krye të kësaj vihet re një mungesë e qartë e përkufizimeve ligjore të gjinisë në nivel shtetëror.

Një ndër çështjet më shqetësuese të lidhura me komunitetin LGBT në rajonin tonë (Europa qendrore dhe lindore) mund të jetë përndjekja dhe keqtrajtimi nga policia. Çfarë roli mund të luajë bashkëpunimi mes agjencive të zbatimit të ligjit dhe komunitetit LGBT në përmirësimin e sigurisë së tyre në hapësirat publike dhe trajtimin e krimeve dhe diskriminimit të nxitur nga urrejtja ndaj komunitetit LGBT?

Anastasia Danilova: Krimet e urrejtjes ndaj individëve LGBT nuk njihen si të tilla, dhe policia i përkufizon si huliganizëm, vjedhje, apo agresion/mësymbje. Ka edhe raste përpjekjesh për zhvatje nga oficerët e policisë, të cilët zhvasin para prej individëve homoseksualë gjatë grumbullimeve që ata kryejnë, në shkëmbim që të mos zbulojnë orientimin e tyre seksual. Për më tepër, ka edhe raste të ditura, kur policia refuzon të hartojë raportë të kallëzimeve në rastet kur viktimat janë individë të komunitetit LGBT, ndërsa mënyra sesi oficerët e policisë trajtojnë individët LGBT përfshin fyerjet dhe trajtimin përçmues. Në rastet kur vihemi në dijeni për këto raste, ne regjistrojmë një ankesë në Ministrinë e Brendshme. Ndërkaq, duke qënë se policia është e vetëdijshme për ekzistencën e organizatës sonë, qëndrimi ndaj individëve LGBT të cilët kontaktojnë policinë ndryshon përnjëherë kur përmendet „GENDERDOC-M” ose kur punonjësit tanë ofrojnë ndihmë. Njëkohësisht, çdo vit policia mbron pjesëmarrësit e aktiviteteve publike LGBT, nuk pengon mbarëvajtjen e këtyre aktiviteteve, si edhe i trajton organizatorët me respekt.



*Kush janë aktorët kryesorë në bërjen e qyteteve më të hapura e mikpritëse ndaj njerëzve me seksualitet të ndryshëm?*

Manuel Rosas Vázquez: Në fakt, kjo është një pyetje me përgjigje të shumta, dhe gjithashtu varet kë pyet. Por, ajo çka nuk mund të mohohet është nevoja e pjesëmarrjes mbizotëruese të administratës lokale për të njohur plotësisht popullatën e tyre LGBTI dhe të parandalojë diskriminimin në hapësira publike.

*Cila është eksperiencia jote e bashkëpunimit me autoritetet publike? A mendoni se ekzistenca e një plani veprimi në nivel shtetëror për çështjet LGBT është e rëndësishme?*

Anastasia Danilova: Bashkëpunimi me autoritetet publike është qartësisht i rëndësishëm, duke qënë se OJQ-të nuk mund të sjellin ndryshime thelbësore në mënyrë të vetme, veçanërisht kur bëhet fjalë për të informuar popullatën dhe të përfshijnë çështjet e LGBT në fushën e arsimimit. Për fat të keq, në kontekstin tonë, na mungon angazhimi politik, duke qënë se shumë politikanë përfitojnë prej çështjeve LGBT si një mjet manipulues në ligjëratën publike, gjë e cila i ndihmon të marrin vota. Organizata jonë ka një bashkëpunim të mirënjohur me Ministrinë e Shëndetësisë në çështjet e shëndetit, dhe parandalimit të HIV dhe sëmundjeve të tjera seksualisht të transmetueshme. Ministria e Punëve të Brendshme është gjithashtu deri diku një institucion partner. Për shembull, ne bashkëpunojmë në fushën e mbrojtjes së të drejtës së marshimit të LGBT dhe me pjesëmarrjen e policisë në programet tona të trajnimit mbi SOGI (Orientimi Seksual dhe Identiteti Gjiner<sup>17</sup>). Megjithatë, edukimi i policisë ende nuk është përhapur gjerësisht, dhe as nuk është qëndëruar. Sot e kësaj dite, ky institucion mbetet ende homofobik dhe transfobik. Për më tepër, shpesh, anëtarët e këtij institucioni janë burim diskriminimi dhe shantazhi.



*Cilat janë hapat e para që administrata e qytetit dhe politikë-bërësit mund/duhet të ndërmarrin për të mbështetur barazinë LGBT+?*

Manuel Rosas Vázquez: Kjo është po ashtu një pyetje tejet komplekse, por do të thoja se qytetet që janë të interesuara të bëjnë përpara në njohjen e plotë, dhe parandalimin e diskriminimit ndaj komunitetit LGBT duhet pikësisht të kenë vullnetin politik, e ndjekur nga trajnime në tematika të LGBTI të punonjësve të ndihmës së shpejtë, si departamenti i policisë, zjarrfikësit, si dhe personeli shëndetësor. Gjithashtu, duhet të dekretohen politika në administratën lokale për të zhvilluar programe dhe për të bërë punë me grupe lokale LGBTI.

*Cilat mund të jenë disa prej strategjive që OJQ-të dhe këshillat bashkiakë mund të ndjekin për të promovuar përfshirjen e LGBT në komunitetet e tyre?*

Anastasia Danilova: Unë mendoj se pasja e mbështetësve në këshillat bashkiakë, të cilët mund të ndryshojnë qasjen ndaj këtij problemi dhe mund të përfshijnë grupe të ndryshme në vendim-

marrje, duke përfshirë individë të komunitetit LGBT, është thelbësisht e rëndësishme. Sipas mendimit tim, kjo është ndër strategjitë më efikase dhe të fuqishme për momentin, sepse në Moldavi, ashtu si dhe në shumë shtete të tjera të Europës Qendrore dhe Lindore, ky process është ende në hapat fillestarë.

*Cili është roli i teknologjisë në mbështetjen e diversitetit dhe nxirjes së përfshirjes së komunitetit LGBT+?*

Manuel Rosas Vázquez: Teknologjia është një aleat për komunitetin tonë, e veçanërisht mjetet e teknologjisë së informacionit. Nëpërmjet këtyre mjeteve, komuniteti ynë është i aftë të shprehë nevojat në anonimitet absolut që në shumë raste është tejet i rëndësishëm, pasi disa prej anëtarëve të komunitetit tonë, për fat të keq, ende duhet të fshihen. Ka shumë shembuj në Europë ku pyetësorët në internet kanë ndihmuar organizatat vendore, rajonale dhe ndërkombëtare të hartëzojnë nevojat e individëve të komunitetit LGBTI për t'u përballur me jetën e përditshme. Për shembull, Agjencia e Bashkimit Europian për Të Drejtat Thelbësore<sup>18</sup> shpalli rezultatet e pyetësorit më të madh të ndërmarrë në Europë për komunitetin LGBT. Këto rezultate sugjerojnë se në vitet e fundit ka patur shumë pak progres. Për shembull, shumë çifte të të njëjtit seks raportojnë se ata janë ende të frikësuar të mbajnë duart në publik. 40 përqind e të intervistuarëve kanë përjetuar persekutim, dhe shkalla e diskriminimit në hapësirat publike si shkollat, kafenetë, dhe klubet e natës mbetet e lartë. Komuniteti transgjinnor është grupi që përjeton diskriminimin më të rëndë, veçanërisht kur bëhet fjalë për identifikimin e dokumenteve dhe aksesit ndaj shërbimeve publike.

*Cili është vizioni juaj për përfshirjen e komunitetit LGBT+ në qytetet e Europës Qendrore dhe Lindore? Cilat janë sfidat kryesore dhe mundësitë që ju shihni?*


Anastasia Danilova: Do të reflektoj mbi këto pyetje bazuar në eksperiencën tonë në Moldavi. Kur flasim për sfidat kryesore,



pikësëpari, për momentin është e pamundur të ndërtohet bashkëpunim efikas mes këshillave bashkiak për shkak të nivelit të tyre të lartë të homofobisë dhe transfobisë. Edhe përdorimi i simbolit të ylberit sjell reagime negative. Për shembull, një prej anëtarëve të këshillit bashkiak të partisë socialiste bëri kërkesë për të ndaluar përdorimin e ylberëve në qytet, duke e konsideruar atë si një kërcënim. Në kryeqytet nuk ka hapësira LGBT si për shembull bare, klube nate apo kafene, e jo më në qytete të tjera. Të gjitha përpjekjet për të hapur vende të tilla kanë dështuar pasi nuk ishin fitimprurëse. Prandaj, e vetmja gjë që mund të bëjmë është të marrim me qira hapësira të tilla për të mbajtur aktivitete për komunitetin LGBT. Sfida të tjera të cilat i kam përmendur edhe më parë, janë mungesa e qytetarëve të hapur ndaj LGBT si dhe përjashtimi i këtij komuniteti nga hapësirat publike. Nëse do flasim për mundësitë, një prej mundësive më të spikatura është të punosh individualisht me anëtarë të këshillave bashkiakë të cilët janë aleatë të fortë të komunitetit LGBT të cilët janë aleatë të komunitetit LGBT ose që janë vetë pjesë e komunitetit. Megjithatë, siç thashë edhe më parë, kjo është thjesht një fazë fillestare. Njëkohësisht, solidariteti, bashkëpunimi, dhe zbatimi i aktiviteteve të përbashkëta në probleme që prekin gjithësecilin si për shembull mjedisi, aksesueshmëria, mobiliteti, menaxhimi i mbetjeve, etj. është një ndër mënyrat për të ushqyer një qasje pozitive ndaj individëve të komunitetit LGBT, sepse ata nuk janë thjesht përfaqësues të këtij komuniteti, por edhe qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm.

Manuel Rosas Vázquez: Shtetet dhe qytete e Europës Qëndrore dhe Lindore duhet të njohin, mbrojnë, dhe të luftojnë diskriminimin ndaj komunitetit LGBTI në territoret e tyre, jo vetëm sepse kjo është gjëja e duhur për t'u bërë, por sepse ata kanë përgjegjësinë morale për të siguruar dhe mbrojtur të drejtat njerëzore ndaj të gjithë qytetarëve të tyre. Sfida kryesore është edukimi dhe sigurimi i informacionit të saktë ndaj qytetarëve që janë kundër, për të njohur plotësisht të drejtat themelore të komunitetit LGBTI. Unë kam besimin se qytetarët e Europës Qëndrore

dhe Lindore janë të gatshëm të mësojnë dhe bashkëpunojnë me pjesën tjetër të Europës në mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTI dhe shembulli i kësaj është fakti që ne kemi Lublanën si shtet themelues të rrjetit tonë dhe së fundmi Kotorri i Malit të Zi iu bashkua këtij rrjeti. Kjo është një shenjë e qartë se më shumë njerëz në rajon kërkojnë drejtësi sociale dhe të drejta të barabarta për të gjithë.



## KRIZA E COVID DHE DIGJITALIZIMI

Josef Šmida është një profesionist në fushën e përfshirjes sociale dhe të drejtave të njeriut për më shumë se një dekadë. Në katër vitet e fundit, ai ka ndërthurur digjitalizimin dhe dimensionin social, veçanërisht në drejtim të përjashtimit dhe arsimimit digjital. Aktualisht, ai punon në teknologjinë civile, të dhëna të hapura dhe të drejtën e informacionit në epokën digjitale në OSF Pragë. Ai është një anëtar i Partisë së Gjelbër Çeke prej tetëmbëdhjetë vitesh dhe një anëtar i Koordinimit Global të Gjelbërt për mandatin e dytë. Ne biseduam me Josef rreth digjitalizimit, pandemisë dhe mënyrës se si teknologjia ndikon në jetën dhe qytetet tona

*Na trego për veten dhe punën tënde si aktivist*

Emri im është Josef Smida, jam nga Praga në Republikën Çeke. Në këtë moment po punoj në fondacionin Shoqëria e Hapur<sup>19</sup> në Pragë dhe ministrinë e Çështjeve Sociale e të Punës. Unë punoj më të drejtat njerëzore dhe përfshirjen sociale. Tani, po ndërthur këto tema me digjitalizimin. Unë punoj me projekte në këtë fondacion në Pragë që trajton transparencën dhe të drejtën e informacionit në epokën digjitale; po punoj për të dhënat e hapura dhe teknologjitë civile, duke qënë se në mbështesim sektorin e OJQ-ve. Nga ana tjetër, në Ministri unë punoj me një projekt që zhvillon koordinimin me bazë në komunitet me anë të një qasjeje ndërdisiplinore. Po operon në 4 rajone, në Republikën Çeke dhe në të gjithë ata që janë në periferi dhe kanë vështirësi strukturore. Nëse flasim për të gjelbërit, unë jam anëtar i partisë së gjelbër çeke që në 2002. Kam punuar si kryetar i sektorit të ekspertizës së të drejtave njerëzore kur ishim në qeveri. Jam po ashtu anëtar i koordinimit të të Gjelbërve Globalë, si përfaqësues i EGP<sup>20</sup>. Kam qënë gjithashtu aktiv me të rinjtë e gjelbër, si më të rinjtë e gjelbër çekë, ashtu dhe me FYEG<sup>21</sup>.



*A mund të na tregoni më shumë për projektet tuaja në fondacionin Shoqëria e Hapur që trajtojnë digjitalizimin dhe komunitetet vendase?*

Projekti titullohet “Shteti yne, të dhënat tona”. Aspekti kryesor është transparenca e të dhënave të shtetit dhe e drejta ndaj informacionit. Projekti është tashmë 10-vjeçar. Ne po përpiqemi të shtyjme institucionet shtetërore për të hapur të dhënat. Mund të jenë të dhëna meteorologjike, si për shembull Instituti Çek i Meteorologjisë që ishte shumë i mbyllur për të marrë të dhëna të bollshme të parashikimeve të motit. Në rast se ndokush do të pësonte dëme si pasojë e motit të keq, ata duhet të viheshin në kontakt me kompanitë e sigurimeve për t’i provuar së ishte si pasojë e shkaqeve natyrore, dhe si pasojë duhet të siguronin të dhëna nga ky institucion. Por, mund të merrje këto të dhëna vetëm nëse do të paguaje për to. Po ashtu, institti kishte një listë çmimesh për këto të dhëna. Institucionet e financuara nga shteti, me para të taksapaguesve duhet të kenë akses të hapur për të gjithë të dhënat. Vitin e shkuar ky institucion më në fund u hap. Ne mbështesim gjithashtu organizatat që përpiqen të bëjnë publike të dhënat për fushën e tyre të ekspertizës. Jo vetëm që po shtyjme për hapjen e të dhënave, por përpiqemi gjithashtu të lidhim shtetin, bizneset, dhe OJQ-të. Ne përpiqemi

ta bëjmë këtë sepse nuk ka një hapësirë ku ata të mund të takohen dhe të bashkëbisedojnë sesi mund të bëjnë informacionin më të aksesueshëm. Po diskutohet edhe mbi çfarë informacioni bëhet fjalë, për kë, në çfarë formati duhet hapur – është një process dhe dialog i gjatë mes palëve të ndryshme. Kështu që ne organizojmë aktivitete, ku ata të mund të takohen, të njihen se kush bën çfarë dhe për kë. Une po organizoj një ekspozitë të të dhënave të hapura, që është aktiviteti më i madh i të dhënave të hapura në të gjithë vendin. Vitin e kaluar ne patëm një folës kryesor – Jan Phillip Albrecht nga të Gjëlbrit Gjermanë, kështu që unë përpiqem gjithashtu t'i bëj aktivitetet edhe më të gjelbra. Ne po japim gjithashtu çmime për aplikacionin më të mirë të ndërtuar. Këtë vit ne mbështetëm ide nga sektori i OJQ-ve duke përdorur teknologjinë digjitale për të arritur këtë qëllim, p.sh. si të shpërndajmë më mirë vaktet e pangrëna, të cilat janë të shumta në restorante. Përfytyro, ka teknologji që lejojnë të shpërndajnë ushqimin në azile dhe tek njerëzit e pastrehë, ose për qëllime të caktuara të shërbimeve sociale. Ne po përpiqemi gjithashtu të zhvillojmë një program pak më të gjerë për të mbështetur gjithashtu sektorin e OJQ-ve dhe digjitalizimin e punëve të tyre.

*Po për sa i përket punës tuaj me të rinjtë?*

Një prej partnerëve më të rëndësishëm që kemi është Cesko Digital (Republika Çeke Digjitale) – 3000 komunitete vullnetarësh nga sektori i TIK<sup>22</sup>. Njerëzit janë të përfshirë në mënyra të ndryshme dhe ne si OS (Open Society) Pragë jemi aty që prej fillimit.. Ne kemi ndihmuar për ta themeluar dhe për t'i dhënë një drejtim dhe jemi duke bashkëpunuar me ta që prej asaj kohe. Ne bëjmë disa gjëra që janë planifikuar, por ka edhe bashkëpunim të zhdërvjellët. Thelbi është që ne përpiqemi t'i japim komunitetit ekspert të TIK një depërtim mbi sektorin e OJQ, duke qënë se duan të punojnë me OJQ-të dhe shoqërinë civile. Nëse flasim për arsimimin dhe pandeminë, ky ishte një moment historik për Cesko Digital. Deri atëherë, ekzistonte vetëm një grup i mbyllur i ekspertëve të TIK që po përpiqen të ndihmojnë botën, por gjithsesi nuk e dijnë tamam ku të fillojnë. Gjithashtu, shoqëria

nuk po i kuptonte nevojat e tyre. Pandemia tregoi sesa shumë ata ia kanë nevojën infrastrukturës në internet – kur vjen puna te shkollat, institucionet publike ose OJQ-të. Papritmas, kushdo pati nevojë për mbështetje IT<sup>23</sup>. Fusha e edukimit pati nevojën më të madhe dhe më të paparashikuar. Shkollat dhe familjet në përgjithësi nuk ishin gati për këtë gjë. Ekzistonte një rrezik i madh që familjet me më pak aftësi të zhvilluara IT dhe të ardhura të ndryshme do të kenë hendeqet më të mëdha në arsimim. Ky projekt u dorëzoi atyre pajisje në shkolla, të mbledhura nga kompani të ndryshme dhe donatorë, dyqane elektronike, të gjithë kishin të paktën dhjetë kompjutera për të dhënë për këtë qëllim. Një tjetër gjë ishte mbështetja metodologjike. Të kesh një kompjuter nuk është e mjaftueshme dhe shumë shkolla – ash-



tu si stafi dhe studentët patën probleme për të përdorur mjetet në internet. Ekziston një ekip i veçantë në Cesko Digital që ndihmon dhe trajnon njerëzit në përdorimin e GSuite, ekipeve të Microsoft, Zoom etj. ashtu si edhe më shumë trajnime të përparuara në rast se ka nevojë. Së treti, ekziston dimension i përfshirjes sociale; ne ishim të vetëdijshëm se ka shkolla që janë më gati dhe nuk kanë nevojë për ndonjë ndihmë nga ne. Ato kanë dhe burime të tjera për të marrë ndihmë. Por, në Republikën Çeke ka ende shkolla që janë të ndara, p.sh. shkollat të komunitetit Rom në lokalitetet e përjashtuara sociale. Është një problem afatgjatë, por përgjatë kësaj pandemie ata ishin një ndër grupet shoqërore më të prekura në këto shkolla. Nuk ka të bëjë vetëm me cilësinë e shkollave por edhe mjedisin, ku fëmijët rriten. Edukimi në distancë i shpërngulur në shtëpitë e tyre nuk nënkupton që ata/ato do të ndjekin mësimin duke qënë se mjedisi dhe shtëpia në vetvete mund të mos i ofrojë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në distancë, p.sh. fëmijët mund të kenë pesë motra/vëllezër, plus prindërit, gjyshërit, ose dikush tjetër që jeton me ta. Në rast se janë shtatë njerëz që jetojnë në të njëjtën shtëpi, zakonisht në kushte tepër të këqija, arsimimi në distancë thjesht nuk do të funksionojë. Është shumë e vështirë të sigurosh akses të barabartë në arsimim, edhe nëse ka burime për edukimin digjital. Kjo është një sfidë që duhet zgjidhur në të ardhmen. Kur flasim për arsimim, duhet të flasim gjithashtu për standardet e strehimit.

Cesko Digital bëri edhe një tjetër projekt interesant, Rmap që siguroi informacion të qartë se ku njerëzit mund të marrin maska dhe aparate frymëmarrjeje. Në fillim të pandemisë, tregu për maska ishte tërësisht bosh, nuk mund të blije asnjë maskë. Ekzistonte një valë solidariteti kryesisht prej grave që bënë maska dhe aplikimi tregonte ku ndodhen maskat më të afërta. Mund të marrësh një maskë shumë shpejt, falas. Papritmas u shfaqën vende që shisnin maska dhe pjesë makinerie. Ishte një projekt emergjent dhe tashmë është mbyllur, pasi fitoi shumë çmime.

Ka edhe shumë projekte të tjera që përpiqen të ndihmojnë OJQ-të, si p.sh. projekte civile teknologjike me *Transparency International*, që jep informacione për politikanët. Mund të kërkosh çfarëdo niveli politikani dhe të marrësh informacion bazik mbi ta, si dhe të dhëna financiare, kush i mbështet financiarisht, aktivitetet, etj. Ky projekt është në zhvillim e sipër dhe po përmirësohet dita ditës.

Një tjetër projekt ndihmon bashkitë të paraqesin pasqyra të qarta të buxhetimit. Është një mjet në internet me të dhëna të hapura dhe jep një pasqyrë të situatës financiare. Çdo gjë që është e shkruar në fa-

tura, është e shkruar në këtë portal. Funksionon si shërbim për qytetarët. Mund të shohësh sa shumë bashkia po shpenzon për çfarë. Është gjithashtu gjë e mirë për udhëheqjen e bashkisë sepse qytetarët do të kenë një pasqyrë të qartë të sesi bashkia po përdor paratë. Tani ka dhjetë bashki në Republikën Çeke që mund ta përdorin. Quhet citivizor.

Ka shumë projekte për të cilat mund të flas – mbi median, transparencën dhe digjitalizimin, por të drejtat sociale, ekonomike e kulturore të lidhura me këto projekte nuk janë shumë dhe kjo është diçka që dua të hap për diskutim. Në përgjithësi, këto të drejta janë ende jo aq të mbrojtura, si në Republikën Çeke dhe në rajonin tonë – Europa Lindore. Po ashtu, ato dhe nuk kuptohen në gjerësi, jo të gjithë do të bien dakord mbi kuptimet e termave. Është një proces shumë i ngadaltë dhe nëse të dhënat e hapura janë qartësisht të lidhura me të drejtat civile si për shembull aksesin ndaj informacionit, arsimimi, strehimi, ose shëndeti, si dhe pandemia në terma të përgjithshëm, është tashmë shumë më e lidhur me të drejtat sociale, kulturore e ekonomike. Dhe shpresoj se kjo është e ardhmja e këtij projekti.



Vitin e shkuar tek Ekspoja e hapur, tema kryesore ishte kriza klimaterike. Ne donim të tregonim se ekziston një problem i madh – ndryshimet klimaterike që prekin të gjitha të drejtat. Vitin tjetër, nëse pandemia e lejon, tema kryesore do të jetë shëndeti. Por, kjo s’do të thotë se ekspoja ka një temë të ngushtë. Duhet të trajtohet edukimin, të drejtën e informacionit, politikën, tregun e punës, strehimin dhe shumë të tjera. Shumë e më shumë njerëz në Republikën Çeke, dhe jo vetëm, po kuptojnë këtë krizë ekonomike e sociale. E gjithë kjo është tashmë sfiduese, ashtu si shmangia e të quajturit “komunist” ose “shumë të majtë”, por fatkeqësisht në Europën Lindore është ende shumë e vështirë për të dalë nga kjo flluskë sapuni.

*Po, duket sikur është mallkim i përjetshëm të të duhet të shpjegosh çfarë është socializmi në të vërtetë dhe si socializmi i vërtetë, ose politikat e majta duhet të funksionojnë. Është po ashtu goxha e frikshme si sektori i kulturës po shtypet tani. Ju uroj fat në projektet e ardhshme.*

*Na tregoni për punën tuaj në ministrinë e Çështjeve Sociale dhe cili është projekti që trajton zonat më pak të zhvilluara në pjesën perëndimore të Republikës Çeke.*

Kjo është krejtësisht jashtë temave të digjitalizimit, trajton përfshirjen sociale në një kuptim më të gjerë. Ky projekt financohet nga BE dhe në njëfarë mënyre është i pavarur nga struktura e ministrisë. Është një projekt që po zhvillohet jashtë ministrisë. Këto katër rajone janë më pak të privileguara në kuptimin e zhvillimit por kanë shumë mundësi për të tejkaluar këto sfida. Ne po zbatojmë koordinim me bazë komunitare. Ka katër koordinatore komuniteti që krijojnë një rrjet të njerëzve dhe institucioneve aktive. Është po ashtu një ekip multidisiplinor: arkeologë, historianë, arkitektë, antropologjistë socialë, gjeo-botanistë, njerëz që mund të ndihmojnë zhvillimin lokal duke dhënë ekspertizë. Le të themi, nëse je kryetar i një fshati, edhe nëse do të bësh një



ndryshim, ndihesh disi vetëm duke qënë se shteti dhe bashkia rrallë herë ndihmojnë. Institucionet rajonale nuk janë tamam të arritshme duke qënë se nuk ke kompetenca ose kapital social. Projekti po zhvillohet për tre vite. Ekzistojnë shumë zhvillime urbane në disa fshatra. Nga ngritja e rrugëve, hapësirave publike ose edhe të ndihmsh për të organizuar njerëzit. Nëpërmjet këtij projekti ne do të marrim informacion mbi problemin. Nëse ka qytetarë aktivë, është një pikënisje e mirë. Por ata shpesh nuk i kanë aftësitë për të organizuar të tjerët, nuk kanë eksperiencë dhe mund të frikësohen. Ata po kuptojnë shumë aspekte mbi nevojën e pjesëmarrjes, ekspertizës, dhe përfshirjen e qytetarëve.

Një kryetar/e aktiv/e mund të përfshijë banorët dhe në këtë mënyrë gjithashtu siguron që të rizgjidhet herën tjetër. Nëse pjesëmarrja vendoset në zinxhir, krijohet një rreth besimi dhe lumturie. Më pëlqen projekti sepse kam shansin të largohem nga flluska e Pragës dhe të shkoj në një rajon ku jetesa dhe mundësitë janë të ndryshme. Është një peizazh shumë i bukur, por nuk ka shumë për të bërë në këto vende. Njerëzit shkojnë për të punuar në Gjermani dhe rikthehen në Republikën Çeke për të fjetur. Kur vjen puna te shërbimet, kultura, dhe shumë gjëra të tjera, është

goxha bosh. Shpesh, nuk është se duhen bërë shumë gjëra për ta përmirësuar, këto rajone kanë qënë gjithnjë shumë të pasura dhe plot me njerëz inteligjentë. Nuk ka asnjë arsye për të besuar se ky rajon nuk mund t'i japë njerëzve atë që meritojnë. Projekti mund të duket të jetë një ndërhyrje nga jashtë, por në të vërtetë koordinatori i komunitetit është një person që tashmë jeton atje. Ne përpiqemi të jemi pjesë e komunitetit përmes agjentëve tanë që sjellin ekspertizë pas konsultimit me vendasit. Ne gjithashtu u japim atyre një këndvështrim të jashtëm. Nëse koordinatori është me të vërtetë nga ai vend, ata zakonisht e njohin shumë vendin, njerëzit dhe kulturën, por shumë shpesh ata nuk janë të pavarur. Ata duhet të krijojnë dhe mbajnë marrëdhëniet e tyre me komunitetin edhe nëse ata nuk do të punojnë më si koordinator i komunitetit. Ata shpesh vuajnë nga "verbëria lokale" - nuk shohin ndonjë problem sepse kanë jetuar atje për një kohë të gjatë. Individët nga Praga mund të kenë një qëndrim që vendasit mund të mos e pranojnë aq shumë, por koordinatori duhet të bëhet ekspert i vendit, të ketë aftësi që të bëhet pjesë e komunitetit. Në këtë mënyrë, aktiviteti është shumë më i qëndrueshëm. Këta njerëz gjithashtu kanë ndjeshmëri, janë në gjendje të udhëheqin dhe në këtë mënyrë kontribuojnë në komunitetin lokal.

Ky projekt është në vitin e fundit. Jam kureshtar nëse do të ketë vazhdueshmëri. Nëse do të ketë, në projektin e ri duhet të ketë një dimension digjital, sepse ndarja rurale dhe urbane ka gjithashtu dhe një aspekt digjital - rajonet nuk janë gati për epokën digjitale, që është tashmë këtu.



## REALITETI VIRTUAL PËR QYTETIN INTELIGJENT

Në këtë artikull bisedojmë me Gunita Kulikovsky, e cila ka një përvojë të gjerë me aktivizmin urban dhe proceset e pjesëmarrjes në rajonin nordik-baltik. Gjithashtu, që nga viti 2016 ajo ka themeluar një kompani teknologjike gjithëpërfshirëse Vividly që punon me komunikimin vizual për projekte urbane dhe arkitekturë. Kohët e fundit ka filluar një kapitull të ri të konsulencës urbane për të ndihmuar planifikuesit urbanë me vendime të planifikimit të udhëhequr nga të dhënat, digjitale dhe vizuale.

*Na trego pak për veten, me çfarë merresh dhe cili është kualifikimi juaj?*

Unë jam Gunita Kulikovska. Jam një trajnuese, arkitekte, dhe kam punuar si një strategjistë urbane. Kam studiuar arkitekturë dhe jam përfshirë në aktivizëm studentor dhe OJQ, të cilat më çuan drejt lidhjes time me shumë njerëz interesantë të cilët punojnë me metodologjitë e pjesëmarrjes së hershme, në kohërat kur këto ide thjesht diskutoheshin. Në këtë moment, është një normalitet i ri për planifikimin urban. Si një arkitekte e re, dukej si diçka përtej planvendosjeve, vizatimeve dhe modelimit. Në tërësi, kjo ishte dhe koha kur grupi i punës AlterUrb<sup>24</sup> filloi në CDN<sup>25</sup>. Për mua dhe të tjerë që themeluam këtë grup pune dukej sikur hapësirat urbane, në veçanti hapësirat publike janë një platformë për demokracinë, duke i ripërcaktuar këto hapësira; mënyra sesi hapësira dhe kushtet hapësinore mund të fuqizojnë njerëzit për të marrë pjesë në rrethanat sociale e politike ku ata po jetojnë. Patjetër që kjo nuk është asgjë e re, gjërat që ndodhen përpara hundës ore në oborrin tënd janë gjërat në të cilat përfshihesh më shumë. Nëse politika duket kaq larg, ajo çfarë ndodh në oborrin tënd duket kaq e afërt dhe personale. Kjo është mënyra sesi mund ta bëjmë demokracinë sociale më personale, më të angazhuar. Unë isha pjesë e një skuadre që po eksperimentonte me këto metodologji pjesëmarrjeje në Riga, Letoni, kryeqyteti i kulturës në 2014.

<sup>24</sup> Alternative Urbanization, Urbanizimi Alternativ

<sup>25</sup> Cooperation and Development Network, Rrjeti i Bashkëpunimit dhe Zhvillimit

Kështu që ne mbështetëm idenë se kultura si e tillë nuk është thjesht kultura tradicionale që ne njohim, por edhe kultura me pjesëmarrje, kultura e angazhimit qytetar, kultura e planifikimit urban – janë të gjitha kultura që duhet të jenë pjesë e këtij programi, duke kremtuar Rigën si kryeqyteti i kulturës në Europë. Aty ishte ku çdo gjë filloi dhe puna mori hov. Përfundimisht, projekt pas projekti, dhe duke rritur kureshtjen ndaj procesit, komunikimit, vizualizimit dhe angazhimit duke qënë se metodologjia dhe mjetet e zakonshme që përdorin arkitektet nuk po punonin me njerëzit ose nuk i bënin ata të hipnin në bord. Kjo ishte mënyra sesi në fund të 2014 unë u njoha me realitetin virtual dhe median gjithëpërfshirëse e cila në atë kohë më bëri shumë përshtypje. Ne ishim të parët që sollëm syzet virtuale në Balltik jo për qëllime shkencore. Unë vura re një potencial të madh në mënyrën sesi në bashkëbisedojmë për arkitekturë, si mund të përjetojmë arkitekturën, në mënyrën e vet më të pastër dhe të mirë – në nivel hapësinor. Kështu që nëse ne ishim të limituar në planvendosjet, vizatimet, renderizimet – tani, ekziston një portal për të hyrë në hapësirë dhe për ta përjetuar vërtet atë. Paskëtaj, Vividly (përkth. gjallërisht) u krijua. Të flasësh gjallërisht, të veprësh gjallërisht, dhe të tregosh arkitekturë dhe qytetet gjallërisht. Donim të kapërcejmë hendeqet mes pritshmërive tona rreth projekteve në arkitekturë dhe realitetit. Mbi të gjitha, kjo krijoi marrëveshje mes banorëve vendas të lagjeve dhe zhvilluesve të rinj në qytet. Në kapërcejmë hendeqet mes profesionistëve dhe jo-profesionistëve, për të krijuar baza të përbashkëta dhe gjuhë të përbashkët, gjuhë të hapësirës dhe arkitekturës në mënyrë që të gjithë të mund të kuptojnë se me çfarë projekti ka të bëjë. Në të njëjtën kohë shërben si një element që sjell sëbashku palët e interesuara – duke i angazhuar, duke i kuptuar ata, dhe duke disaktuar atë çka është krijuar kështu që ata nuk do të gjenden thjesht përballë këtij fakti. Ata do të jenë në bord, dhe pjesë e zonës. Në Vividly ne i kthejmë hapësirat në përjetime.

*Na trego më shumë për projektet që bëni.*

Nuk ka të bëjë me çfarë bëjmë, por përse e bëjmë. Ne përqipemi vërtet për të krijuar baza të përbashkëta komunikimi. Ka gjithnjë mënyra të ndryshme dhe dëgjues të ndryshëm për t'u adresuar, prandaj edhe mjete të ndryshme që ne përdorim, teknologjitë që përzgjedhim. Unë e përsëris vazhdimisht që është shumë e rëndësishme që pyetjet të vendosen në rendin e duhur. Së pari, të vendosim cila do të jetë historia, cilat janë veprimat që duhen ndërmarë, e së dyti të kuptojmë kujt duhet t'i shpjegojmë çfarë, dhe së treti të përzgjedhim teknologjinë ose mjetet e duhura. Prandaj, ne punojmë me teknologjitë dhe mjetet e peizazhit, duke filluar nga zgjidhje të ndryshme të faqeve të internetit në celular tek përjetimet e realitetit virtual. Kur vjen puna tek planifikimi urban dhe përfshirja e palëve të interesuara, është shumë e rëndësishme për ta trajtuar në mënyrën e duhur. Ne kemi ndërtuar një përbërje të elementëve për të trajtuar këtë rrugëtim të përdoruesve. Për shembull për shkak të krizës së COVID, bota u zhvendos shumë shpejt drejt sferës digjitale; kjo nënkupton që



edhe pjesëmarrja qytetare ka lëvizur drejt mjedisit digjital. Ne përqipemi të përdorim të dhëna 3D, të dhëna hapësinore që kemi dhe i kemi kthyer ato në përjetime ndërvepruese në internet kështu që kushdo të mund të hapë shpejt e shpejt p.sh. 3D.Belgrade.com dhe të jetë i/e aftë të kuptojë çfarë po ndodh në qytet dhe cilat janë projektet e zhvillimit ose ide të veçanta që i janë paraqitur publikut. Në njëfarë

mënyre, e quajmë teleportim virtual, sepse ne ndërthurim të dhënat 3D me imazhe 360°, kështu që mund të shihni terrenin dhe mjedisin 360°. Kështu, njerëzit mund të shohin planet dhe vizualizimet dhe ta marrin informacionin menjëherë. Në shumë prej këtyre projekteve me pjesëmarrje ne bëjmë pyetje të hapura: Çfarë do të pëlqenit këtu? Si do ta shihnit atë? Edhe pse ata e dijnë se ekzistojnë disa kufizime planifikimi, gjithnjë ka ide. Mos e bëj atë pyetje nëse pak a shumë e di çfarë do të ndodhë, bëj pyetje pak më specifike, Si do ta përdornit? Ose, A do të merrnit pjesë në këtë? Morëm reagime nëpërmjet Bot të Telegramit – një asistent planifikues virtual që të jep një pjesë informacioni mbi proceset planifikuese ose idetë dhe ti mund të përgjigjesh pyetjeve ose të ndash idetë e tua mbi pyetjet që po trajtohen. Është e mundur që të kalosh shpejt nga një projekt tek tjetri, por nuk është asgjë që lojtarët<sup>26</sup> e fortë në internet ose modeluesit nuk e bëjnë; është thjesht më e lehtë, të dhëna më të thjeshta – model lazer që kthehet në model 3D. Në fazën e parë faqja e internetit ishte bosh dhe asistenti virtual të jep pjesë informacioni dhe të dhëna kontakti dhe të pyet: ‘Si do ta shihnit zhvillim e kësaj zone? Teksa përgjigjesh, profesionistët mund ta përfytyrojnë por të tjerët jo gjithnjë. Kështu që kur profesionistët vizatojnë mbi propozimet nga biseda në bot<sup>27</sup> mund të jeni të aftë të diskutoni propozimin. Më pas, njerëzit mund të vizualizojnë shumë më mirë sesi idetë e tyre mund të kthehen në përfundime të prekshme.



Për shembull, nëse shihni nga pamja bird's eye mund të shihni sesi zhvillimi duket në tërësi. Mund të jeni të ulur në çfarëdo qyteti, dhe të teleportoresh në këtë diskutim planifikimi dhe të jesh pjesë e saj. Ne nuk jemi më të kufizuar me praninë tonë fizike, ne mund të ndajmë ide të zhvillimit. Për shembull, ka shumë ri-migrim; njerëzit po kthehen pas në fshat dhe janë të interesuar të jenë pjesë në planifikimin e asaj zone, po nuk mund të jenë pjesë e saj fizikisht. Kështu që kthehet në një platformë goxha gjithëpërfshirëse, angazhuere, ku qyteti është i aftë të lundrojë informacionin dhe ta shohë nga këndvështrimi hapësinor, ndryshe nga hartat e sheshta dhe planet, ne mund të shohim si krijohen terreni e gjeografia. Na jep një shtresë tjetër informacioni për atë zonë. Ajo çka është e rëndësishme, nuk ka të bëjë me sesa e koklavitur është kjo zgjidhje, por ka të bëjë me faktin nëse zgjidhja i përshtatet skenarit të duhur, historisë së duhur të përdoruesit. Ne themi gjithnjë: krijoni historinë e përdoruesit përpara se të krijoni zgjidhjen ose një prototip. Ne përdorim teknologjinë për të nxitur angazhim. Ndonjëherë përdorim shprehjen “për të ngritur kulturën e planifikimit”. Pra, ju si një banor, ose si një sipërmarrës, jeni të aftë të kuptoni drejtimin që po merr qyteti, dhe mund të zgjeroni veprimet tuaja dhe të merrni më shumë njerëz në atë zonë, ose sesi mund të bëheni më rezistent me biznesin në marrëdhënie me resurset natyrore që ekzistojnë në atë zonë. Pra, kthehet në jo vetëm një platformë për të marrë mendime, por edhe për të krijuar një sens përkatësie dhe të mbështesë pjesëmarrjen në qytet.

*A duhet të bashkëpunoni me nivele të ndryshme qeverisëse dhe si është përvoja e të punuarit me ta?*

Ka disa nivele pjesëmarrjeje. Në shumicën e rasteve, pjesëmarrja zyrtare është e ngulitur në procedurat e planifikimit. Por, nga këndvështrimi i zhvilluesve, mund të përfshihesh në qytet si zhvillues duke përdorur fuqinë e angazhimit dhe marrjen e mendimeve. Përfshirja e njerëzve është një investim për komunikimet e ardhshme dhe marketingun. Kështu, le të mendojmë për shkollat ose kopshtet – ka plot grupe njerëzish që janë të interesuar për to: prindërit e fëmijëve, fëmijët, mësuesit/mësueset dhe sigur-



sigurisht edhe pjesa tjetër e banorëve në qytet. Është gjithash-tu një miratim për fuqitë politike, ose për njerëzit që janë në atë pikë të pushtetit, në atë pozicion, për të cilët shpërndarja e këtij mesazhi ndaj njerëzve është në interesat e tyre, sepse kjo i lejon të mbajnë pozicionin e tyre. Kjo ka të bëjë me komunikimin dhe ka qënë rasti në qytetet që ne kemi punuar deri tani. Po ashtu, fondet e Bashkimit European kanë mundësuar këto lloj eksperimentesh dhe prototipesh. Kemi rastin e temave të mëdha në një projekt, planifikimi urban dhe pjesëmarrja dhe tema të mëdha të panjohura si për shembull realiteti i zgjeruar (XR) duke përfshirë gjithë këto mjete gjithëpërfshirëse. Ky është projekti i parë që vërteton që koncepti i realitetit të zgjeruar (XR) mund të zbatohet në planifikim urban për publikun e gjerë. Mund të kuptoj planifikuesit që janë thjesht të ulur përballë këtij pellgu me teknologji, dhe të gjitha janë “më zgjidh mua, më zgjidh mua”, por gjithsesi, planifikuesit duhet të kenë aftësi të larta digjitale, në mënyrë që të jenë të aftë të përzgjedhin dhe të kuptojnë sesi mund ta bëjnë bashkë. Ky është momenti ku ne ndërhyjmë dhe bëhemi një ekip energjistik të cilët shtyjme përpara, qyteti të kuptojë më mirë dhe peizazhin e digjitalizimit, teknologjisë dhe në të vërtetë ta thjeshtojë atë deri në pikën që është klienti, nga këndvështrimi i bashkisë, cilin planifikim/operacion ose temë planifikimi po provohet për të zgjidhur dhe duke mos u përpjekur të përqendrohemi në teknologji si e tillë dhe kjo është kur burokracia bëhet pak më e lehtë për t’u trajtuar. Bashkitë janë tashmë të ngarkuara me shumë gjëra, nuk kanë mjaftueshëm kohë për ta shpenzuar në pjesëmarrje. Por, mbase, është një kopësht, një zonë që mund ta zbatosh dhe kthehet në një rast pilot, një provë e metodologjisë dhe më pas të tjerët mund të mësojnë prej saj dhe të përshtaten.

*Faleminderit. Prej sa kohësh po merreni me këtë dhe sa e madhe është skuadra juaj? Në çfarë mënyre punoni?*

Ne vendosëm të krijojmë një kompani nga zeroja në një hapësirë ku asgjë nuk është e përcaktuar. Ripërcaktuam proceset, duke ngritur vazhdimisht pyetje të reja dhe duke u përpjekur për t’u përditësuar sepse në hapësirën digjitale çdo gjë po ndryshon

shpejt. Shumë pyetje strategjike. Faktikisht, bota e biznesit është kaq dinamike dhe të qënit një sipërmarrës është zhvillim dhe rritje personale e vazhdueshme dhe pa i zhvilluar vetë këto mekanizma të të mësuarit, është e pamundur të mbash kokën mbi ujë. Prandaj, kemi bërë shumë prova dhe gabime për të përcaktuar çfarë po bëjmë vërtet. Une e fillova këtë kompani në 2016 dhe në fakt, ne filluam si një startup në Helsinki dhe nga aty lëvizëm në Londër dhe më pas në shumë vende këtej përreth. Kemi krijuar bashkëpunime ndërkombëtare me organizata që përfaqësojnë arkitektë. Ne po ndërtonim një produkt të veçantë për përdorim vetjak dhe zyra arkitekture të shkallës së vogël të cilat kanë aksesuar realitetin virtual pa asnjë pengesë, shkarkime të tepruara apo procese të tjera, sepse në vitet 2-15-2017 shihej ende si e paaksesueshme. Veçanërisht me aplikacionin Vividly ne donim që t’i jepnim akses medimeve krijuese dhe t’i lejonim arkitektët të flisnin për hapësirën e tyre në mënyrë kreative dhe ta shprehin në mënyrën më të mirë. Ashtu siç ndodh në biznesin e teknologjisë dhe në biznes në përgjithësi, gjërat ndryshojnë si dhe teknologjia mbi të cilën ne e bazojmë produktin tonë ndryshojnë në mënyrë dramatike. Në këtë mënyrë, kur bëhesh më i madh, ke më shumë përdorues dhe komunitet më të madh, bëhet më e vështirë për ta mirëmbajtur.



Tri vitet e para kanë të bëjë vetëm me përcaktimin e vlerës të shtuar që ti sjell – a është produkti, apo koha, përpjekjet, njohuritë dhe konsulenca juaj, apo a është e përzierë. Për dy vite ne kemi qënë më shumë një kompani shërbimesh duke u përpjekur për t'u fokusuar në shtimin e vlerës së asaj çka bëjmë. Gjithnjë ekziston një zgjedhje dhe të dalësh jashtë dhe të fillosh një flluskë për asgjë, nuk është vendimi më i lehtë për t'u bërë. Rail Baltica, infrastruktura më e madhe e hekurudhave që krijon lidhje gjithandej, që nga Helsinki në Varshavë, filloi të aktivizohet dhe unë arrita të dëgjohesha prej tyre për të diskutuar progresin, risitë, digjitalizimin në planifikim e ndërtim dhe kjo gjë më dha mjaftueshëm arsye për t'u kthyer sërish këtu në Riga. Tani ne jemi gjashtë deri në tetë njerëz që punojmë në distancë; ne takohemi dhe punojmë krah për krah. Puna fleksibël lejon bashkëpunime të reja interesante – kjo është mënyra sesi projektet e reja ose kompanitë satellite kanë filluar në ekosistemin Vividly. Një prej tyre ishte Muzeu prej Shtëpie, i cili është gjithashtu një nismë që ne filluam në kohërat e COVID dhe u bëmë goxha të njohur për këtë në botë, duke qënë të aftë për të sjellë muzetë tek njerëzit. Ne e krijuam këtë nismë për të mbështetur muzetë. Ne e krijuam këtë me Inv inga SHBA për të sjellë përmbajtjen e tyre në botë pa asnjë barrierë fizike. Vividly merr disa kërkesa shumë interesante nga partnerë të ndryshëm, projekte të ndryshme të mundshme, si për shembull rishtazi filluam të punojmë me punësimin dhe trajnimet duke përdorur realitetin virtual. Kjo na lejon të kuptojmë aspektet psikologjike dhe shkencore të mënyrës sesi njerëzit reagojnë në hapësirë, të cilën nuk mund ta marrësh nga një intervistë e rregullt, qoftë kjo ballë për ballë. Njerëzit mund të dijnë përgjigjet e duhura dhe gjërat që ata thonë mund të mos jenë njësoj me sesi ata veprojnë, bëjnë apo ndiejnë. Është gjithashtu e dobishme që gjatë trajnimeve të jemi të aftë të provojmë si ndihesh në vend të të tjerëve, të dëgjosh të tjerët dhe të shohësh sesi komunikojnë. Këto lloj trajnimesh të aftësive të buta<sup>28</sup> janë tepër thelbësore, dhe zakonisht tejet të shtrenjta për kompanitë, por me realitetin virtual (VR) mund ta shumëfishosh këtë vlerë.

Gjithashtu, pas këtij projekti që përmenda më parë, ne kuptuam se vizualizimet, angazhimi, chatbox<sup>29</sup>, çdo gjë mund të funksion-

jë më së miri, por është nevoja për një bazë të mirë, disa të dhëna hyrëse, dhe të dhënat duhet të jenë të organizuara disi. Kështu, ne filluam të punojmë me qasjen e planifikimit urban të udhëhequr nga të dhënat, dhe për t'i bërë bashkitë të ndërmarrin vendime më të zgjuara, dhe jo emocionale. Ne po punojmë për ta paketuar për qytetet, për t'i ndihmuar të kuptojnë idenë më mirë, të japin ekspertizën e duhur sepse të dhënat janë të dhëna, mund t'i vizualizosh, por a mund gjithashtu të të ndihmojë për të marrë një vendim? Vendimi vjen nga thirrja për atë vendim – për shembull ku duhet ndërtuar kopështi, cilat janë kriteret, dhe për shembull si do të ndikojë komunitetin vendor, ose taksimin dhe të ardhurat, standardi i jetueshmërisë dhe atraktiviteti i hapësirës për shkak të atyre faktorëve. Prandaj, ne mund të krijojmë një program për atë kopësht ose hapësirë publike – çfarë duam të investojmë në këtë fushë në mënyrë që të marrim rezultatet që po kërkojmë. Këto lloj qasjesh do t'i ndihmonin vërtet qytetet të jenë më racionale dhe të përdorin fuqinë e të dhënave. Qytetet flasin shumë për të qënë inteligjentë, por në fund të fundit asgjë nuk është e ndërlidhur në mënyrë inteligjente. Sërish, e kuptoj pozicionin e zyrtarëve të bashkisë – për ta, këto të dhëna janë aty, thjesht duhet t'i organizosh, mbledhësh, dhe do të kesh përgjigjen. Por, për t'u bërë i aftë në menaxhimin e të dhënave, për të mësuar si të analizosh, si t'i paraqesësh ose si të zgjedhësh kriteret e duhura mund të jetë një tjetër ngarkesë për programin e tyre tashmë tejet të zënë. Kështu, është e kuptueshme që mund mos të dish çdo gjë, por të pasurit e këtyre mjeteve në



process, të mbledhura në një mënyrë më miqësore ndaj përdoruesve, dhe digjitale është e nevojshme. Produktet janë PDF, materiale të printuara, dhe do të thotë se sasia e madhe e të dhënave cilësore, dhe thellësisë së të dhënave rrafshohet, për shembull në harta PDF ose JPG – edhe pse mund t'i kesh këto harta në mënyrë më ndërvepruese.

*Si po përshtatemi ne si njerëzim me teknologjinë?*

Ne themi se teknologjia po lëviz shumë shpejt dhe është aq dinamike, po cili ka qënë progresi ose zhvillimi i risive p.sh. në sistemet politike ose sociale? Sa e kemi përtërirë demokracinë, domethënë duke e bërë më të mirë. Çfarë bën teknologjia? E bën diçka më të shpejtë ose efikase, më të hapur. A kemi krijuar mekanizma, metodologji, koncepte të reja të cilat janë strukturat sociale e politike? Ne vazhdojmë dhe përsërisim të njëjtat ndarje politike, demokratët socialë janë këta, qendrorët janë ata, të djathtët janë këta. Megjithatë, është ripërcaktuar tashmë, ndoshta ato emra nuk janë më të ligjshëm, nëse njerëzit nga e kaluara, nga 50 vite më parë do të pyeteshin se çfarë nënkuptojnë këto emra, përgjigjet nuk do t'i përshtateshin vlerave të sotme. Ne nuk kemi sjellë risi në atë fushë, prandaj përgjigja ime është kjo: unë mendoj se ne po krijojmë hendeqe edhe më të gjera mes këtyre dy risive. Si shoqëri ne nuk po ripërtërijmë sistemet sociale, ne nuk po ecim përpara dhe prandaj teknologjia është shumë më përpara dhe do të na duhet të kapim ritmin. Teknologjia mund të organizohet shumë më mirë sesa njerëzit, nganjëherë teknologjia është tashmë atje, por ne nuk jemi rritur ende për ta shfrytëzuar atë në mënyrën më të mire. Kjo është tema për të cilën duhet të diskutojmë – gjithçka është atje, por ne nuk po lejojmë që pjesëmarrja të jetë plotësisht e hapur, sepse ne jemi të frikësuar dhe sistemet tona bazohen në agjenda politike dhe madje edhe në projekte, kështu që ne po kufizojmë hapjen dhe demokracinë që teknologjia mund të na japë.

*Kjo është gjithashtu interesante të imagjinohet, si do të ishte teknologjia ose çfarë do të diskutonim tani nëse teknologjia do të ishte më e arritshme për të gjithë për këto vite ose nëse demokracia jonë do të zhvillohej aq shpejt sa teknologjia.*

Një shembull i mirë është një skenë e filmit fantastiko-shkencor. Pothuajse në të gjithë filmat fantastiko-shkencor ju mund të shihni se si teknologjia tejkalon njerëzimin. Nuk ka pasur skenarë ku është e kundërta, ku njerëzit zhvillohen. Jo për shkak të teknologjisë, çipeve dhe super inteligjencës artificiale (AI). Si mund të jemi më të zhvilluar në mënyrë që të komunikojmë më mirë dhe më qartë. Teknologjia duhet të jetë nxitëse dhe jo e kundërta. Ky është sigurisht një mendim provokues dhe për diskutim, por ajo çfarë duhet të them është se ekziston një mënyrë tjetër për ta parë këtë!



**A R T I K U J T**

## DUKE PËRPARUAR DREJT ARRITJES SË BARAZISË DIGJITALE DHE PËRFSHIRJES NË QYTETET INTELIGJENTE: RASTI I PORTALIT QEVERITAR *E-ALBANIA*

*Nga Manjola Logli*

### 1. HYRJE

Nevoja për qytetet inteligjente po rritet dita-ditës. Këto qytete janë dhe zgjidhja ndaj problemeve me të cilat qytetet e Europës Qëndrore e Lindore përballen si rrjedhojë e migrimit të brendshëm nga zonat rurale drejt atyre urbane. Për më tepër, disa qytete në Europën Qëndrore e Lindore po përpiqen të zbatojnë dhe të promovojnë praktikën e qëndrueshmërisë për të trajtuar këto sfida të zhvillimit urban, që vijnë në rritje dita-ditës. Ashtu si pjesa më e madhe e qyteteve inteligjente në botë, kur bëhet fjalë për zgjidhjet inteligjente, qytetet e Europës Qëndrore e Lindore janë të fokusuar më shumë në zgjidhjet teknologjike, edhe pse teknologjia mund të sjellë po aq pasoja negative sa edhe pozitive, duke rritur diskriminimin, pabarazitë dhe duke sjellë përplasje të vlerave të pavarësisë dhe mbrojtjes së të dhënave. Çdo qytet ka vizion të caktuar dhe shpesh ka përparësi të ndryshme për arritjen e qëllimeve, duke përfshirë këtu edhe kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranën, ku koncepti i qytetit inteligjent nuk është i panjohur. Disa elementë të tij janë zbatuar, si për shembullin në rastin e projekteve Mobike, aplikacioni "Tirana ime" dhe së fundmi portali qeveritar e-Albania. Nëpërmjet këtij shkrimi do të shqyrtojmë rekomandimet për zbatimin e teknologjive të qyteteve inteligjente në Tiranë, bazuar në një rishikim të përmblendhur



të literaturës për këtë temë, për t'i dhënë politikëbërësve një mundësi për të dalluar fushat për përmirësime në lidhje me ndikimin që teknologjitë në qytetet inteligjente mund të kenë në jetën dhe etikën tonë.

Nëpërmjet këtij portali, qeveria e Shqipërisë i ofron qytetarëve shërbime të ndryshme, për lëshimin e dokumenteve, duke iu dhënë qytetarëve mundësinë për të aplikuar për leje dhe dokumente të ndryshme në internet, duke shmangur rradhët e gjata në institucione publike. Në të kundërt, kjo mundësi e madhe për të rinjtë, ashtu si për të tërë që kanë mundësinë për të aksesuar këtë portal, është kthyer në një barrierë për popullsinë e moshuar dhe njerëzit të cilët nuk kanë mjetet e nevojshme për të aksesuar teknologjinë, duke u kthyer në një fenomen që krijon pabarazi. Edhe pse në qytetin e Tiranës ekzistojnë dy ADI-SA (Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve të Integruara) që i ofrojnë qytetarëve shërbime publike, ato janë të pamjaftueshme për të plotësuar të gjithë nevojat e qytetarëve, pa shpenzuar kohë në rradhë të gjata. Diçka tjetër që duhet përmendur është që ka

disa qytete në Shqipëri të cilave u mungon kjo lloj asistence, duke qënë se nuk ka zyra ADISA, dhe ata nuk janë të informuar se mund ta marrin këtë shërbim në zyrat e lartpërmendura. Për këtë arsye, kjo pjesë e popullsisë, duke mos patur tjetër alternativë, ka vendosur për një zgjidhje më pak efikase, si për shembull të shkojë në vende që ofrojnë shërbime mbështetëse për përdorimin e portalit e-Albania, të paautorizuara nga qeveria. Në këtë mënyrë, pa qënë të vetëdijshëm, ata po japin informacionet e tyre personale dhe rrezikojnë privatësinë vetjake si rrjedhojë e ndërveprimit me këto zyra.

Qëllimi i këtij shkrimi është të paraqesë një analizë të saktë të teknologjive të qyteteve inteligjente, duke diskutuar rëndësinë dhe disavantazhet e tyre, pra duke sugjeruar zgjidhje më të mira për qytetarët e Shqipërisë, duke marrë parasysh të gjithë nevojat e përdoruesve dhe duke iu dhënë politikëbërësve mundësinë për të bërë përmirësime të lidhura me ndikimin e teknologjisë së qyteteve inteligjente në jetën dhe etikën e individëve. Nga njëra anë, ky shkrim do të fokusohet në dy probleme, duke përshkruar mënyrën sesi këto teknologji rrezikojnë privatësinë e qytetarëve dhe mungesën e informacionit dhe njohurive. Duke patur parasysh këtë, koncepti i qytetit inteligjent duhet të rishikohet dhe rivlerësohet në mënyrë që të përditësohet në një variant më të mirë për të përmbushur kriteret e nevojshme sipas disa standardeve dhe vlerave, duke çuar në një zgjidhje të sigurt.

## 2. BARAZIA DIGJITALE DHE PËRFSHIRJA NË QYTETET INTELIGJENTE

Qyteti inteligjent është një *"buzzword"* e cila ka të bëjë me një fushë të gjerë, ku një ndër përbërësit kryesorë është teknologjia. Duke përfshirë teknologjinë, një qytet inteligjent duhet të përmirësojë cilësinë e jetës së qytetarëve, t'i shërbejë këtyre vlerave, të bëjë jetën tonë më të lehtë, dhe të sigurojë një të ardhme të sigurt.

"Ndërkohë që teknologjia ka pa dyshim një ndikim pozitiv në jetët tona, mund gjithashtu të jetë një kërcënim. Duke qënë shumë e më shumë e integruar në jetët tona, TIK po ndikon në jetët tona, etikën dhe ç'është më e keqe, duke krijuar ndarje digjitale.

Teknologjia e informacionit e komunikimit nuk mund automatikisht të krijojë një qytet inteligjent, por njerëzit mundën. Duke ndjekur qytetarët si protagonistët kryesorë, një qytet inteligjent duhet të përqafojë barazinë digjitale dhe përfshirjen, edhe pse shumë pak bashki janë mjaftueshëm "të zgjuara" dhe kanë angazhuar qytetarët e tyre për strategji të qyteteve të zgjuara. Përpos kësaj, vihet re një mungesë literature dhe kërkimi shkencor për sa i përket barazisë digjitale dhe përfshirjes si pjesë e konceptit të qytetit të zgjuar.

Një qytet inteligjent nuk mund të neglizhojë përqindjen e popullsisë të cilës i mundojnë aftësitë dhe mundësitë për të aksesuar risitë, dhe t'i mbajë larg platformave të reja, përndryshe zor se mund të quhet "inteligjent". Një qytet inteligjent duhet të promovojë strategji si për barazinë digjitale, ashtu edhe përfshirjen. E para ka të bëjë me gjendjen e të qenit të aftë për të kënaqur të gjithë nevojat e qytetarëve pavarësisht gjendjes së tyre ekonomike, aftësive, njohurive, etj. përmes nismave qytetarëve që japin barazi, akses të hapur, demokraci, dhe ekonomi për pjesëmarrje të plotë në shoqërinë tonë. E dyta, përfshirja digjitale ka të bëjë me aktivitetet e ndërrmarra për të ndihmuar qytetarët të aksesojnë dhe përdorin teknologjitë në një mënyrë të sigurt dhe të duhur.

## 3. ZGJIDHJE TË SUGJERUARA

Ashtu siç e përmendëm më parë, portali qeveritar e-Albania, ndërkohë që mund t'i sjellë shumë të mira qytetarëve, mund të krijojë 'ndarje digjitale' për atë pjesë të popullsisë të cilët e gjejnë vetveten të shkëputur nga këto teknologji. Zgjidhjet inteligjente, të ofruara nga qytetarët, nuk duhet thjesht të gërvishtin sipërfaqen e nevojave të qytetarëve, por duhet të synojnë që përdorimi i tyre është gjithëpërfshirës dhe i drejtë/paanshëm. Ka shumë zgjidhje që mund të aplikohen për të parandaluar 'ndarjen digjitale' dhe të promovojë përfshirjen në rastin e portalit qeveritar e-Albania, gjë e cila mund të zbatohet edhe në një kontekst më të gjerë.

- Qytetet duhet të fillojnë me plane konkrete përpara së të përfshijnë këto teknologji, testimin e tyre, dhe lënien e hapësirës për eksperimentin, në mënyrë që të krijojnë alternativa më të qëndrueshme.
- Qytetet duhet të bëjnë kërkim për përbindjen e qytetarëve që nuk ndihen rehat me këto teknologji, qytetarët pa akses dhe aftësi digjitale, në mënyrë që për të marginalizuar të gjitha efektet negative që mund ta bëjnë jetën e qytetarëve edhe më të komplikuar, duke i shmangur ato dhe duke u siguruar që i gjithë komuniteti është i ndërlidhur dhe merr pjesë në vendimmarrje.
- Bazuar në të dhënat e nxjerra prej këtyre kërkimeve, qytetet mund të përdorin strategji që përfshijnë ato të cilat mund të ndihmojnë të tjerët, duke i dhënë mundësitë për të propozuar ide, të fuqizojë qytetarët për të promovuar bashkëpunim, ndijimi pjesëmarrës, dhe rritjen e përfshirjes sociale.



- Po ashtu, qytetet mund të sigurojnë programe të ndryshme që ofrojnë trajnime falas në biblioteka të qyteteve, soë shërbime internet, duke ofruar njohur falas dhe mjetet e duhura për të promovuar sjelljet pro-sociale për të gjithë.
- Në rastin e kontekstit të Tiranës, qyteti duhet të vendosë numrin e zyrave ADISA dhe shërbimeve që ato ofrojnë për qytetarët, duke i përkthyer këto teknologji në një gjuhë më të lehtë për të gjithë, duke fuqizuar qytetarët për të tejkalluar barrierat që kanë krijuar.
- Ata duhet të ofrojnë udhëzime që duhet të jenë të aksesueshme për të gjithë e këto udhëzime mund të jenë pjesë e gazetës ditore, duke qënë se janë kryesisht të shitura ndaj popullsisë së vjetër, ose mund të jenë pjesë e reklamave televizive. Për më tepër, ata mund të ofrojnë broshura falas për të gjithë.

#### 4. PËRFUNDIME

Të gjitha qasjet e qyteteve inteligjente janë të bazuara në teknologji, duke krijuar atë çka shumë mund ta quajnë "qytetet inteligjente". Mënyra sesi secila prej këtyre teknologjive zbatohen duhet përditësuar në mënyrë që cilësia e jetës së të gjithë qytetarëve të përmirësohet. Për sa i përket kësaj, termi i 'qytetit inteligjent' ka të bëjë me gatishmërinë e individëve për të ndërtuar zgjidhje urbane inteligjente, duke rritur pjesëmarrjen, ndarjen e njohurive, dhe shmangien e përplasjes së vlerave tona.

Prandaj, në mënyrë që ta bëjmë qytetin të lulëzojë, të gjithë strukturat kryesore të qytetit duhet të punojnë së bashku, duke fuqizuar qytetarët, dhe duke krijuar hapësirë për eksperimentim për të zgjidhur problemet e qytetarëve, duke përdorur gjithë resurset dhe zbatimin e teknologjive të reja nëpërmjet një kontrolli demokratik.

## MENDIMI PRAKTIK

nga Daria Smagina dhe Lucy Gavrilenko

### PJESA 1: NJË DËSHIRË E FORTË PËR TË RIPËRCAKTUAR QYTETET INTELIGJENTE

Nëpërmjet këtij artikull duam të ndajmë disa përvoja të perspektivës globale mbi bërjen e qyteteve më inteligjente dhe rezultatet e pyetësorit tonë pilot, ku të anketuarit, që përfaqësojnë vendet e Europës Lindore dhe Jugore dhe madje edhe të Amerikës Latine, ndajnë pikëpamjet e tyre lokale. Si studiues të gjelbër urbanë, po pyesim: si funksionon procesi i zhvillimit të qyteteve inteligjente në pjesë të ndryshme të botës? Cilat qytete ilustrojnë më mirë përdorimin e teknologjive inteligjente dhe si e arritën ato nivelin e tyre të modernizimit? Ne po pyesim se si kjo njohuri mund të zbatohet në realitetin e Europës Lindore. Duke krijuar një pyetësor të pavarur, ne u përpoqëm të gjenim përgjigje të paktën për disa nga këto pyetje në këtë artikull.

Sipas vlerësimeve të OKB, 68% e popullsisë në botë do të jetojnë në qytete deri në vitin 2025 [1]. Tashmë, disa nga mega-qytetet e botës thuhet se janë të mbipopulluara. Bashkitë nuk arrijnë dot gjithnjë të përballojnë sfidat e grumbullimit masiv të mbetjeve, furnizimin e shërbimeve dhe vështirësinë e shpërndarjes së energjisë elektrike në mënyrë uniforme nga rajoni në rajon, etj. Për t'i siguruar popullsisë shërbime urbane me cilësi të lartë, administratat po përballen gjithnjë e më shumë me nevojën e sistemeve të ndryshme të përparuara të informacionit.

Për të kuptuar se si evolucioni i shpejtë i strategjive moderne të organizatave civile ndikon në jetën e njerëzve është e vlefshme që së pari të përpiqemi të kalojmë nëpër përbërësit kryesorë të perceptimit të inteligjencës së qyteteve nga një qytetar i ri me-satar; Le të fillojmë duke diskutuar një mendim shumë të popullarizuar: ku në literaturën për qytetet inteligjente, një denoncues i rëndësishëm i përbashkët i referohet një progresi teknologjik. Sipas Institucionit Britanik të Standardeve, Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) “[...] krijojnë mundësi që qeveritë lokale të ndërveprojnë drejtpërdrejt me komunitetet dhe infrastrukturën urbane dhe të monitorojnë se çfarë po ndodh në qytet, si po zhvillohet qyteti dhe cilat mënyra mund të përmirësojnë cilësinë e jetës” [2]. Kjo do të thotë që përmes përdorimit të sensorëve të ndryshëm të integruar që mbledhin informacion në kohë reale, qytetet mund të grumbullojnë të dhëna nga banorët dhe të përfitojnë nga teknologjitë bashkëkohore algoritmike për të zgjidhur problemet e joefikasitetit. Por, sa efektive janë teknologjitë e përpunimit të të dhënave në qytetet moderne në të cilat jetojmë? TIK presupozon se është thelbësore për cilësinë, produktivitetin dhe ndërveprimin e shërbimeve të qytetit – për të ulur kostot, konsumin e burimeve dhe për të përmirësuar komunikimin midis banorëve të qytetit dhe shtetit.





Ne shpesh besojmë se përdorimi i teknologjive inteligjente në qytetet tona po përhapet vazhdimisht për të përmirësuar menaxhimin e rrjedhës urbane dhe përgjigjen e shpejtë ndaj detyrave komplekse. Për më tepër, është një besim i zakonshëm që një “qytet inteligjent” është më i përgatitur për të zgjidhur problemet sesa një qytet që ka një marrëdhënie të thjeshtë “operacionale” me qytetarët e tij. Sidoqoftë, termi në vetvete mbetet i paqartë në specifikën e tij, dhe prandaj përfshin shumë interpretime dhe diskutime, njëri prej të cilave vendosëm ta vinim si provokimin në mesin e të anketuarve tanë.

1. SINGAPOR	2. HELSINKI
3. ZYRIH	4. OKLAND
5. OSLO	6. KOPENHAGEN
7. GJENEVË	8. TAIPEI
9. AMSTERDAM	10. NJU JORK
56. MOSKË	73. SHËN PETERBURG

Një nga vlerësimet kryesore që një qytet inteligjent mund të marrë në ditët e sotme është renditja nga institucionet ndërkombëtare, ekspertët dhe institucionet e tjera të ngjashme. Sidoqoftë, ne kemi në mendje se ndërsa një renditje e tillë ofron një pasqyrë të nevojshme të trendeve globale, ajo prapë nuk mund të pranohet si burimi i vetëm i drejtë i kategorizimit objektiv. Ndërsa jemi duke u përqëndruar në tre fusha në këtë hulumtim – Europa Lindore (konkretisht Rusia), Europa Jugore (Itali) dhe Amerika (Kolumbi dhe SHBA) – ne do të nxjerrim në pah tendencat kryesore që shfaqin këto rajone në renditjen e fundit të qyteteve inteligjente botërore. Vendi i parë në listën e vitit 2020, i prezantuar nga Instituti për Zhvillimin e Menaxhimit, në bashkëpunim me Universitetin e Singaporit për Teknologji dhe Dizajn (SUTD) [3], ka shpallur Indeksin e

Qytetit Inteligent 2020, i cili shkoi në Singapor për të dytin vit radhazi. Pozicioni i dytë në renditjen e qyteteve inteligjente u mor nga Helsinki, dhe i treti iu dha Zyrihut. Okland dhe Oslo vijojnë më pas, ndërsa Kopenhaga dhe Gjeneva zunë përkatësisht vendin e gjashtë dhe të shtatë. Qyteti Taipei është qyteti i tetë më i inteligjent, i ndjekur nga Amsterdami. Nju Jorku mbylli dhjetëshen e parë. Përveç kryeqytetit rus, vlerësimi përfshinte Shën Petersburgun, i cili zuri pozicionin e 73-të, pa ndryshuar pozicionin e tij krahasuar me vitin 2019. Në studimin e botuar më 17 shtator 2020, Moska u rendit e 56-ta. Kryeqyteti rus u ngjiti 16 vende në renditjen e qyteteve inteligjente, krahasuar me listën nga viti 2019. Renditja përfshinte 109 qytete.

Këto janë disa nga rezultatet e raportit vjetor të ICity Rate 2017, raporti vjetor i FPA (Shoqata e Planifikimit Financiar) që ofron një përmbledhje të situatës së qyteteve në Itali në rrugën e tyre për t’u bërë “inteligjent”, domethënë më afër nevojave të qytet-



et, të tilla si varfëria, arsimi, ajri dhe uji, energjia, rritja ekonomike, punësimi, turizmi dhe kultura, kërkimi dhe inovacioni, lëvizshmëria e qëndrueshme, zonat e gjelbra publike, ligjshmëria dhe siguria, etj. Atje janë projekte ambicioze për qytetet e së ardhmes, disa prej të cilave tashmë janë në zhvillim e sipër. Për shembull, disa qytete janë duke futur në mënyrë aktive teknologji dhe po shpalosin planet sesa të zgjuar dhe të qëndrueshëm mund të bëhen deri në vitin 2030. Milano, Bolonja dhe Firenze, tre qytetet kryesore në Itali, përfaqësojnë modele të ndryshme të zhvillimit urban, në gjendje të sjellin arritje të rëndësishme. Milano, i nxitur nga dinamizmi ekonomik, është “platforma e mundshme” më solide për Qytetin Inteligjent të vendit.

Një model tjetër kurioz i parë mirë nga renditja e Institutit Ndërkombëtar Zviceran për Zhvillimin e Menaxhimit është që qytetet më të mëdha të Amerikës Latine (të tilla si Santiago, Sao Paulo, Buenos Aires dhe Bogotá) janë mbledhur në fund të qindësive të para. Në përgjithësi, këto qytete kanë disa karakteristika të përbashkëta. Aspektet dhe teknologjitë e qytetit inteligjent në përgjithësi vlerësohen pozitivisht, por lidhja e tyre me përfshirjen dhe barazinë mori një vlerësim jashtëzakonisht të ulët. E njëjta gjë vlen për sigurinë dhe aksesueshmërinë. Këto probleme lidhen, kryesisht, në fushën shoqërore. Si e tillë, hapësira sociale është një shqetësim. Nga ana tjetër, ekzistojnë gjithashtu vështirësi të dukshme me bazat e menaxhimit të qytetit, të tilla si ndotja e ajrit, korrupsioni dhe kujdesi shëndetësor. Edhe pse qytetet grumbullojnë shumëfishimin e mundësive ekonomike, çështjet e demokracisë dhe të drejtave themelore të njeriut janë ende në program. Programet zyrtare shtetërore të zhvillimit urban, si integrimi i sporteve në Bogota, “Argjentina Urbane”, etj., po mbulojnë nevojat më të “dukshme” të qytetarëve, duke injoruar kërkesat e përhershme. Për shembull, për të mposhtur problemin e transportit në Bogota, ata ndërtuan një sistem metrobus që mbulon pjesët kryesore të qytetit. Ekziston edhe një aplikacion që ju lejon të zhvillonit një itinerar drejt destinacionit tuaj dhe të monitoroni orarin aktual të mbërritjeve. Nga ana tjetër, zonat e qytetit me dendësinë më të lartë të popullsisë janë ende duke u injoruar dhe nuk ka perspektivë për të zgjidhur problemin. Sistemi i auto-

busëve është i mbipopulluar, qytetarët e urrejnë përdorimin e tij dhe preferojnë të përdorin makina personale ose të qëndrojnë në zonën e bllokut të tyre. Kjo qasje i referohet zhvillimit të infrastrukturës, por nuk i referohet sigurimit të qasjes reale në lëvizjen urbane; kjo krijon shumë efekte anësore, të tilla si pasiguria, veçimi, përjashtimi etj.

Një qytet inteligjent është një vend ku jo vetëm teknologjitë dhe infrastruktura po zhvillohen në mënyra të mjaftueshme, por qyteti u siguron qytetarëve qasje të barabartë në shërbimet e tij. Koncepti modern propozon që të ndërtohet kjo barazi bazuar në të dhënat e mëdha të mbledhura nga zona e qytetit nga mjete të shumta teknologjike. Le të shohim nga afër. Ne nuk dimë si ta parashikojmë të ardhmen, por jemi mjaft të aftë të imagjinojmë se si do të jetë jeta në zonat e mëdha metropolitane. Në radhë të parë, qendrat urbane do të jenë edhe më të populluara. Si rezultat, megaqytetet e mbingarkuara aktualisht do të përjetojnë probleme edhe më të mëdha me ngarkesën, infrastrukturën dhe transportin në të ardhmen. Këto sfida po trajtohen nga risitë për qytetet që janë futur dhe testuar në shumë vende sot.



Shpesh një qytet inteligjent konsiderohet si një vend ku nuk keni nevojë të shqetësoheni për sigurinë personale. Si të sigurohemi që shkalla e krimit në mes të qyteteve dhe vendbanimeve të tjera të zbrësë në zero, dhe njerëzit e zakonshëm të mos kenë më frikë për veten dhe familjet e tyre? Disa qeveri mbështeten në përdorimin e inteligjencës artificiale, si pjesë e mundësive të reja të zhbllokuara nga teknologjitë e fundit të bazuara në vizionin e makinerive dhe Inteligjencën Artificiale. Për shembull, teknologjitë e njohjes së fytyrës përdoren në shumë qytete inteligjente në të gjithë botën, veçanërisht në Moskë. Për momentin, më shumë se 160 mijë kamera inteligjente janë instaluar në kryeqytetin rus, me ndihmën e të cilave policia zgjidh qindra krime në vit. Kjo teknologji e zgjuar shpesh përdoret për të marrë kontrollin mbi jetën e përditshme dhe politike të njerëzve, duke prishur të gjithë paradigmen ligjore të hapësirës personale private. Në këtë mënyrë ata përdorin teknologji inteligjente video në Kinë për të kontrolluar pakicën Ujgur dhe për të mbledhur të gjitha të dhënat e mundshme duke i përdorur ato pa leje dhe kundër politikës së drejtave të njeriut. Sa i përket rrugës së sigurt dhe shkallës së ulët të krimit, ajo lidhet drejtpërdrejt me normat e të ardhurave dhe lumturisë në qytet. Njerëzit e lumtur që kanë çfarë të hanë, kryesisht nuk zgjedhin të kryejnë krime.

Dukshëm, sistemi i propozuar ka rreziqe të shumta. Shqetësimi kryesor që kemi në rend të ditës tanimë përfaqësohet nga shteti që përdor mjete kontrolli si në jetën publike, dhe atë private të qytetarëve. Mund të gjejmë sisteme të ndërkombyeshme për të krijuar siguri në qytete. Këto sisteme drejtohen nga vetë qytetarët. Për shembull, në Nju Jork, ekziston një aplikacion aktiv qytetarësh që njerëzit e përdorin për raportimin e drejtpërdrejtë të krimeve. Niveli i pjesëmarrjes pasqyron nivelin e sigurisë që ka në qytet. Nga ana tjetër, ky aplikacion përjashton njerëzit që nuk kanë telefona celularë dhe internet (komunitete të pambrojtura nga shoqëria, njerëz të pastrehë, etj.). Kjo mënyrë e vendosjes së sigurisë mund të jetë një nga strategjitë më efikase, prandaj duhet të ketë një nivel të veçantë të digjitalizimit midis grupeve të synuara.

## HULUMTIMI SOCIAL

Pas promovimit të pyetësorit për dy javë në mediat sociale, morëm përgjigje nga të rinjtë që jetojnë në qytete të një shkalle dhe gjeografie tjetër: nga Akra dhe Novosibirsk në Bolonjë dhe nga Londra në Bogota. Duke hedhur një vështrim në shembujt e qyteteve inteligjente që na u dhanë nga të anketuarit, del qartë – ka dy vendndodhje kryesore të qyteteve inteligjente: i pari është në Europën Veriore dhe një tjetër është në Azi. Shembulli i vetëm i Amerikës së Veriut që kemi është Nju Jorku dhe një dyshe kanadeze, Kebek dhe Toronto. Sidoqoftë, dy udhëheqësit kryesorë të renditjes sonë botërore janë Tokio dhe Amsterdam.


Ju mund të mendoni se tani ne jetojmë jetën tonë më të mire, të digjitalizuar, por në të njëjtën kohë, shumica dërrmuese e të anketuarve tanë konsideruan që qytetet e tyre nuk ishin inteligjente. Sidoqoftë, ata që jetojnë në qytete inteligjente arritën në përfundimin se kjo lidhet kryesisht me shërbimet publike online dhe kontrollin e trafikut.



Sipas mendimit të të anketuarit, transporti publik dhe problemi i lëvizshmërisë së qytetit u zgjodhën si drejtimi kryesor për zhvillimin e teknologjive të qytetit të zgjuar. Në të njëjtën kohë, siguria dhe siguria e qytetarëve u shfaq si opsioni më pak i preferuar. *Lind një pyetje: a ka ndodhur sepse, duke jetuar në Evropë, ku kemi një iluzion sigurie, jemi mësuar ta trajtojmë këtë privilegj si normalitet të ri?*

Një trend interesant u shfaq kur erdhi fjala për një pyetje kryesore – a jeni gati të lidhni smartphone-in tuaj me rrjetin e qytetit inteligjent? Ndërsa pothuajse të gjithë ata që jetojnë në një qytet kanë një smartphone, në zonat e hulumtimit tonë, 11% e njerëzve deklarojnë se nuk janë të gatshëm për ndërhyrje të tilla.

Në pjesën më kreative të pyetësorit, ku ne propozuam të shpikim mënyrën se si të anketuarit do të donin të kontribuonin në bërjen e qyteteve të tyre më inteligjente, ne kemi marrë rezultate të pa-



pritura. Ndërsa disa njerëz preferuan të heqin dorë nga përgjigjet, të tjerët shprehën me padurim gatishmërinë për të komunikuar dhe bashkëpunuar me autoritetet e tyre lokale, për të marrë pjesë në edukimin publik (lidhur me teknologjinë e qytetit inteligjent), dhe madje për të mobilizuar qytetarët në mënyrë vullnetare për t'u përfshirë në nismat lokale.


Duhet të pranojmë se qasja e përfaqësuar në këtë hulumtim social pilot ka një shkallë mjaft modeste. Sidoqoftë, përmes kësaj forme kemi gjetur prirjen kryesore: njerëzit janë të gatshëm të jetojnë në qytete inteligjente dhe ata kanë një bazë të shkëlqyeshme që mund të përdoret për të ndihmuar profesionistët që përcaktojnë problemet e qytetit për një zhvillim të ardhshëm të strategjisë inteligjente, gjë që një nga ekspertët tanë e konsideron si hapin më të rëndësishëm të këtij rrugëtimi. Në fund të fundit, ne ishim veçanërisht krenarë për të vëzhguar të anketuarit tanë të bashkuar për të zgjedhur qytetarë inteligjent midis banorëve të tyre si përbërës të një qyteti inteligjent!

Sigurisht, zhvillimi i teknologjive digjitale dhe ndërtimi i “qyteteve inteligjente” shihen si një nga strategjitë themelore të zhvillimit modern urban. Qeveritë lokale në të gjithë botën po investojnë në mjedise inteligjente si një mënyrë për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve urbane. Qytetet portretizohen si “rrjete inteligjente”, të cilat janë të lidhura jo vetëm me njëri-tjetrin, por edhe me përdoruesit e fundit, zyrtarët, biznesmenët. Mediat sociale po bëhen një mënyrë e re për të “ndjerë” qytetin dhe për të mësuar se çfarë po ndodh në të. Ky transformim urban shkon paralelisht me transformimin e kërkimit urban. Ata fillojnë të punojnë me sasi të mëdha informacioni, mund të analizojnë ndryshimet në qytet me intervale minutë dhe orë dhe të nxjerrin qindra modele të reja të aktivitetit urban nga të dhënat e papërpunuara. E gjithë kjo kërkon një transformim në metodat e studiuesve të qytetit.

Sidoqoftë, asnjë transformim teknologjik nuk ndodh pa probleme. Kjo është veçanërisht e dukshme në shkencë, ku praktikat

dhe idetë e studiuesve janë të bashkangjitura në disa metodologji dhe punojnë me të dhëna. Për të digjitalizuar, ata duhet të braktisin këto praktika ose t'i përziejnë ato me të tjera. Digjitalizimi në kërkimet urbane nuk është pa dhimbje, veçanërisht për studiuesit socialë dhe humanitarë të cilët duhet të zhvillojnë modele të koordinimit me "programuesit" në lidhje me të dhënat, metodat dhe menaxhimin e projekteve.

Në përgjithësi, projektet moderne digjitale urbane priren të formojnë modele pune koordinimi që zgjidhin tensionet që lindin në ekipe ndërdisiplinore. Përzierja e modeleve të ekspertizës, punës së përbashkët, menaxhimit zyrtar, asambleve të përkohshme ose urdhrave bëhen zgjidhje në projektet digjitale urbane, ekipet e të cilave karakterizohen nga role hibride dhe kufij të papërcaktuar. Për të arritur rezultate të kërkimit të përbashkët, pjesëmarrësit duhet të rishikojnë parimet e tyre metodologjike, qasjet dhe kuptimet në procesin e hartimit të projektit, mbledhjes, përpunimit dhe interpretimit të të dhënave, duke marrë parasysh ndikimin gjithnjë në rritje të digjitalizimit të qytetit dhe proceseve urbane. Prandaj, ne guxojmë të nxjerrim përfundimin, se qytetet e zhurmshme inteligjente të kohërave tona, sipas ideve të të rinjve të moshës 18-35 vjeç, janë, para së gjithash, mishërimi i qyteteve inteligjent. Koncepti i një qyteti inteligjent, për ta thënë drejtpërdrejt, i detyron qeveritë të bashkëpunojnë me banorët e tyre, duke marrë parasysh respektin për të dhënat personale të secilit përdorues të teknologjive të ofruara inteligjente. Sipas përvojës nga Rusia, Amerika e Jugut dhe Europa, bota ka ende diçka për të kërkuar në këtë dialog për të drejtat civile në zhvillimin e shpejtë të qyteteve inteligjente.



## Pjesa II: MENDIMI PRAKTIK: RINDËRTIMI I VIZIONIT TË QYTETEVE INTELIGJENTE

Që nga fillimi i aventurës sonë hetimore, ne kemi vendosur të mbështesim mendimet tona përmes bisedimeve të shpejta me ekspertë në temën e qyteteve inteligjente. Për të analizuar shumëllojshmërinë e rrugëve që mund të ndërmerreshin për të bërë qytetin më inteligjent, ne u takuam me dy ekspertë nga pjesë të ndryshme të botës: Rusia dhe SH.B.A.

Të dy kanë përvojë të gjerë të praktikës globale në lidhje me teknologjitë inteligjente dhe / ose planifikimin urban. Shpresojmë që kualifikimi dhe njohuritë e tyre për pikat e forta dhe të dobëta të zhvillimit modern urban do të na lejojnë të arrijmë një nivel të ri të të kuptuarit të problemit.

Eksperti ynë i parë, Aleksey Radchenko, është një specialist në sistemet e informacionit gjeografik (GIS) dhe punon për zhvillimin e teknologjive të qytetit inteligjent në Rusi. Autor i kanalit të shkencës urbane, transportit dhe të dhënave të qytetit ([https://t.me/urban\\_blog](https://t.me/urban_blog)); autor i projektit 'Harta e aksidenteve rrugore' ([dtp-stat.ru](http://dtp-stat.ru)) dhe Analiza e Rrugëve ([transmetrika.com](http://transmetrika.com)).

*Cila është formimi juaj profesional në lidhje me Qytetet Inteligjente dhe teknologjitë urbane inteligjente?*

Unë punoj me sektorin e IT, kryesisht - analist i GIS. Për shembull, tani unë jam përfshirë në një projekt që lidhet me analizat e të dhënave të hapura GIS në sektorin e zhvillimit urban. Projekti ynë kryesor, tani për tani, është një hartë ndërvepruese e aksidenteve. Ideja prapa projektit ishte bashkimi i hartave të veçanta me të dhënat zyrtare pa fytyra, kështu që në fund të fundit mund të shohim lokalizimin e aksidenteve rrugore në kohë reale.

*Si mund t'ia përshkruani konceptin e qytetit inteligjent një personi që nuk ka asnjë ide për të?*

Aktualisht nuk ka një përkufizim të vetëm të Qytetit Inteligjent. Unë e shoh konceptin e Qytetit Inteligjent si një politikë urbane që lejon ndërtimin e një strategjie të ndërgjegjshme konsumi duke e bazuar në analizën e të dhënave të mëdha, ku të gjitha aktivitetet pasqyrohen në statistikë. Përkufizimi i një qyteti inteligjent është ende i pasigurt pasi ai lidhet me fenomenin e qytetit digjital, gjurmëve digjitale, dhe të drejtave digjitale.

*A mendoni se të gjitha qytetet duhet të bëhen inteligjente? A e trajtoni këtë trend si pozitiv?*

Është pothuajse e pamundur të vlerësosh procesin e kthimit në qytet inteligjent si pozitiv ose negativ. Çdo mjet mund të përdoret në të dy mënyrat. Digjitalizimi i të dhënave urbane mund të jetë jashtëzakonisht efikas. Në të njëjtën mënyrë mund të jetë i dëmshëm në aspektin e kontrollit shoqëror. Në përgjithësi, ky proces nuk mund të ndalet, prandaj është e rëndësishme të keni një kontroll të fortë dhe transparencë të procesit.

*Kur është koha që një qytet të fillojë të kalojë në një qytet inteligjent?*

Çdo qytet duhet të jetë inteligjent në mënyrën se si mund ta përballojë atë dhe sipas qëllimeve që ka. Tanimë, të gjitha territoret janë digjitalizuar (faqet e internetit të qytetit, semaforët, interneti, etj.). Pra, kthimi në qytet inteligjent është i pashmangshëm. Çështja e vetme është: Si plotësohen nevojat strategjike të qytetit?

*Kush është nismëtari dhe vendimmarrësi kryesor këtu?*

Digjitalizimi në Rusi është nisur nga qeveria si pjesë e politikës së kontrollit. Të gjithë projektet digjitale federale që kemi sot nuk synojnë thjeshtimin e procesit burokratik, por forcimin dhe rritjen e zonës së kontrolluar dhe analizën. Kjo lejon përjashtimin e përfshirjes personale fitimin e disa pikëve besnikërie nëse mjeti



përdoret në mënyrën e duhur. Nga ana tjetër, edhe duke llogaritur të gjitha përpjekjet dhe investimet nga anët e qeverisë dhe investitorëve privatë, problemi kryesor këtu është mungesa e të kuptuarit se për çfarë mund të përdoren të gjitha këto projekte (që kushtojnë mbi miliardë rubla). Bëhet fjalë sidomos për qytetet e vogla, ku nganjëherë po përpiqen të zbatojnë zgjidhje me anë të politikave të mëdha.

*Cilat janë pjesët më të rëndësishme të rrjedhës/fazave të procesit modern krijimit të qyteteve inteligjente?*

Unë konsideroj pasjen e një grupi synimesh si fazën më të rëndësishme. Në këtë hap, ne duhet t'i përgjigjemi pyetjes 'si do ta ndryshojmë qytetin me teknologjitë digjitale?'. Së dyti është e rëndësishme vendosja e rregullave, baza ligjore dhe metoda për punën e ardhshme, kushtet financiare dhe nivelet e përgjegjësisë, gjë e cila është injoruar edhe nga Moska.

*Çfarë do të theksonit si risqet kryesore të qyteteve inteligjente?*

Rreziku më i madh këtu ka të bëjë me rrjedhjen e të dhënave personale. Për shkak të kostove të larta të sistemeve të mbrojtjes, ky problem bëhet shpesh rast i zakonshëm. Për shembull, të dhënat e vendndodhjes dhe gjurmimit të qytetarëve janë tashmë në dispozicion për çdo person të interesuar në Moskë. Tani kemi një diskutim të gjerë mbi privatësinë digjitale. Sidoqoftë, mendoj se një përqindje jashtëzakonisht e vogël e njerëzve kujdesen për gjurmët e tyre digjitale dhe janë të gatshëm të mbrojnë të dhënat e tyre duke përdorur mjete ligjore. Në përgjithësi, një person nuk mund të thotë 'Unë jam gati të ndaj të dhënat e mia' ose 'Nuk jam gati'; sot pjesa më e madhe e të dhënave është mbledhur pa marrëveshje nga ana e objektit të këtyre të dhënave. Për shembull, të dhënat e vendndodhjes së qytetarit mblidhen nga infrastruktura nëntokësore, sistemet e transportit, rrjeti i kamerave në rrugë, etj. Ata nuk kërkohet të bien dakord me këtë. Edhe nëse ata do të hidhnin celularin e tyre, kamerat në ndërtesa ose në ashensorë do të filmojnë të gjitha ndryshimet e vendndodhjes.

Ose le të shohim pasaportat e shëndetit që janë në disa vende të Azisë. Të dhënat që ata përdorin janë të arritshme. Edhe më shumë - pronari i pasaportës duhet të tregojë të dhënat e gjendjes së tyre shëndetësore për të patur qasje në pika të veçanta të qytetit dhe mallrave. Mendoj se kjo praktikë do të përhapet më tej.

*Si e vlerësoni këtë qasje nga një këndvështrim njerëzor?*

Unë nuk do të qëndroj në ndonjë këndvështrim të veçantë, sepse përparësitë këtu përqendrohen në mirëqenien e shoqërisë më shumë sesa në sigurimin e privatësisë së të dhënave personale. Kundërvënja ndaj kësaj paradigme është joefikasë tani, veçanërisht, në kushtet e pandemisë.

*Në këtë rast, një qytetar gjendet në situatën që edhe pse mund të mos dojë, i duhet të blejë një smartphone dhe të ngarkojë aplikacione të caktuara?*

Po, siç mund ta shohim nga rasti i monitorimit shoqëror (aplikimi i përdorur për kontrollin e mbylljes prej pandemisë në Moskë) edhe nëse personi nuk kishte një smartphone, ata u pajisën me një dhe u detyruan të instalonin programin e nevojshëm për të marrë pjesë në këtë sistemi monitorimi.

*Cila është frika juaj më e madhe për sa i përket konceptit të qytetit inteligjent?*

Siguria e të dhënave personale, rreziqet financiare si investimet joefikase shtetërore dhe shqetësimi i shtetit për qytetarin, emocionet dhe ndjenjat e tyre, etj. Kjo qasje, mbështetja e vendimeve tona në të dhëna dhe statistika i bën të gjithë njësoj të pamatur dhe në këtë mënyrë ne mund të humbasim tiparet lokale, diçka që e bën një qytet një vend të veçantë.

*Dhe cila është shpresa juaj më e madhe?*

Përfshirja, barazia dhe konkurrenca midis qyteteve. Teknologjitë digjitale e bëjnë këtë proces më kompleks dhe e përshpejtojnë atë. Aksesit në të dhëna për hulumtim është një shpresë tjetër që kam për qytetet inteligjente. Shkencëtarët tashmë kanë marrë një mori mjetesh të reja për përcaktimin dhe zgjidhjen e problemeve lokale.

---

Para se të shkojmë në intervistën e dytë që kemi në program, le të kujtojmë veten se Qyteti Inteligent nuk është vetëm një koncept digjital i optimizimit të proceseve urbane por projekti aktual i "rritjes së cilësisë së jetës së njerëzve". Edhe pse është mbledhja dhe analizimi i të dhënave të mëdha, ato ende bëhen nga njerëzit dhe për njerëzit.

Pikërisht për këtë këndvështrim ne do të flasim me ekspertin tonë të dytë - Dhuru A. Thadani, një arkitekt amerikan, me dekada praktike në planifikim urban, zhvillim dhe arkitekturë në të gjithë botën. Për dyzetë vitet e fundit, Z. Thadani ka mësuar, vënë njo-



huritë në praktikë, dhe është përpjekur të vendosë arkitekturën dhe urbanizmin tradicional në sytë e publikut. Ai ka qenë anëtar themelues i Kongresit për Urbanizmin e Ri (CNU) që nga formimi i tij në 1993. Ai ka qenë projektuesi kryesor i qyteteve dhe qyteteve të reja, rigjenerimit urban, rijetëzimit të lagjeve, kampuseve akademike dhe projekteve të dendësimit e mbushjes urbane.

*Kur vjen koha që një qytet të fillojë të shndërrohet në një qytet inteligjent?*

Vetëm pasi një qytet të ketë shteruar të gjitha zgjidhjet pasive për të përmirësuar cilësinë e jetës për banorët e tij. Vetëm atëherë duhet të shpenzohen investimet kapitale në teknologjinë inteligjente.

*Kush është nismëtari dhe vendimmarrësi kryesor këtu?*

Zakonisht, stafi i Planifikimit dhe Dizenjimit Urban të qytetit mbështetet nga administratorët dhe menaxherët e qytetit.

*Dhe cilët janë përfituesit kryesorë?*

Aktualisht, përfituesit kryesorë janë kompanitë që shesin teknologjitë, pa kuptueshmëri të lartë të formës urbane.

*Cili është roli i qeverisë në krijimin e qyteteve inteligjente? Dhe cili është roli i kompanive globale dhe lokale? Po qytetarëve?*





Qeveria është klienti që merr vendimet përfundimtare. Administratorët, qytetarët dhe dizajnerët duhet të kuptojnë që qyteti i zgjuar është një titull brendimi. Nuk e përmirëson cilësinë e jetës së banorëve. Ndërtimi i një parku të ri ose zone argëtimi në qytet nuk kërkon teknologji inteligjente. Shtimi i linjave të autobusëve në një zonë të pashërbyer mund të bëhet pa teknologji inteligjente. Zonimi për korridoret me shumë përdorime mund të lejojë dyqanet që ofrojnë nevoja ditore për t'u lokalizuar në një zonë të nën-shërbyer. Lejimi i banorëve të qytetit për të punuar nga shtëpitë e tyre ose për të drejtuar një biznes në vendbanimin e tyre ndihmon në plotësimin e të ardhurave të familjes dhe duhet të nxitet, për sa kohë që nuk ka ndotje toksike. Sigurimi i licencave për tregjet javore të fermerëve për të ndodhur në tokë publike brenda një lagjeje mund të luftojë mungesat ushqimore, ku banorët nuk kanë qasje në produkte të freskëta. Shtimi i trotuareve, korsive të biçikletave dhe ngadalësimi i trafikut nuk kërkon ndonjë teknologji inteligjente. Mbjellja e pemëve të rrugës dhe sigurimi i dritave të rrugës nuk kanë nevojë për teknologji të gjerë - maksimumi, mund të ketë sensorë të dritës që fikin dhe ndezin dritat kur dikush kalon. Nuk ka nevojë të monitorohet lagështia e tokës dhe ujitja e ujit për pemët e rrugës - nëse përdoren bimë vendase që lulëzojnë në klimën rajonale.

### *Çfarë do të theksonit si rreziqet kryesore të Qyteteve Inteligjente?*

Rreziku është që qytetet të investojnë financiarisht në teknologji inteligjente të qytetit kur nuk janë të nevojshme. Investimet me kapital të lartë në zgjidhjet teknokratike promovohen nga kompanitë që prodhojnë, instalojnë dhe monitorojnë këto teknologji me pak ose aspak shqetësim për cilësinë e jetës, formën urbane, jetën e komunitetit, shkëmbimin e mallrave dhe shërbimeve, ose krijimin e vendeve thelbësore të jetës urbane.

### *Cila është frika juaj më e madhe për sa i përket konceptit të qyteteve inteligjente?*

Teknologjia e qytetit inteligjent presupozon se njerëzit janë memecë dhe nuk mund të fikin dritat kur largohen nga dhoma. Është më mirë të arsimosh sesa të gjesh një zgjidhje të shtrenjtë që supozon se një person mesatar nuk mund të mendojë. Me kalimin e viteve, profesionet e ndryshme të dizajnit kanë zhvilluar një reputacion shumë të ulët në mendjen e publikut. Ka shumë arsye për këtë situatë, por kryesisht njerëzit nuk shërbehen. Shqetësimet e publikut duhet të dëgjohen dhe të përgjigjen gjithashtu, në vend që të bëhet një objekt që admirohet vetëm nga dizajnerë të tjerë. Kam frikë se projektuesit që promovojnë teknologji inteligjente, do të zhvlerësojnë shërbimet që arkitektët dhe planifikuesit ofrojnë, duke bërë pretendime të rreme. Ne duhet të promovojmë ide që e bëjnë jetën të sigurt dhe të qëndrueshme përmes arsyes së shëndoshë. Projektet e teknologjisë së lartë si qyteti Masdar kanë dështuar keq.

### *Dhe cila është shpresa juaj më e madhe?*

Unë i dua qytetet dhe e dua larmishmërinë urbane nga rajoni në rajon. Shpresa ime më e madhe është që të gjitha qytetet të lulëzojnë dhe të arrijnë potencialin e tyre maksimal, pa i lyer me ar të gjitha pajisjet mekanike që kërkojnë mirëmbajtje afatgjatë. Makineritë më efikase dhe të qëndrueshme janë ato që janë të fikura. Para se të vendoset një kabëll i vetëm me fibra optike, një "qytet inteligjent" duhet të planifikohet të jetë kompakt, i lidhur dhe i plotë.

Për të përfunduar këtë deklaratë, z. Thadani na propozoi të hidh-nim një vështrim në konceptet që ai bashkoi së bashku për vizionin e zhvillimit të qyteteve inteligjente.

### KONCEPTI I INTELIGJENCËS

Kompaktësia i referohet aksesit për të gjithë banorët në nevo-jat e tyre të përditshme, të arritshme në këmbë. Kjo do të thotë zonim me përdorim të përzier që lejon të jetosh mbi shitjen me pakicë dhe një përzierje të fortë të jetesës dhe vendeve të punës në mënyrë që vendet e punës dhe vendbanimet të jenë në afërsi.

I lidhur i referohet hyrjes së përshtatshme për të kaluar tranzitin brenda 400 metrave nga secila ndërtesë banimi; qasja në par-qe, hapësirë të gjelbër dhe argëtim; dhe lidhja me institucionet kulturore dhe qytetare.

I plotë i referohet një mjedisi të larmishëm multikulturor ku banorët me të ardhura të ndryshme dhe nga të gjithë grup-moshat janë të mirëpritur të marrin pjesë në aktivitetet e përditshme të komunitetit.

### KONCEPTI I SIGURISË

Para se të instalohet një kamera e vetme me qark të mbyllur, të gjitha hapësirat publike duhet të ballafaqohen nga ndërtesa që kanë dritare që duken në fushën publike. Vija e shikimit mid-is hapësirës private dhe hapësirës publike duhet të jetë e pa-penguar. Kjo është mënyra më efikase për të krijuar një mjedis të sigurt. Njëqind sy në rrugë janë shumë herë më mirë se çdo numër i caktuar kamerash.

Reduktimi i gjerësisë së korsive të trafikut ndihmon në uljen e shpejtësisë së automobilave, duke i bërë rrugët më të sigurta. Reduktimi i rrezes së një bordure në cep shkakton ndalimin për-para se të bëni një kthesë. Këto janë vetëm disa strategji që i bëjnë qytetet më të sigurta pa teknologji inteligjente.

### KONCEPTI I QËNDRUESHMËRISË

Para se të investoni në sensorë digjitalë të shtrenjtë të teknolog-jisë së lartë dhe sisteme monitorimi kompjuterik, vendndodhja e qytetit inteligjent duhet të jetë në afërsi të ujit të pijshëm të besueshëm dhe burimeve të freskëta të ushqimit. Produktet e freskëta nuk duhet të udhëtojnë në një distancë të gjatë për të ushqyer popullatën lokale.

Edhe pse llamba elektrike, ashensorët me shpejtësi të lartë dhe ajri i kondicionuar janë shpikje të jashtëzakonshme, secila ndërtesë duhet të projektohet për të përfituar nga drita natyrore dhe ajrimi i kryqëzuar, në mënyrë që brendësia të jetë e ban-ueshme gjatë ditës pa ndriçim artificial dhe të jetë e rehatshme për pjesën më të madhe të vitit, pa harxhuar energji në sistemet e ftohjes dhe ngrohjes.

Konsumatorët duhet të kërkojnë që të gjitha materialet dhe sistemet e ndërtimit të përfshira në ndërtesë të vlerësohen për koston e tyre potenciale të ciklit të jetës, përpara se të financojnë projektin, i cili zakonisht është një kredi hipotekore. Cili do të jetë shpenzimi aktual për të mirëmbajtur pronën gjatë gjithë kredisë?



Nëse këto rekomandime themelore të planifikimit nuk respektohen, atëherë pavarësisht se sa teknologji është e përfshirë në 'Qytetin Inteligjent, ajo do të jetë gjithmonë memece.

Për ta përmbledhur: duke u hedhur në teknologjitë e qytetit të zgjuar dhe duke i zbatuar ato kudo, është e rëndësishme të përdorësh një qasje kritike dhe të vazhdosh të pyesësh veten dhe të tjerët e përfshirë - a kemi vërtet nevojë të përdorim këto mjete për këtë rast? A mund të zëvendësohet nga metodat tradicionale apo analiza dhe mbledhja e të dhënave të mëdha është e domosdoshme për këtë situatë? Kush po përfiton nga procesi dhe kush është i gatshëm të marrë përgjegjësinë për një proces kaq masiv teknik? Të gjitha këto pyetje nuk mund të marrin përgjigje këtu, nga ne, por dëshirojmë t'ju frymëzojmë të mendoni për këtë dhe të përpiqeni t'u përgjigjeni atyre, të paktën, për veten tuaj.

Siç mund ta shohim nga këto dy intervista, ka dy anë të së njëjtës medalje. Me bërjen e qyteteve inteligjente që po përhapet gjerësisht në të gjithë botën, mbizotëron domosdoshmëria që ky proces të jetë ende në program. Pyetja dhe dyshimi për të është një reagim i drejtë ndaj evolucionit kompleks të teknologjive inteligjente. Një gjë interesante është se nëse do të kthehemi te shembujt e jetës reale, do të shohim se mekanizmat teknokratikë mund të përdoren jo vetëm nga qeveritë, siç mund të shohim në Rusi ose Kinë, por edhe nga kompanitë globale. Të parët e përdorin atë për forcimin e kontrollit shoqëror, e dyta - për ngritjen e fitimeve. Të dy i numërojnë njerëzit si burim i të dhënave dhe përfitimeve ekonomike, askush prej tyre nuk i llogarit njerëzit dhe qytetarët si karaktere njerëzore. Nga ana tjetër, ka kompani globale që po futen në këtë lojë të Inteligjencës si furnizues, por preferojnë të qëndrojnë pa emër duke marrë ende fitime të pabesueshme nga shitja e teknologjive.

Tani ju mund të bëheni të kuq, të digjeni përbrenda dhe mund të pyesni monitorin tuaj me zë të lartë: Pse nuk e ndryshojmë këtë, e marrtë dreqi?! '

Ne duam ta përfundojmë artikullin tonë me një listë të rekomandimeve bazuar në informacionin që kemi mbledhur. Ne analizuam të gjitha informacionet që kemi marrë, i përmbledhëm në përvojën e jetës dhe punës në kontekstin që kemi të Europës Lindore, por ka një pjesëz mendimi kritik që duhet shtuar. Ne i mirëpresim lexuesit tanë të hedhin një vështrim në rekomandimet tona në lidhje me zhvillimin e Qyteteve Inteligjente në kontekstin e Europës Lindore.

1. A duhet ta bëjmë këtë qytet inteligjent? Burimet ekonomike të qyteteve të Europës Lindore janë jashtëzakonisht të kufizuara. Për shkak të kësaj, duhet si fillim një fazë kryesore: të bëhet një analizë e gjerë e detajuar e territorit, e problemeve të tij dhe mënyrave tradicionale të zgjidhjes së tyre. Ne e dimë që shumica e autoriteteve lokale të Europës Lindore janë mjaft konservatore. Kështu që mund të kemi një specialist të pavarur si një person që mund të ndihmojë për të gjetur një vendim të thjeshtë krijues për problemet e vjetra të qytetit.

2. Nëse vendimi është marrë dhe strategjia e qytetit inteligjent është aprovuar për zbatim, rekomandimi tjetër i rëndësishëm është përqendrimi në qëllimet e kësaj strategjie. Vendosja e qëllimeve të veçanta nuk do të lejojë që mjetet teknokratike të përhapen në zonat në të cilat nuk kërkohet. Në BE burokracia është një proces i ngadaltë. Për të kapërcyer këtë boshllëk jo-produktiv, mund të jetë më mirë të fillohet me një kronologji të caktuar dhe vendosjen e synimeve.

3. Pastaj, në përputhje me qëllimet, zhvilloni bazën ligjore dhe kornizat e strategjisë për të përcaktuar ligjet rregullatore dhe njerëzit përgjegjës.

4. Vetëm pasi të jenë shteruar metodat tradicionale, vendosen qëllimet dhe zhvillohet baza ligjore; është koha për t'u marrë me përmbajtjen e strategjisë, e cila nuk mund të përshkruhet nga rekomandimet tona dhe mund të ndryshojë nga rasti në rast.

Këtu sugjerojmë t'i kushtojmë vëmendje të veçantë bashkësive lokale të cilat zakonisht lihen jashtë procesit, edhe pse ato mund të ndihmojnë në identifikimin e nevojave kryesore të territorit dhe sjelljen e një këndvështrimi personal në proces.

5. Rekomandimi i fundit që kemi këtu ka të bëjë me transparencën e procesit. Mbajtja e hapur e informacionit rreth zhvillimit të strategjisë së qytetit inteligjent do t'u sigurojë qytetarëve mënyra më të mira ligjore për ta kontrolluar atë dhe për të qenë të sigurt se fluksi përputhet me kornizat.



Sigurisht, krijimi i qytetit inteligjent nuk është aspak një udhëtim i thjeshtë por ka disa pika kyçe që do të dëshironim të përmendim në fund të artikullit tonë.

Siç pamë nga ekspertët tanë dhe shembuj globalë, ka njerëz, të cilët llogariten si numra dhe trajtohen si burime. Ne duhet të personalizojmë rrjedhën e qytetit inteligjent, procesin e zbatimit dhe duhet të personalizojmë vetë qytetin. Dukshëm, një problem i madh është mungesa e komunikimit efikas midis qeverisë dhe qytetarëve. Për të rregulluar situatën, disa teknologji inteligjente mund të përdoren për të optimizuar ndërveprimin me vendimmarrësit zyrtarë për të arritur një përmirësim real të nivelit të jetës. Megjithatë, nuk jemi të sigurt nëse do të funksiononte në mënyrën e duhur në realitetin e pakëndshëm të krizës demokratike të Europës Lindore.

Nuk ka dyshime që ne mund të përdorim mjete inteligjente në shumicën e qyteteve të Europës Lindore. Por a duhet të mbledhim të gjitha të dhënat dhe t'i mbajmë ato në mënyra të sigurt? A duhet vërtet të ndajmë secilin nga hapat tanë për të zbuluar se ku është më mirë të ndërtojmë një zonë të gjelbër? Apo të japim informacionin tonë shëndetësor për të marrë qasje në mallrat e qytetit? Para se të zbatojmë mjete inteligjente në të gjitha qytetet dhe të shpenzojmë para të shumtra për këtë ne rekomandojmë të sigurohemi që kemi kuptuar çfarë është informacioni privat sot dhe ku është kufiri i vërtetë midis kësaj dhe hapësirës personale që jemi gati të sakrifikojmë për mirëqenien e përbashkët.

Kjo ishte një tjetër pyetje që do të donim t'i përgjigjeshit vetë. Por teksa i përgjigjeni, ju lutemi, sigurohuni që t'i jepni përparësi vetes, privatësisë dhe lumturisë suaj.

## TRANSPORT INTELIGJENT PËR NJË QYTET INTELIGJENT

Masha Pashkova-Dzneladze

A keni kaluar ndonjëherë në rrugët e qytetit duke pyetur veten: kush i ka bërë trotuaret kaq të ngushtë? Kush vendosi të zhvendosë stacionin e autobusit nga vendi që ka qënë prej dekadash? Kush mori këtë vendim idiot për të prerë pemët dhe zgjeruar rrugët?

Epo, nuk je vetëm. Shumë prej nesh nuk i pëlqejnë vendimet e ndërmarra pa këshillim me banorët, ose pa shpjegime. Po ashtu, askush nuk po përpiqet të na bindë se vendime të caktuara janë të justifikueshme. Përkundrazi, protestat dhe peticionet tona thjesht nuk merren parasysh. Në shumicën e qyteteve të Europës Lindore, nuk ka bashkëbisedim mes bashkisë dhe qytetarëve. Për këtë arsye, nevoja dhe dëshirat e tyre janë të paplotësuara.

Unë kam jetuar në 3 qytete të mëdha deri tani, Tbilisi ku u lindi dhe u rrita, Praga, ku jetova për 2,5 vite dhe Beogradi, në të cilin u zhvendosa në shtator të 2019.

### Tbilisi

Mbaj mend kohërat kur në qytetin tim të lindjes, rruga ku unë jetoja ishte me dy drejtime. Paskëta, një ditë e kthyen në rrugë me një drejtim, një gjë shumë e çuditshme në sytë e mi kur isha e vogël. Në të vërtetë, shumë e më shumë rrugë po kthehen në një

drejtim, dhe në më shumë kryqëzime po vendosen semaforë me kohëmatës të cilët të detyrojnë të presësh për të kaluar rrugën edhe nëse nuk ka makina. Shumë e më shumë njerëz po migrojnë drejt kryeqytetit sepse qeveria nuk përkujdeset për rajonet e tjera, dhe po ndërtohen edhe më shumë ndërtesa të shëmtuara. Linjat e trameve, që dikur mbulonin të gjithë qytetin, u zhdukën në vitet '90, pasi njerëzit filluan të shesin metalet për skrap gjatë krizës së madhe ekonomike që erdhi pas luftës civile, marrjes së pavarësisë nga Bashkimi Sovjetik dhe futjes në kapitalizëm.

Për fat të mirë, në ditët e sotme në Tbilisi ekziston një metro, e cila ka dy linja, por është tërësisht e pamjaftueshme për gjithë popullatën, dhe as nuk mbulon gjithë lagjet e qytetit. Ekzistojnë disa autobusë, por shumë e më shumë "Marshrutkas" një mjetje e vendeve post-sovjetike, autobusë të vegjël të shëmtuar, tërësisht të përhumbshëm për këdo që është më i gjatë sesa 175 cm. Ata ndalojnë kudo në mes të rrugës, mjafton të tundësh duart në ajër (ashtu si njerëzit ndalojnë një taksì në filmat amerikanë) por rehatia në këto mjete ende mungon. Më përpara, kishte shumë kompani të vogla që konkurronin me njëra-tjetrën dhe prandaj ecnin me shumë shpejtësi për të 'kapur' sa më shumë pasagjerë të jetë e mundur. Tanimë, të gjithë Marshrutkas i përkasin Kompanisë së Transportit të Tbilisit – një monopoli në pronësi private që nuk kujdeset për pasagjerët ose për punonjësit. Këto "mini-buse" zakonisht janë plot dhe ngasin në një mënyrë të pasigurt.



Infrastruktura e biçikletave është praktikisht jo ekzistente. Në rastin më të mirë, në njërën anë të rrugës është një korsi biçikletash në disa prej rrugëve të qytetit. Pra, mund pak a shumë të lëvizësh në mënyrë të sigurt nga njëra anë tek fundi i një rruge tjetër. Disa njerëz kurajozë përdorin biçikletën në të gjithë Tbilisin, duke rrezikuar jetën e tyre. Është një linjë treni që shkon përgjatë gjithë Gjeorgjisë deri në Azerbajxhan, duke e përshkuar kryeqytetin nga veriu në juglindje, ka disa ndalesa brenda qytetit, të ndodhura pranë stacioneve të metrosë, por fatkeqësisht qeveria lokale mori vendimin për ta lëvizur nga qendra e qytetit në anën tjetër të detit të Tbilisit, pra duke e bërë shumë të papërshtatshme për këdo. Ka diskutime që kjo u bë për të shitur tokat ku kalonin linjat e hekurudhave. Një tjetër vendim 'inteligjent' i qeverisë vendore ishte të mbushnin kilometra të tërë tuneli të gërmuar ku linja e trëtë e metrosë ishte planifikuar. Në tërësi, sistemi i transportit të Tbilisit i shtyn të blejnë një makinë dhe njerëzit që nuk mund ta përballojnë, dhe kjo është rreth 65% e popullsisë së qytetit. Pra transporti mbetet një mekanizëm torture.

## Pragë

Kur u zhvendosa në Republikën Çeke dhe fillova të udhëtoja aktivisht përreth qytetit, isha vërtet e tronditur. Ekzistonka mundësia që sistemi i transportit të punojë, dhe të jetë faktikisht ... një sistem? Ka një metro, tram, autobusë, dhe trena që janë të ndërlidhur dhe të aksesueshëm nëpërmjet një metode të thjeshtë pagesash, që meqë ra fjala, u shpik nga Partia e Gjellbër (nëse po pyesje veten nëse transporti publik është çështje politike). Transporti është gjithnjë në kohë, është i pastër, dhe me hapësirë. Shumë rralë, gjatë orareve të pikut ke nevojë t'i kërkosh një ose dy njerëzve të lëvizin që të mund të dalësh. Çmimi është më shumë se i pranueshëm për cilësinë e shërbimit. Të gjitha stacionet janë të lidhura qartësisht dhe mirë dhe edhe nëse nuk ke smartphonë, mund lehtësisht të lexosh hartën që ndodhet në çdo stacion ku kalojnë autobusët, metroja e tramet si edhe ku shkojnë. Ose, mund të shkarkosh aplikacionin e transportit

çek dhe të kontrollosh lidhjen tënde me Google Maps. Po ashtu, mund të përdorësh teleferikun me të njëjtën kartë (*litacka*).

Mos më keqkuptoni, ka shumë aspekte ku transporti në Pragë ka vend për përmirësim! p.sh. lëvizja me biçikletë në qytet mund të jetë goxha e vështirë për fillestarët. Nuk ka shumë korsi biçikletash. Në disa vende ato janë të vizatuara, por më pas zhduken papritmas, duke ju lënë në mes të rrugës të pasigurt se ku duhet të kalosh. Mund të marrësh biçikletën në transport publik pas një pagese shtesë dhe falas në disa prej trenave. Sistemi i autobusëve të natës mund të përmirësohej gjithashtu. Por, gjendja në të cilën është transporti publik i Pragës duhet të jetë një shembull për kryeqytetet e tjera të Europës Lindore, vendimmarrësit e së cilave nuk marrin parasysh se lëvizshmëria e aksesueshme dhe e denjë është një e drejtë njerëzore.

## Beograd

Ardhja për të jetuar në Beograd ishte një eksperiencë emocionuese për mua, por pasi kisha jetuar në Pragë, përshtatja në kryeqytetin e qendëruar drejt makinave të Serbisë ishte e vështirë. Këtu, ashtu si në Tbilisi, njerëzit shtyhen të blejnë makina, të paguajnë për naftë, të qëndrojnë esëll në mbremjë, ose të ngasin makinën të dehur, si edhe të paguajnë gjoba për parkim në vendet "e gabuara". Ku tjetër do të parkojnë njerëzit nëse qeveria i shtyn të gjithë për të blerë makina?! Nuk mund të ketë po aq vende parkimi sa banorë në qytet. Çdo mëngjes, kur ecja nga apartment im drejt zyrës, për 30 minuta mund të shihja 4-5 policë të ndryshëm duke parë target e makinave e duke vendosur gjoba. Në Beograd fillova të bëhesha sërish shumë e matur. Nuk mund ta dish nga cili cep do të të vijë një makinë sepse të gjithë e kanë me nxitim. Dhe të them të drejtën, i kuptoj – po nxitojnë për të krusyer disa sekonda në çdo qoshe, sepse më pas, do të qëndrojnë për minuta të tëra, dhe ndoshta edhe një orë në zona të ndryshme të qytetit në trafik.

Problemi i Beogradit nuk është vetëm numri i madh i makinave dhe mungesa e transportit publik. Qyteti vetë ka elementë shumë të çuditshme planifikimi, p.sh. linjat e tramit në disa zona janë në mes të rrugës e në disa të tjera janë anash saj, që do të thotë se tramet janë të detyruara të ngasin më ngadalë se makinat. Po ashtu, makinat e parkuara shpesh ndërhyjnë me lëvizjet e tramit. Metroja po ndërtohet tani, e le të shpresojmë se do të ndërtohet siç duhet dhe do të ndihmojë për të tejkaluar trafikun e rënduar të qytetit. Të ecësh me biçikletë në Beograd, ashtu si në Tbilisi, është një sport goxha ekstrem. Megjithatë, shoh shumë njerëz duke i dhënë biçikletës, më së shumti në verë, por edhe në dimër.

### Mësime për t'u mbajtur mend

Çfarë mund të na mësojnë Tbilisi, Praga, dhe Beogradi për qytetet? Në, të gjëlberit, biem dakord së planifikimi urban duhet të ndodhë me përfshirje maksimale të banorëve të një qyteti të caktuar – duke qënë se këta njerëz janë ata që do të përdorin qytetin. Jo kushdo duhet të ketë një kualifikim në planifikim urban, por kushdo mund të shprehë nevojat e tyre dhe është detyra e qytetit t'i plotësojë ato. Paskëtaj, është detyra e planifikuesit t'i transferojë këto nevoja në ndërhyrje urbane dhe nëpërmjet këtyre ndryshimeve të kënaqë nevojat e lartpërmendura.

Një ndër çështjet më të mëdha me të cilat qytetet e Europës Lindore po përballen është shembja e sistemeve të transportit publik. Kjo është një nevojë që është mëse e dukshme për çdo vizitor. Në të gjitha qytetet e Europës Lindore ku kam qënë, transporti nuk është i përshtatshëm. Këtu do të shpjegoj se çfarë duhet të bëjë qeveria lokale për të transformuar transportin publik nga një mekanizëm torture në një shërbim që popullata mund të përdorë. Këto mund të përshkruhen në gjashtë të vërteta të thjeshta:

*E vërteta e thjeshtë # 1: Mungesa e transportit publik dhe infrastrukturës së duhur të biçikletave në qytet bën që banorët të blejnë gjithnjë e më shumë makina.*

Duket e thjeshtë apo jo? Si mund t'i fajësojmë njerëzit që nuk janë të gatshëm të qëndrojnë në autobusë kaq të mbushur me njerëz saqë edhe sikur të të bjerë të fikët nga mungesa e ajrit në gush-tin e Tbilisit ose Beogradit, nuk ka vend për t'u rrëzuar? Kur ka një përleshje në stacionet e metrosë për të hyrë dhe dalë nga makinat e trenave sepse ka shumë njerëz në to, blerja e një makine të vogël dhe të lirë duket se është një zgjidhje e lehtë. Ju keni automjetin tuaj personal dhe shkoni nga pika A në B pa pasur nevojë të mbështeteni te gjashtë të huaj të tjerë që qëndrojnë pranë jush. Përveç kësaj, jo të gjithë mund të blejnë një makinë, dhe edhe nëse do të kishin mundësi, bllokimet në trafik do të ishin të pafundme.

*E vërteta e thjeshtë # 2: Pavarësisht se sa i zgjeroni rrugët, nuk do të jeni në gjendje të plotësoni kërkesën gjithnjë në rritje të hapësirës së makinave.*

Thjesht nuk ka aq hapësirë në qytet. Edhe nëse do të kishte, ju duhet të merrni parasysh efektet shoqërore të rrugëve shumë të gjera në qytet. Për më tepër, është provuar që shtimi i korsive të makinave thjesht e bën përdorimin e makinave më tërheqës, në vend që të zvogëlojë sforcimin e trafikut (thjesht mendoni për qytete si Los Anxhelos). Pra, çfarë mund të bëhet? Një zgjidhje mund të jetë ndalimi i shpërdorimit të parave të taksapaguesve dhe në vend të kësaj, investimi i tyre në infrastrukturën e transportit; punësimi i profesionistëve për të studiuar qytetin dhe sjelljen e transportit dhe dalja në zgjidhjet më të mira të tranzitit masiv. Një zgjidhje tjetër është teknologjike. Në ditët e sotme, qytetet mbledhin të dhëna të shumta. Është shumë e lehtë të vlerësosh numrin e udhëtarëve në transport. Këto janë të dhënat ku planifikuesit mund të bazojnë vendimet e tyre në lidhje me numrat e autobusëve, frekuencën dhe vendndodhjet për linjat e reja të autobusëve / tramvajit, duke i bërë ato me kosto efikase.

*E vërteta e thjeshtë # 3: Transporti privat ngjan mirë*

Transportin privat e shoqërojmë jo vetëm me lehtësinë, por edhe me rehatinë. Sidoqoftë, biçikletat janë gjithashtu transport privat

edhe nëse për shumë nuk janë në radar. Një biçikletë ju jep të njëjtën fleksibilitet dhe pavarësi si makina. Të ngasësh është praktikisht falas. Sigurisht që jo të gjithë mund të pedalojnë 10 km në ditë. Kjo është arsyeja pse duhet të lejohet të marrësh biçikleta në transportin publik. Në këtë mënyrë njerëzit do të ishin në gjendje të kombinonin mjetet e disponueshme të transportit dhe të kishin më shumë itinerare dhe shanse për të shkuar në kohë. Njerëzit duhet të jenë të motivuar për biçikletë. Një shërbim i marrjes me qira të biçikletave do ta ndihmonte këtë dhe zgjidhjet inteligjente të qytetit si një hartë digjitale e stacioneve të qirave të biçikletave dhe korsive të biçikletave do të ishin një bonus shtesë.

#### *E vërtetë e thjeshtë # 4 Njerëzit duhet të dinë se ku po shkojnë*

Hartat në internet ndryshuan perceptimin tonë për qytetin, se si ne komunikojmë dhe udhëtojmë në të. Nëse duam që qytetarët të mos humbasin, duhet të sigurohemi që të krijojmë aplikacione që tregojnë transportin në kohë reale, dhe nëpërmjet tyre, të përcaktojmë lidhjet më të mira. Kjo duhet të përfshijë biçikletën si një opsion: hartë që tregon rrugët e biçikletave dhe i rendit ato sipas vështirësisë, pjerrësisë dhe kohës së udhëtimit (këto ekzistojnë tashmë në disa qytete, si ky: [mapa.prahounakole.cz](http://mapa.prahounakole.cz)).

#### *E vërtetë e thjeshtë # 5 Kombinimi i mjeteve të ndryshme të transportit shpesh e bën për rrugën më të shpejtë*



Prandaj, rrugët ekzistuese të trenave duhet të përfshihen në rrjetin e transportit të qytetit. Në shumicën e rasteve ato kalojnë nëpër qytet gjithsesi, kështu që ato janë një mënyrë e shpejtë dhe praktike për të lidhur qytetet e afërta. Para se të zbulojë lidhjen biçikletë + tren nga banesa ime në Pragë për në zyrën time, po shpenzoja deri në 1 orë në udhëtim me autobus + metro + autobus, në vend që të shpenzoja vetëm 25 minuta. Përmes së njëjtës logjikë, tragete dhe teleferikë mund të përfshihen gjithashtu në transportin e qytetit, në varësi të peizazhit të tij. Në këtë mënyrë, banorët mund të mbulojnë në pak kohë distanca të mëdha.

#### *E vërtetë e thjeshtë # 6 Njerëzve u pëlqen të ecin, nëse ka hapësirë për të ecur*

Pesë zbulimet e mëparshme çojnë në rikuperimin e më shumë hapësirë për këmbësorët. Në fakt, disa rrugë mund të rezervohen për këmbësorët dhe biçikletat, duke lejuar që të hyjnë vetëm ata shoferë makinash që jetojnë ose punojnë atje. Barcelona po zbaton këtë qasje me një sukses të madh - blloqet 3x3 për këmbësorë u bënë më të gjalla dhe më të sigurta.

Në vend të një përfundimi, unë do të doja të përshkruaj përsëri kriteret e një sistemi të mirë të transportit publik:

**I shpejtë** - ju lejon të mbulonit distanca të mëdha në kohë të shkurtër;

**I aksesueshëm** - bazuar fizikisht në vendndodhjen ose mundësitë tuaja

**I përballueshëm** - nuk duhet të jetë i shtrenjtë dhe duhet të ketë përfitime të veçanta për të varfërit.

**I pastër** - koshat e plehrave dhe pastrimi i rregullt bën që dikush të dëshirojë ta përdorë atë më shumë.

**I ndërlidhur** - ndërrimi ndërmjet llojeve të ndryshme të transportit duhet të jetë i lehtë. Le të shpresojmë se një ditë do të shohim zbatimin e këtyre zgjidhjeve në qytetet tona plotësisht.



## PYETËSORI PËR QYTETET INTELIGJENTE

Përgjatë procesit të përgatitjes së këtij publikimi, ekipi i redaksisë krijoi një pyetësor online, me qëllimin për të bërë bashkë ndjesi dhe mendime më të larmishme dhe personale përreth kësaj teme. Më poshtë do të gjeni përgjigjet që kemi marrë. Shijojeni!

Qyteti inteligjent është një qytet i pajisur me risi teknologjike për të mbledhur të dhëna në parametra të ndryshëm. Sipas mendimit tim personal, një qytet inteligjent do të ishte më i gjelbër në kuptimin se do të luftojë efektin e ishujve urbanë të ngrohjes dhe ndikimin e pritur të ndryshimeve klimatike.

Një qytet inteligjent është një qytet që e ben jetën e qytetarëve më të lehtë, më të shëndetshme, dhe më të pëlqyeshme. Elementë si gjelbërimi dhe parqet, këndet e lojrave, transporti publik dhe rrugët e sigurma janë thelbësore.

Një qytet inteligjent mbledh dhe përdor të dhëna për:  
-Përmirësimin e shërbimeve për njerëzit  
-Të kuptuar padrejtësitë sistematike dhe për t'i trajtuar ato.

### SIPAS MENDIMIT TUAJ, ÇFARË ËSHTË NJË QYTET INTELIGJENT? SI MUND TA PËRKUFIZOJMË? CILËT JANË PËRBËRËSIT?

Një qytet që përdor teknologjinë për të përmirësuar atë çka është tashmë mirë në qytet (rritja e aksesit në transport publik, demokratizimi i vendimmarrjes, dhe bërja e hapësirave publike më gjithëpërfshirëse).

Qytetet inteligjente përdorin shërbimet digjitale për:  
-Bërjen e shërbimeve publike më të aksesueshme dhe efikase.  
-Të lehtësuar pjesëmarrjen në vendimmarrjen në qytet (për shembull buxhetimin me pjesëmarrje).

Përbërësit kyç që përcaktojnë një qytet inteligjent janë qytetarët, teknologjia, dhe institucionet. Meqënëse shume prej zgjidhjeve bazohen në teknologji, unë besoj se teknologjia luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e një qyteti inteligjent. Ajo duhet të kënaqë nevojat e qytetarëve të cilat duhet të vendosen në qendër të konceptit të "qytetit inteligjent", në mënyrë që të sigurojë cilësinë më të mirë të jetës për të

Një qytet inteligjent është një qytet që siguron mënyra inteligjente për të trajtuar problematikat, duke përmirësuar jetën e qytetarëve, një qytet ku mundësitë janë të aksesueshme njësoj për të tërë, e një qytet që promovon kontroll demokratik pa përplasje të vlerave të qytetarëve.

Më shumë rrugë biçikletash për t'i siguruar mundësi njerzve të cilët duan t'i japin biçikletës drejt punës në vend se të përdorin makinat. Më shumë transport publik Sistem më i mirë i pagesës së transportit publik Sisteme inteligjente të kontrollit të trafikut

Ndërtesa të mbuluara me vegjetacion, çati të gjelbra, dhe më pak beton.

Përdorimi më efikas i infrastrukturës fizike.

Rrjet elektrik efikas shtëpi dhe ndërtesa që përdorin burime të rinovueshme të energjise

Sisteme drenazhimi ujrash & menaxhimi mbetjesh më të mira

### NË ÇFARË MËNYRE DO TË DËSHIRONIT QË QYTETI JUAJ TË BËHEJ MË "INTELIGJENT"? ÇFARË DO TË DËSHIRONIT TË KISHTE QYTETI JUAJ INTELIGJENT?

Promovimi i vullnetarizmit

Qytet më bashkëpunues, një qytet ku qytetarët janë parësorë ku ata kanë një rol kryesor në hartimin e politikave dhe vendimmarrjes.

ndërtimi i më shumë parqeve dhe këndeve të lojrave për fëmijët dhe kafshët

Internet publik

Burokracia në internet që do të kursente kohë. Një aplikacion ku do të mund të gjurmohet faturat dhe detyrime të tjera.

Sistem më i mirë online i pagesave qeveritare



**Jo-funksionale** – Qytetet shpesh shpenzojnë fondet publike për elementë “inteligjentë” të panevojshëm si për shembull këto kosha plehrash “inteligjentë” me panele diellorë. Në realitet, këto kosha janë shumë më të vështirë për t’u boshatisur, marrin më shumë hapësirë, dhe janë shpesh në vende që pengojnë njerëzit më aftësi të kufizuara për të lëvizur në qytet. Gjithashtu, çmimi për një prej tyre është rreth €5000.

**Jo-funksionale** – Muret për reklama digjitale me veçori “inteligjente” si kjo e cila të lejon të dërgosh kartolina nga Zagrebi në realitet nuk përdoren dhe zvogëlojnë sigurinë e trafikut rrugor kur vendosen në kryqëzime (si për shembull kjo në Zagreb).



**Funksionale** – Zagrebi ka një mbulim WiFi të hapur shumë të mirë në pjesët qendrore të qytetit. Të dhënat e hyrjes janë të gjendshme në kroatisht dhe anglisht gjë e cila e bën qytetin shumë më të aksesueshëm. Fatkeqësisht, si në shumë raste, ky element nuk është i disponueshëm jashtë pjesës qendrore të qytetit.



**S I T Ë -**

**Q Y T E T I  
I N T E L I G J E N T**

## SI MUND TË ORGANIZOHEMI PËR- RETH NJË QYTETI INTELIGJENT? #KËSHILLAFUSHATE

Elena Petrovska

Gjërat e para në fillim!

Me çfarë çështjeje doni të merreni në qytetin tuaj?


### Përcaktoni problemin dhe identifikoni ndryshimin që dëshironi të bëni

Takoni grupin tuaj dhe punoni në zhvillimin e një vizioni të përbashkët për qytetin që doni të krijoni – le të jetë ambicioz! Sapo të filloni të planifikoni një veprim, do të ishte mirë të përqendrohni në vetëm disa aspekte në të njëjtën kohë në mënyrë që të mbani të qartë mesazhin tuaj dhe veprimet e synuara.

Ndërkohë që identifikoni ndryshimin që doni, pyesni veten dhe grupin tuaj si më poshtë:

- Për cilat probleme jeni më me nerva?
- A ka njerëz të tjerë që ndajnë inatin dhe irritimin tuaj?
- A mund të mendoni për një zgjidhje praktike për këtë çështje?
- A do ketë kjo zgjidhje një ndikim të përhershëm në jetën e njerëzve?
- A krijon një ndryshim strukturor ose kulturor?

Përpiquni të gjeni zanafillën e problemit që doni të trajtoni – për këtë mund të përdorni metodologjinë e “Pemës së problemit”



Nëse doni të krijoni një zgjidhje që zgjat, (të eliminoni problemin në rrënjë), është e rëndësishme që të trajtoni simptomat / efektet (gjethet) e problemit. Do t'ju duhet të shihni faktorët që mbajnë lart problemin tuaj (trungu) dhe ta lidhni me historitë e thella të pabarazive (shkaqet rrënjësore).

### Përcaktoni kërkesat tuaja.

- Bëni të mundur që të merrni parasysh gjithë grupet e ndryshme të njerëzve në qytetin tuaj që janë ndikuar negativisht nga ky problem dhe të siguroheni se ka mjaftueshëm që ata të ndajnë mendimet dhe të shprehin nevojat e tyre..
- Nëse ju vetë nuk jeni drejtpërdrejt të ndikuar nga ky problem, mund të merrni rolin e aleatit. Në këtë rast, është veçanërisht e rëndësishme që njerëzve që ndikohen drejtpërdrejt t'u jepet përparësi në punën tuaj organizatore.
- Një mënyrë për të bërë të mundur që të krijoni kërkesa të forta për fushatën tuaj është t'i bëni ato S.M.A.R.T. (Specifike, të Matshme, të Arritshme, Realistike dhe të matura në Kohë). Mund të përdorni tipologji të ndryshme analizash, si për shembull SWOT, PESTEL, etj.

## Krijoni një strategji dhe ndani rolet.


Strategjia është një pjesë thelbësore e organizimit, sepse ju ndihmon të kuptoni sesi secili hap që ndërmerrni do t'ju çojë më pranë zbatimit të kërkesave tuaja. Një strategji mund të përcaktohet si metoda e ndërtimit të fuqisë së mjaftueshme për të ndikuar në një vendimmarrës për t'ju dhënë atë që dëshironi në qytetin tuaj. Kur flisni për strategji, duhet të përcaktoni pikat si në vijim:

- rolet e fuqishme në komunitetin tuaj
- palët e interesuara
- kërkesat
- synimet
- mbështetësit
- taktikat

Lojtarët kryesorë në veprimtarinë tuaj janë ata njerëz që mund t'ju ndihmojnë të bëni ndryshimin që dëshironi.

**Përbërësit** janë njerëzit të prekur drejtpërdrejt nga problemi dhe aleatët janë mbështetësit e tyre. Këta janë njerëzit që do t'ju ndihmojnë të ngrini fuqi për të ushtruar presion mbi një objekt - ky është një vendimmarrës me fuqinë për t'ju dhënë atë që dëshironi. Një objektiv dytësor do të ishte dikush që ka fuqinë të ndikojë tek vendimmarrësi.

**Palët e interesuara** janë të gjitha entet që mund të ndikohen nga veprimi juaj dhe / ose janë të interesuar në temë: Institucionet, individët, qeveria, organizatat, shoqatat, donatorët, media, përfituesit, kundërshtarët, shkollat, personazhet e famshëm, klubet sportive, kompanitë, ministritë, komuniteti akademik, etj. Duke marrë parasysh që mund të keni shumëllojshmëri të ndryshme të palëve të interesuara brenda audiencës tuaj të synuar, mund t'ju duhet të krijoni mesazhe të ndryshme për ta. Ju mund të përdorni grafikun e mëposhtëm për të kategorizuar sistematikisht palët e interesuara;



## Krijoni mesazhin

Mesazhi është ideja thelbësore që dëshironi që njerëzit të mbanjnë mend dhe të përsërisin për veprimin tuaj aktivist: fjalët, frazat, historitë dhe imazhet që përdorni për të komunikuar mesazhin tuaj.

Këto janë disa parime të dhënies së një mesazhi efikas:

- Përshtateni mesazhin sipas audiencës së synuar
- Përqëndrohuni në vlerat e përbashkëta mes jush dhe grupit të synuar
- Lidhini historitë me shembuj realë dhe personale
- Drejtojini audiencat drejt zgjidhjeve pozitive
- Përdorini statistikën me masë
- Përdorni referenca të kulturës popullore<sup>30</sup>

## Mobilizohu!

Ndërtimi i fuqisë kolektive është thelbësor për fushatën tuaj, sepse individët mund të kenë më shumë pushtet kur punojnë së bashku. Fuqia kolektive është fuqia që ka një grup duke punuar së bashku me një interes të përbashkët për arritjen e një qëllimi.

Ky process i angazhimit të të tjerëve përfshin:

- ndërmarrja e veprimeve për komunikim (tavolinë në komunitet tuaj urban, shpalljet publike, partneriteti me grupe të tjera, mediat sociale)
- ndërtimi i marrëdhënieve me anëtarë të rinj
- që anëtarët të jenë më të përfshirë, dhe
- zhvillimi i anëtarëve të rinj në lidera



## Përzgjidhni kanalet dhe mjetet tuaja

Kur ndërmerrni një fushatë, mos e lini angazhimin jashtë internetit pasdore. Në ditët e sotme, shumë materiale që përdoren në aktivitete jashtë internetit, ndodhen dhe në internet, gjë e cila ndihmon në arritjen tek një numër më i madh njerëzish dhe llojesh të ndryshmes grupesh të synuara. Për fushatat në internet, mund të përdorni mediat sociale, por kini parasysh se këto rrjete përdorin të dhënat tona personale dhe përdorin algoritmet që e bëjnë edhe më të vështirë të arrish audienca të reja. Megjithatë, një fushatë e fuqishme në mediat sociale mund të përdoret gjithashtu për të presionuar grupet e synuara dhe për t'i detyruar të veprojnë. Mund të përdorësh *Instagram, YouTube, Twitter, Facebook, V Kontakte, TikTok dhe Snapchat*. Mos e lini pasdore email-in si pjesë të komunikimit tuaj dhe përdorni kanalet në Telegram për të shpërndarë mesazhet tuaja dhe për të anëtarësuar mbështetës.

këshillë bonus: Kontrolloni disa nga këto platforma në internet për të krijuar/redaktuar materiale në internet: *Canva, YT cutter, Soundwise, HTML Image Color Codes, Colors, Voice2v, Filmora*.

Nëse vendosni të zhvilloni një fushatë në internet – bëni përpjekje shtesë në kërkimin e të dhënave, ligjeve dhe politikave të problemit që doni të trajtoni. Përshtateni mesazhin tuaj sipas politikave/ligjeve që doni të ndryshoni/ndikoni.

Për ta çuar këtë fushatë në rrugë, mund të punoni në organizimin e protestave në masë, performancave, mbledhjeve publike, paraqitjen e banderolave/posterave me mesazhin kryesor në një ndërtesë/urë. Për ide shtesë dhe frymëzim shihni theurban-activist.com. Me cilindo lloj veprimi urban që vendosni të shkoni, telefononi mediat (një ditë para aksionit) dhe përgatitni një njoftim për shtyp që do të dërgoni (duke ndjekur veprimin) për të gjitha mediat që nuk erdhën.

## Vlerësimi dhe hapat e ardhshëm

Pasi veprimi që kishit në plan u zhvillua, bëni një bashkëbisedim duke u ulur në një rreth me grupin/ekipin tuaj dhe diskutoni se çfarë shkoi mirë dhe çfarë mund të përmirësohet herën tjetër. Shënoni gjithçka dhe sillni përvojën tuaj në rritje në organizimin e ardhshëm nëpër qytetet tuaja!

Është e rëndësishme që të zgjidhni fitore të vogla për të cilat keni besim se mund t'i arrini dhe nuk do të shpenzoni shumë nga burimet tuaja. Arritja e fitoreve të vogla do t'ju ndihmojë të merrni vëmendjen e mbështetësve dhe të ndërtoni fuqi për të vazhduar të bëni presion për fitoren tuaj të madhe. Është e vështirë të parashikosh se sa kohë do të duhet për të bërë disa ndryshime. Disa fushata mund të kërkojnë shumë taktika për një periudhë të gjatë kohore për të krijuar përfundimisht një ndryshim të qëndrueshëm.

Nuk ka diçka të tillë si humbja kur bëhet fjalë për aktivizëm. Nëse përjetoni një prapambetje në punën tuaj, duhet të rigrupoheni me anëtarët tuaj dhe të shihni nëse strategjia juaj ka nevojë për rishikim.

Nuk duhet të hiqni dorë.  
Organizohu! Kundërshto! Tejkalo!



## PËRMBAJTJA E SESIONEVE

Kjo pjesë e publikimit kremton përpjekjet krijuese dhe intelektuale të ekipit organizues të cilët punuan në mënyrë të palodhur në zhvillimin e sesioneve për aktivitetin në Riga. Duke qënë se aktiviteti u anulua, ne vendosëm të ndajmë sesionet me publikun e gjerë. Korniza është shkruar për të mbështetur të gjithë ata që duan të organizojnë punëtori dhe aktivitete trajnuese në temën e qyteteve inteligjente dhe çështje të lidhura me këtë. Në përshkrimin e seksioneve mund të gjeni informacion të detajuar duke përfshirë metodologjinë dhe materialet që do t'ju ndihmojnë të përfytyroni sesi aktivitetet mund të zhvillohen.

### DITA 0

#### Tema:

Prezantimi dhe njohja me njëri-tjetrin

Kohëzgjatja: 70-90 minuta

Numri i pjesëmarrësve: 15-22

Materialet: 3 tasa/ kapele, letra ngjitëse për shënime<sup>31</sup>, stilolapsa, një mbulesë, disa tabela flipcharts, shënues.

Qëllimi: të sigurojë një hapësirë ku pjesëmarrësit mund të mësojnë mbi njëri-tjetrin, projektin dhe organizatorët

Metodologjia: kuiz *online/offline*, lojra, punë në grup

#### Udhëzimet:

1. Nxehja: Moderatorët e sesionit përgatisin një kuiz, online ose duke përdorur shënues flipchart. Pjesëmarrësve iu kërkohet t'i përgjigjen tri pyetjeve (pasi gjithësecili ndan përgjigjet, moderatorët dëftojnë informacionin e saktë ose shtojnë më shumë de-

<sup>31</sup> sticky notes

taje). Këto tri pyetje janë:

- 1) **KUSH** po e organizon këtë trajnim dhe çfarë dini mbi këtë nismë/organizatë?
- 2) Mbi **ÇFARË** metodologjie është bazuar trajnimi? Dhe çfarë dini për parimet dhe metodat e edukimit jo-formal?
- 3) **KUSH** po e zhvillon trajnimin? Kush janë anëtarët e ekipit organizator?

2. Pas kuizit, moderatorët ndajnë informacionet logjistike (si për shembull mbi vendin e zhvillimit të aktivitetit, akomodimi, programi, etj.) me pjesëmarrësit dhe prezantojnë të gjithë ekipin organizator.

3. Lojëra për thyerjen e akullit

- 1) **Loja e lëvizjes së emrit**: Të gjithë pjesëmarrësit qendrojnë në një rreth. Pjesëmarrësi i parë fillon duke thënë emrin e saj/tij ndërkohë që bën një lëvizje të caktuar. Pjesëmarrësi i radhës përsërit emrin/emrat dhe lëvizjen/t e mëparshme dhe më pas thotë emrin dhe bën lëvizjen e vet. Kjo gjë vazhdon deri tek pjesëmarrësi i fundit.
- 2) **Loja me çarçaf**: Një çarçaf i madh mbahet mes dy grupeve, ndërkohë që një prej lojtarëve të secilit grup qëndron pas çarçafit. Qëllimi i lojës është të jesh i pari që identifikon personin pas çarçafit, pasi ai bie. Skuadra fituese merr individin nga skuadra humbëse në grupin e tyre.
- 3) **Loja "Si je"**: Pjesëmarrësit ndahen në disa skuadra dhe iu kërkohet të japin përgjigjet e tyre për këto thënie një nga një. Këto fjali mund të jenë: "Vendi im i preferuar është..", "Nëse do të shkruaja një libër, do të ishte për..", "Nëse do të isha kryetar bashkie, vendimi im i parë do të ishte...", "Nëse do të mund të organizoja një aktivitet ndërkombëtar për të rinjtë, do të ishte për temën e ...", etj.

4) **Loja "Historia e kujt"**: Gjithësecili shkruan (me shkrim lehtësisht të lexueshëm) historinë e tyre më gazmore apo të çuditshme në një copë letër. Historitë hidhen në një kapele, e më pas përzgjidhen e lexohen me zë të lartë. Pjesëmarrësit përpiqen të gjejnë cila histori i përket kujt.



#### Tema:

Nata e lojërave

Kohëzgjatja: 90 minuta

Numri i pjesëmarrësve: 15-22

Materialet: informacioni jepet në përshkrimin e lojës në lidhjet (links) më poshtë

Qëllimi: të krijohet hapësira që pjesëmarrësit të njihen më njëri-tjetrin në një mjedis jo-formal dhe të thyhet akulli në komunikim.

Metodologjia: një lojë ndërvepruese

Udhëzimet:

Përpara se të fillojë loja, pjesëmarrësit ftohen të marrin pjesë në një lojë emri, për të kujtuar emrat e njëri-tjetrit.

Moderatorët organizojnë njëren prej këtyre lojërave: Rrëfenja e dy qyteteve (<https://www.coe.int/en/web/compass/tale-of-two-cities>) ose Një xhami në qytetin e përgjumur (<https://www.coe.int/en/web/compass/a-mosque-in-sleepyville>).



## DITA 1

### Tema:

Prezantim i përgjithshëm

Kohëzgjatja: 90 minuta

Numri i pjesëmarrësve: 15-22

Materialet: postera, flamuj, publikime të institucioneve që organizojnë projektin

Qëllimi: prezantimi i pjesëmarrësve me konceptet kryesore tematike dhe dhënia e një pasqyre të Grupeve të Punës<sup>32</sup>, punës së tyre, qëllimeve, etj.

Metodologjia: Kafeneja e Botës, reflektim individual, punë në grup

Udhëzime:

Moderatorët bëjnë një prezantim të projektit duke dhënë informacion mbi historinë e organizatës, qëllimin dhe objektivat si dhe rregullat e sjelles, metodologjia dhe anëtarët e ekipit organizator **[10 minuta]**.

Kafeneja e Botës: Moderatorët fillojnë duke prezantuar metodën e Kafenesë së Botës, duke shpjeguar mjedisin dhe rregullat e mirësjelljes.

Mjedisi/aranzhimi:

- 1) tavolina e Alterurb.
- 2) tavolina e Digital [X].
- 3) tavolina e CDN & GEF.
- 4) tavolina e programit.

Procesi fillon me katër raundet e para të prezantimeve 10-minutshë (e udhëhequr nga moderatorët) për grupe të vogla 4-5 persona të ulur përreth tavolinës. Në fund të 10 minutave, secili anëtar i ekipit lëviz në një tavolinë tjetër **[35 minuta]**.

Identifikimi i frikërave dhe pritshmërive: Pjesëmarrësit shprehin frikërat dhe pritshmëritë e tyre nëpërmjet një metodologjie online (p.sh. menti). Pasi gjithësecili ka folur, moderatorët ndajnë pjesëmarrësit në 4 grupe dhe i japin secilit grup 3 frikëra e 3 pritshmëri nga ato që u shprehën më parë, por pa i emërtuar ato. Më pas, këto histori lexohen me zë të lartë nga anëtarët e grupit ndërkohë që pjesëmarrësit përpiqen të gjejnë frikërat dhe pritshmëritë e lidhura me historitë. Pas gjithë këtyre, të gjitha frikërat e pritshmëritë mblidhen prej moderatorëve dhe shkruhen në tabela flipchart, lidhen me rregullat e sjelljes dhe kjo ndërlidhje shpjegohet me kujdes **[45 minutes]**.

### Tema:

Forcimi i shpirtit të skuadrës

Kohëzgjatja: 90 minuta

Numri i pjesëmarrësve: 15-25

Materialet: tabela *flipchart*, stilolapsa, fletë të printuara me detyrat për çdo grup, telefonë të karikuar,

Qëllimi: të ndihmojë pjesëmarrësit të punojnë si skuadër dhe të krijojnë rregulla për të punuarit sëbashku gjatë projektit; eksplorimi i qytetit gjatë aktivitetit

Metodologjia: loja në qytet "Mision i pamundur"

Udhëzime:

1. Moderatorët ndajnë konceptin e lojës me pjesëmarrësit, duke shpjeguar rregullat dhe qëllimet. Më pas, pjesëmarrësve u jepen detyra për të përmbushur brenda një kohe të caktuar, për t'u njohur me lagjen/qytetin, banorët, si dhe shtrirjen e qytetit të lidhura me temat e urbanizimit alternativ dhe qyteteve inteligjente **[10 minuta]**.

2. Loja **[45 minuta]**.

*Përshkrimi i lojës:*

Moderatorët fillojnë duke thënë: “Mirëmëngjes, grupi! E dijmë se keni ardhur në këtë trajnim të motivuar e të gatshëm të punoni sëbashku gjatë ditëve në vazhdim. Nëse do të vendosni të ndani detyrat tuaja në nëngrupe, numri më i vogël i anëtarëve të nëngrupeve duhet të jetë 5. Ju lutem të ktheheni në këtë vendtakim për 45 minuta! Misioni juaj i parë si grup sot – nëse do ta pranoni – është të arrini sa më shumë prej këtyre 12 detyrave në 45 minuta”

*Detyrat:*

- Krijoni disa nofka/pseudonime për gjithësecilin në grup. Vendoseni këtë nofkë në etiketat e emrave.
- Bëni 2 filmime (maksimumi 10 sek. të gjata) që paraqesin “aktivizimin urban”. Të gjithë anëtarët e grupit duhet të jenë në filmim.
- Bëni 3 fotografi të ndryshme të grupit, që përfshijnë të GJITHË grupin; në njërin prej tyre të gjithë duhet të keni diçka në kokë, në të dytën të GJITHË duhet të jeni në ajër, dhe në të tretën...na surprizoni! Ngarkojini këto foto në grupin tonë në Telegram.
- Qëndroni në rrugë dhe në 25 makinat e para që kalojnë, vini re raportin e burrave e grave që i japin makinës.
- Bëni 5 foto të zgjidhjeve të ndryshme të qyteteve inteligjente që do të mund të gjeni.
- Përdorni një prej këtyre zgjidhjeve të qytetit inteligjent. Bëni foto/filmim duke e përdorur/eksploruar atë.
- Bëni 5 foto-selfie të kamerave CCTV. Mund të bëhet nga një nëngrup.
- Gjeni kalimin këmbësor më të afërt dhe midis dy semaforëve masni:
  - sa makina kalojnë

- sa këmbësorë kalojnë
- sa biçikleta kalojnë
- sa motorrë të vegjël/motorrë elektrikë kalojnë
- sa zogj fluturojnë aty pranë

- Kaloni në pesë vija të bardha, bëni një veprim në secilën prej tyre
- Hartëzoni rrugën më të gjatë në një park aty pranë
- Përgjatë kësaj rruge hartëzoni dhe emërtoni çdo specie bime dhe shpend/kafshë që shihni dhe njihni. Përdorni një hartë digjitale për hartëzimin.
- Gjeni 3 ndërtesa të që janë ndërtuar në kohë të ndryshme. Bëni një foto të të trijave.
- Merrni tre plehra nga toka dhe hidhni në kosh. Dokumentojeni këtë veprim.

3. Përmbledhje/reflektim: Pjesëmarrësit reflektojnë mbi rregullat (rregullat e mirësjelljes) sërish dhe bien dakord për parimet që duhet të respektohen gjatë projektit, si për shembull të punuarit së bashku, mbështetja dhe respektimi i njëri-tjetrit, të lejosh të gjithë të shprehen dhe të marrin pjesë në diskutim, të jesh i pastër dhe i rregullt, etj. [35 minuta]be part of the dis-

*Pyetjet e sesionit të reflektimit:*

- Çfarë mund të thoni për qytetin/lagjen? (prezantim)
- Çfarë vutë re?
- Si u ndietë?
- Çfarë ju pëlqeu?
- A ishte përmbushja e misionit e vështirë? Nëse po, shpjegoni përse? thing?
- Cili ishte roli juaj? A ndryshoi?

- Cila ishte pjesa më e vështirë?
- Si shkoi puna në grupe?
- Çfarë parimesh duhet të përdorim për të punuar së bashku më së miri gjatë kësaj jave bazuar në eksperiencën tuaj me këtë aktivitet? (moderatorët i shkruajnë përgjigjet në një tabelë flipchart)

**Tema:**

Terminologjia dhe qasjet

Kohëzgjatja: 90 minuta

Numri i pjesëmarrësve: 20-25

Materialet: tabela flipcharts, stilolapsa, shënues<sup>33</sup>

Qëllimi: të bëjë të mundur që të gjithë pjesëmarrësit njohin dhe kuptojnë termat kryesorë dhe qasjet për sa i përket teknologjisë dhe qyteteve zgjuara; nxitja e pjesëmarrësve për të mësuar më shumë mbi rrëfenjën e qyteteve digjitale.

Metodologjia: punë në grup, diskutim në grupe të mëdha

Udhëzimet:

1. Prezantimi me programin e sesionit dhe aktivitetet në grup  
**[10 minuta]**

2. Pjesëmarrësit nahen në 5 grupe (4-5 veta për grup). Çdo grupi i jepet 4-5 koncepte dhe i jepet kohë për të reflektuar mbi to si dhe të krijojnë përkufizimet e tyre. Gjithashtu, secili grup duhet të japë së paku një shembull nga eksperiencia e tyre personale, sesi termat e diskutuara prej tyre përdoren në jetën e tyre të përditshme. **[30 minuta]**

*Termt/konceptet:*

- **të ardhurat bazike universale** (ndonjëherë të quajtura të ardhurat e qytetarit) është një e ardhur e garantuar, jo mbi bazë testimi, e mjaftueshme për të mbuluar nevojat bazike, që i

paguhet çdo individ, i cili është ligjërisht banor i atij shteti kombëtar.

- **çzhvillimi**<sup>34</sup> është një trajtë e shoqërisë dhe ekonomisë e cila ka për qëllim mirëqenien e të gjithëve dhe mbështet bazën natyrore të jetës. Është një lëvizje politike, ekonomike dhe shoqërore e bazuar në idetë e ekonomisë ekologjike, anti-konsumeriste dhe anti-kapitaliste. Është një projekt që përkrah tkurrjen e udhëhequr në mënyrë demokratike të prodhimit dhe konsumit, me qëllimin për të arritur drejtësi sociale dhe qëndrueshmëri ekologjike.
- **3. mobiliteti si shërbim** është ndërthurja e trajtave të ndryshme të shërbimeve të transportit në një shërbim të vetëm të mobilitetit, në dispozicion sipas kërkesës. Për të kënaqur kërkesat e klientit, një operator i MaaS (mobiliteti si shërbim)<sup>35</sup> ofron një listë të larmishme alternativash transporti, qofshin këto transporti publik, lëvizja me makina, sistemet e biçikletave me qira, taksitë, dhe makinat me qira ose një ndërthurje e këtyre.
- **banesat sociale** janë banesa të cilat janë pronë e qeverive vendore ose nga organizata të tjera të cilat nuk fitojnë të ardhura, dhe i jepen zakonisht me qira njerzve që kanë të ardhura të ulëta.



- **strehim i përballueshëm** janë banesat që janë të përshatshme për nevojat e familjeve me të ardhura të mesme ose të ulëta dhe me çmime të këtitilla që këto familje të mund të përballojnë shpenzimet e tjera minimale të jetesës si për shembull ushqimi, veshmbathja, transporti, kujdesi shëndetësor, dhe arsimimi. Me rregull, strehimi konsiderohet si i përballueshëm nëse kushton më pak se 30% i të ardhurave bruto të familjes.
- **plan i zonimit** është procesi nëpërmjet së cilit toka vlerësohet dhe çmohet për t'u përdorur si bazë për vendimmarrjet e lidhura me disponimin dhe shfrytëzimin e tokës. Kjo përfshin studime mbi efektet mjedisore të përdorimit të tokës, dhe ndikimin në komunitet.
- **përfshirja sociale, integrimi dhe izolimi shoqëror** – përfshirja sociale është procesi i përmirësimit të kushteve në të cilat individët dhe grupet marrin pjesë në shoqëri – përmirësimi i aftësive, mundësive, dhe dinjitetit të atyre në disavantazh si pasojë e identitetit të tyre. Izolimi social është procesi në të cilin individët pengohen (ose nuk kanë akses të plotë) nga të drejta të ndryshme, mundësi dhe burime që janë normalisht në dispozicion të anëtarëve të një grupi tjetër, dhe të cilat janë të drejta themelore për integrimin social dhe respektimin e të drejtave të njeriut në atë grup specifik (p.sh. strehimi, punësimi, kujdesi shëndetësor, pjesëmarrja civile, pjesëmarrja demokratike, dhe trajtimi ligjor).
- **Infrastruktura e gjelbër** është një rrjet i planifikuar strategjikisht i hapësirave natyrore dhe gjysmë-natyrore me veçori mjedisore të projektuara e menaxhuara për të dhënë një sërë shërbimesh ekosistemesh si në hapësira rurale, ashtu edhe urbane.
- **planifikimi me pjesëmarrje** përfshin orvatjet sistematike për të përfytyruar të ardhmen e dëshiruar nga komuniteti dhe **planifikimin** për atë të ardhme, duke përfshirë dhe mbrehur kompetenca të caktuara dhe kontributin e banorëve të komunitetit, liderëve, dhe aktorëve të përfshirë në process.

- **gentrifikimi** është procesi i ndryshimit të karakterit të lagjeve nëpërmjet dyndjes së banorëve me më shumë të ardhura dhe bizneseve. Prosesi i gentrifikimit është tipikisht rezultat i vëmendjes së shtuar ndaj një zone të caktuar nga njerëz me të ardhura më të larta që vijnë nga qytetet ose lagjet fqinje. Megjithatë, disa persona e shohin frikën nga shpërngulja, gjë e cila mbizotëron debatin për gentrifikimin, si një element pengues për qasjet e vërteta zhvillimore për shpërndarjen/përhapjen e të mirave të strategjive të zhvillimit urban.
- **ekonomia e platformave** është aktiviteti ekonomik dhe shoqëror i ndihmuar prej platformave. Platforma të tilla janë kryesisht lidhës online ose struktura teknologjike. Shembulli më i njohur është rasti i “platformave të transfertave”, të njohura gjithashtu si “lidhës digjitalë”. Shembuj të këtyre platformave janë Amazon, Airbnb, Uber, dhe Baidu. Një shembull i dytë janë “platformat e risive”, e cila ofron një strukturë të zakonshme teknologjike mbi të cilën të tjerët mund të ndërtojnë, si për shembull në rastin e shumë zhvilluesve të pavarur të cilët punojnë mbi platformën e Microsoft-it.




- **të drejtat digjitale** janë të drejtat njerëzore dhe ligjore që lejojnë individët të aksesojnë, përdorin, krijojnë dhe botojnë media digjitale ose të aksesojë e të përdorë kompjutera, pajisje të tjera elektronike, dhe rrjete telekomunikacioni.
- **siguria kibernetike**, shpesh i referohet kujdesit dhe veprimeve në dispozicion për të mbrojtur sferën kibernetike, si në fushën civile e ushtarake, prej kërcënimeve të mundshme që mund të dëmtojnë këto rrjete të ndërvarura, dhe infrastrukturën e informacionit.
- **të dhënat e mëdha**<sup>36</sup> është një term për mbledhjen e të seteve të të dhënave kaq i madh e kompleks, sa që bëhet e vështirë të përpunohen duke përdorur menaxhim databazash me dorë, ose programe tradicionale të përpunimit të të dhënave. Sfidat përfshijnë mbledhjen, kurimin, depozitimin, kërkimin, ndarjen, transferimin, analizimin, dhe vizualizimin.
- **interneti i gjërave** është një rrjet objektsh fizike të shumëllojshme të ndërlidhura që komunikojnë me njëra-tjetrën nëpërmjet mjeteve elektronike të mundësuar nga interneti, si për shembull ndriçues, termostate, kamera dhe sisteme të sigurisë së banesave, si dhe pajisje të tjera shtëpiake.
- **reja informatike** është një model i teknologjisë së informacionit (IT) për të mundësuar hyrje sipas kërkesës rrjetesh të volitshme në një grup të përbashkët burimesh të konfigurueshme kompjuterikisht (p.sh. rrjete, servera, magazina, programe, dhe shërbime) që mund të sigurohen e shkarkohen me mundim minimal menaxhimi ose ndërveprim me ofruesin e shërbimit
- **5G** është një teknologji e re eireless e cila mundëson një rrjet të ri që është projektuar për të lidhur të gjithë dhe gjithçka virtualisht, duke përfshirë makineritë, objektet dhe pajisjet. Është projektuar për të dhënë shpejtësi të dhënash shumë më të shpejta e me multi-gbps, latencë tejet të ulët, më shumë besueshmëri, fuqi maksimal rrjeti, disponueshmëri të rritur, dhe një shërbim më të njëtrajtshëm për më shumë përdorues.



- **të dhënat e hapura** janë të dhëna pa pagesë dhe gjërësisht të disponueshme për këshillim dhe ripërdorim, duke përfshirë këtu ripërdorimin për qëllime tregtare, me qëllim rritjen e transparencës dhe nxitjen e aktivitetit ekonomik
- **IA (inteligjenca artificiale)** i drejtohet sistemeve që pasqyrojnë sjellje zgjuara duke analizuar mjedisin e tyre dhe duke ndërmarrë veprime – me njëfarë shkalle pavarësie – për të arritur qëllime të caktuara.
- teknologjia e **zinxhirit bllok**<sup>37</sup> është teknologjia që lejon njerëzit dhe organizatat të bien dakord dhe të regjistrojnë në mënyrë të përhershme transfertat dhe informacionin në një mënyrë transparente pa një autoritet qendror.
- **qyteti digjital/inteligjent** është një hapësirë ku shërbimet dhe rrjetet tradicionale bëhen më efikase me përdorimin e teknologjive digjitale dhe të telekomunikimit në dobi të banorëve dhe bizneseve. megjithatë, qyteti inteligjent shkon përtej përdorimit të teknologjisë së informacionit e komunikimit (TIK) për përdorim më të mirë të burimeve dhe emetime më të ulëta gazesh. Kjo nënkupton rrjete me inteligjente të transportit urban, sistem ujësjellës dhe kanalizimesh të përmirësuar, dhe mënyra më efikase për të ndriçuar e ngrohur ndërtesat. Kjo nënkupton edhe administratë të qytetit më ndërvepruese dhe të përgjegjshme, hapësira publike më të sigurta, si dhe plotësimi i nevojave të një popullsie në plakje.

- **ndarje digjitale** – hendeku mes individëve, familjeve, bizneseve dhe hapësirave gjeografike në nivele të ndryshme socio-ekonomike në lidhje si me mundësitë për të aksesuar teknologjinë e informacionit e komunikimit (TIK) ashtu edhe me përdorimin e internetit për aktivitete të shumëllojshme.
- **sistemi i pikëzimit të qytetarëve**<sup>38</sup> – klasifikime të dhënash që ndërthurin të dhëna nga një shumëllojshmëri aktiviteteesh si online dhe offline që po kthehen në një mënyrë për të kategorizuar qytetarët, duke shpërndarë shërbimet, dhe parashikuar sjelljet e tyre të ardhshme.
- **vendimarrje e automatizuar** – Sistemi ADM është një kuadër socio-teknologjik që përmbledh një model vendimarrjeje, një algoritëm që përkthen këtë model në një kod informatik, të dhënat hyrëse që përdor ky kod-ose për të ‘mësuar’ prej tyre, ose për t’i analizuar për të aplikuar këtë model- dhe i tërë mjedisi politik e ekonomik që e rrethon këtë përdorim. Kjo nënkupton se vendimi në vetvete për të aplikuar këtë lloj sistemi për një qëllim të caktuar-si dhe mënyrën sesi është zhvilluar (p.sh. nga një ent publik ose kompani tregtare), e prokuruar dhe e shpërndarë – janë pjesë të kësaj strukture.



3. Prezantim në grup: të gjitha grupet u prezantojnë termat e tyre pjesës tjetër të pjesëmarrësve. Pasi secili grup ka prezantuar termat e tyre, moderatorët ftojnë pjesëmarrësit të shohin përkufizimet e përgatitura nga anëtarët e ekipit organizues. **[25 minuta]**

4. Diskutim në një grup të madh: **[15 minuta]**

*Pyetje për diskutim:*

- Si mendoni se këto terma/koncepte janë të ndërlidhura më qytetet inteligjente?
- Si ndikojne risitë teknologjike në planifikim urban?
- Sa terma të rinj mësuat? A mendoni se termat urbanistike janë të ndërlidhura më termat digjitale?
- Çfarë termash/konceptesh shtesë mendoni se mund të jenë të dobishme për ne?

**Tema:**

Tregimet për qytetet

Kohëzgjatja: 90 minuta

Numri i pjesëmarrësve: 20-25

Materialet: tabela flipchart, stilolapsa, letra shënimi me ngjitëse

Qëllimi: të njohë pjesëmarrësit më rrëfime të ndryshme mbi qytete digjitale dhe të zbulojë sesi këto qytete mund të promovojnë interesa të ndryshëm.

Metodologjia: punë në grupe, diskutimë në grupe

Udhëzime:

1. Moderatorët prezantojnë dy histori shumë të ndryshme mbi dy qytete digjitale, duke dëftuar në fund se në fakt bëhet fjale për të njëjtin qytet. Nga kjo histori, pjesëmarrësit do të mësojnë se ka shume histori/tregime për qytetet, por qytetarët duhet

të jenë gjithnjë tejet kritik në vlerësimin e këtyre tregimeve dhe të shohin përtej historive të tyre. Moderatorët shpjegojnë konceptin e Qyteteve të padukshme<sup>39</sup> [20 minuta]

### Tregimi 1:

*Do t'ju tregoj eksperiencën që përjetova një ditë javën e shkuar kur kuptova sesa shumë ndikim ka teknologjia në jetën time. Mora një ditë pushim nga puna për të kryer disa punë në qytet. Në një postim në Twitter të një prej anëtarëve të këshillit bashkiak pashë se tashmë në qytet kemi një mjet teknologjik të ri, nëpërmjet së cilit qytetarët mund të paguajnë faturat dhe të akesojnë edhe shërbime të tjera. Tashmë mund të paguaj faturat e ujit dhe energjisë elektrike për më pak se 3 minuta!*

*Duke qënë se makinën e kisha çuar për të rregulluar, mora transportin publik drejt qendrës. Nuk e kam përdorur transportin publik prej kohësh, por menjëherë vura re se mund të paguaj në makineritë elektronike duke përdorur celularin tim. Disa klikime më vonë dhe isha ulur rehat-rehat në transport publik. Zbrita në stacion dhe shkova drejt bashkisë së qytetit. Rinovimet e bëra së fundmi të ndërtesës së bashkisë më lanë mbresa të mëdha.*

*Kisha lënë takim online që më përpara, kështu që procesi ishte shumë më i thjeshtë se më parë. Çfarë çlirimi! Në holl nuk kishte tavolinë informacioni, por vetëm disa makineri të shndritshme. Iu afrova asaj që kisha më pranë dhe skanova kodin QR që më dërguan kur bëra aplikimin online.*

*Nëpunësi publik më dha të dhënat e mia të regjistrimit për pajisjen digjitale menjëherë pas i tregova kartën time të identitetit dhe vërtetimin e pagesës. Pas disa minutash kisha mbaruar punë dhe dola prej ndërtesës së bashkisë për të shijuar pjesën tjetër të ditës, nën rrezet e diellit. Ndërkohë që isha e ulur në një kafene, shkarkova po ashtu një aplikacion për të raportuar probleme me shërbimet bashkiake për të cilën më vunë në dijeni në bashki.*

### Tregimi 2:

*Sot është më në fund dita që pata mundësinë të shkoja në bashki. Kam punuar disa turne më shumë këto javë, kështu që nuk kam patur mundësi t'i kryej këto porosi më parë. Nuk kisha zgjidhje tjetër përveçse të merrja një pasdreke pushim sot, pasi nuk po më vinin më faturat, dhe pata frikë se mos do më ndërpresin energjinë elektrike. Ndërtesa e bashkisë është pak larg shtëpisë time kështu që duhet të marr autobuzin ose metronë.*

*Metroja është më e shpëstëtë kështu që vendosa të marr atë. Megjithatë, kur mbërrita në stacion, kuptova se kishin mbyllur vendin ku shesin biletat. E vetmja mundësi ishin makineritë rimbushëse. Duke qënë se nuk kisha kartë krediti me vete, e cila ishte e vetmja mundësi pagese tek makineritë, mu desh të ecja tre stacione në këmbë për te arritur tek stacioni ku mund të paguaja me para në dorë. Fatkeqësisht, duhej edhe të paguaja një tarifë shtesë, por nuk pata zgjidhje tjetër.*

*Hipa në tren dhe mbërrita në zyrat e bashkisë pas pak. Sapo mbërrita, kuptova se ndërtesa dukej disi ndryshe nga herët e tjera. Mesa duket, kane bërë disa rinovime dhe në holl vura re disa makineri të çuditshme, të cilat kërkonin një lloj kodi. U përpoqa të kërkoja ndihmën e dikujt, por nuk kishte njeri vërdallë. Më në fund, një person tjetër si unë, më shpjegoi se bashkia ka vënë në zbatim një plan veprimi për qytetin digjital, që do të thotë se tërë shërbimet tashmë janë në internet. Nuk munda as të caktoja një takim, sepse kjo u paska dashur të bëhet nëpërmjet internetit përpara se të vija te zyrat. Vendosa të shkoja te biblioteka për të hyrë në kompjuter duke qënë se nuk kisha një të tillë në shtëpi. Të them të drejtën, nuk e kuptova fare si funksionon kjo metoda e re, por ajo çfarë është e sigurt, është se do të më duhet të marr edhe një ditë tjetër pushim nga puna për takimin e rradhës dhe kjo do të jetë shumë e vështirë.*

2. Pjesëmarrësit ndahen në grupe dhe secilit grup i jepet të dëgjojë një podcast (Shëndeti publik, shërbimet publike, mjedisi, ekonomia). Secili grup duhet të vlerësojë në mënyrë kritike materialin e dhënë dhe ta përmbledhë në 3-4 pika kyçe sipas strukturës së përgatitur nga moderatorët **[30 minuta]**

#### Regjistrimet<sup>40</sup>:

##### 1.Shëndeti publik

<https://player.whooshkaa.com/episode?id=322821>  
(00.00-06.23)

##### 2.Shërbimet publike

Citylab episodi 8  
<https://www.bloomberg.com/news/articles/2019-02-26/tech-nopolis-citylab-podcast>  
(04.10-09:56 or 12.00-24.30)

##### 3.Mjedisi

<https://guidehouse.com/insights/energy/2018/beyond-the-electron-smart-cities-and-building2grid> (02.23-11:45)

##### 4.Ekonomia

Citylab episodi 1  
<https://www.bloomberg.com/news/articles/2019-02-26/tech-nopolis-citylab-podcast> (02.30-11:40)

#### Struktura:

- Jep një përmbledhje të ideve të regjistrimit (*podcast-it*) (2-3 fjali);
- Listo konceptet dhe fjalët kyçe (në letra shënimesh me ngjitesë);
- Përshkruaj avantazhet dhe disavantazhet kryesore;
- A janë diskutuar këto koncepte në sesionet e mëparshme

(konceptet AlterUrban+Digital)? Ku dhe në çfarë mënyre? Nëse jo, ku mendoni se këto koncepte mund të përfshihen?

Prezantimet në grup dhe diskutimi: Secili grup prezanton regjistrimet e tyre. Më pas, të gjithë pjesëmarrësit ftohen për një diskutim në grup. **[20 minuta]**

#### Pyetjet për diskutim:

1. A vini re ngjashmëri mes koncepteve të përdorura?
2. Si rrëfehen tregime të ndryshme? (fjalë të shpeshta, narrativat futuriste)
3. Cilat janë "arsyetimet kontradiktore"?
4. A fokusohen këto koncepte në shoqërinë e gjerë? Kush janë përfituesit kryesorë?

#### Tema:

Mbrëmja e organizatave

Kohëzgjatja: 55-60 minuta

Numri i pjesëmarrësve: 20-25

Materialet: tabela flipcharts, stilolapsa, shënues, karrige

Qëllimi: të krijojë një hapësirë që pjesëmarrësit të mund të ndajnë informacione rreth organizatave/nismave të tyre (vlerat, historia, synimet, etj. )

Metodologjia: energji-dhënës<sup>41</sup>, punë në grup

#### Udhëzime:

1. Energiser Shkulm ere i bazuar në faktet nga organizatat: Moderatorët i thonë pjesëmarrësve të ulen në një rreth. Karriget vendosen rreth dhe duhet të ketë një karrige më pak se numri





i pjesëmarrësve. Një nga pjesëmarrësit duhet të qendrojë në mes. Kushdo që është në mes thotë: Era e fortë shkulmon për...” dhe mbaron fjalinë duke thënë diçka të vërtetë për organizatën e tyre. Për shembull, “Era e fortë shkulmon për këdo organizata e të cilëve fokusohet në të drejtat digjitale”. Ndërkohë që individi në mes thotë fjalinë kushdo në rreth për të cilët fjalja është e vërtetë duhet të ndërrojë karrigen. Ata që mbeten në mes duhet gjithashtu të përpiqen të zënë një vend. **[10 minuta]**

2. Aktivitet në grup “Profili i organizatës”: Pjesëmarrësit ndahen në 4-5 grupe. Anëtarët e një grupi duhet të zbulojnë të përbashkëtat e organizatave të tyre dhe të përfytyrojnë si mund të dukej një organizatë e përbashkët e tyre, logoja, emri, aktivitetet, vlerat, etj. Më pas, secili grup prezanton “organizatën e tyre të re” në një mënyrë kreative **[45 minuta]**

## DITA 2

### Tema:

Përfshirja dhe të drejtat e qytetarëve

Kohëzgjatja: 90 minuta

Numri i pjesëmarrësve: 20-25

Materialet: stilolapsa, 5 tabela flipcharts, letra, letra shënimesh me ngjitës, shënues

Qëllimi: të rrisë ndërgjegjësimin e pjesëmarrësve mbi pajisjet digjitale të cilat mund të përdoren për të aksesuar të drejtat e qytetarëve

Metodologjia: punë në grupe, diskutime

Udhëzime:

1. Hartëzimi: pjesëmarrësit ndahen në disa grupe sipas kategorive: pjesëmarrja e qytetarëve, shëndeti publik, ekonomia, lëvizshmëria urbane, shërbimet publike **[20 minuta]**

Çdo grupi i jepet një letër ku ata të mund të shënojnë platformat digjitale të cilat ata përdorin në qytetet e tyre ose për të cilat kanë dëgjuar. Paskëta, grupet zhvillojnë një diskutim për 10 minuta ku pjesëmarrësit shkruajnë historitë e tyre. Pjesëmarrësit nxiten të ndajnë histori personale dhe eksperiencë nga qytete të ndryshme dhe sesi ata i kanë përdorur këto platforma për të kërkuar të drejtat e tyre **[10 minuta]**

Pyetje:

- Si i bënit këto veprime përpara se të ekzistonin platformat?
- Si e ndryshuan këto platforma jetën tuaj?

2. Analizimi i platformave duke përdorur parimet e Kartës: në të njëjtat grupe, pjesëmarrësit ftohen të analizojnë platformat bazuar në parimet e kartës **[30 minuta]**

*Parimet:*

- Promovimi i përfshirjes së të gjithë aktorëve në zhvillimin dhe zbatimin e teknologjive. Risitë duhet të marrin parasysh vlerat dhe nevojat e përdoruesve.
- Investim në qytetarinë teknologjike. Të punuarit së bashku me qytetarët për të krijuar hapësirë për eksperimente.
- Lëri njohuritë të lira. Mos e blloko teknologjinë në patenta. Përdor standard të hapur dhe përdor programe me kod të hapur.
- Mbro privatësinë dhe informacionet personale. Jepi qytetarëve akses mbi të dhënat e tyre dhe parandallo padrejtësitë sociale.
- Nda vetëm të dhënat që nuk mund të gjurmohen e lidhen me individët. Të dhënat të tilla janë të mira të përbashkëta. Ki parasysh se jo çdo njohuri mund të regjistrohet në të dhëna fizike.



- Puno për një infrastrukturë publike digjitale. Jepini ofruesve të shërbimeve, nismave qytetare, dhe bashkësive urbane një platformë të përbashkët. Teknologjia duhet të kontribuojë në qëndrueshmëri. Përdor të gjithë mjetet e politikave për të përshpejtuar shpërndarjen e teknologjisë së gjelbër. Siguroheni se qyteti ynë inteligjent nuk do të kthehet në një katastrofë mjedisore për të tjerët.
- Krijoh hapësira publike me gjallëri që krijojnë hapësirë për lëvizje dhe takime, dhe ku njëzëri nuk janë vazhdimisht të vëzhguar. Njihni të drejtën për lidhje njerzore kuptimplota.
- Promovo një ekonomi platforme të drejtë. Zbatoni politika të bëra posaçërisht për raste të caktuara për të mbrojtur vlerat publike.

3. Diskutim: pjesëmarrësit ftohen të reflektojnë dhe të diskutojnë së bashku platformat duke ndjekur këto pyetje udhëzuese. **[30 minuta]**

*Pyetjet:*

- Çfarë vutë re nga analiza e platformave?
- Cili është përdorimi i këtyre platformave? Si i përdorni këto platforma në jetën tuaj të përditshme?
- Cilat ishin idetë pas krijimit të këtyre platformave?
- Cili është qëllimi i tyre?
- Si lidhen këto platforma me jetën e vërtetë?
- Si e kanë ndryshuar jetën tonë?
- Sa të dobishme janë ato vërtet? A e kanë përmirësuar jetën tonë?
- Si organizohen platformat urbane dhe kush përfiton prej tyre?
- Cili është roli i tyre për të ardhmen e qytetit tonë?

**Tema:**

Ndarja digjitale

Kohëzgjatja: 60-90 minuta

Numri i pjesëmarrësve: 20-25

Materialet: përshkrimet e roleve të printuara në A4, gërshërë

Qëllimi: të rrisë ndërgjegjësimin e pjesëmarrësve për mungesën e aksesit në qytetin digjital nga grupe të ndryshme sociale

Metodologjia: lojë me role (Një hap përpara), diskutim

## Udhëzime:

1. Moderatorët i prezantojnë pjesëmarrësit me rregullat e lojës dhe krijojnë një mjedis të qetë. Ndërkohë, çdo pjesëmarrësi i jepet një rol, e shkruar në një copë letër që i jepet atyre (është e rëndësishme që pjesëmarrësit të mos i tregojnë rolet njëri-tjetrit). **[5 minuta]**

*Rolet e mundshme:***1. Një individ që nuk ka akses në internet**

Ti vjen nga një mjedis shoqëror me të ardhura të ulëta dhe nuk mund të përballosh të paguash tarifën e internetit. I vetmi vend ku ti mund të hysh në internet është në punë. Megjithatë, prej ngarkesës së madhe të punës që ti ke, nuk ke shumë kohë për të lundruar në internet. Zakonisht nuk ke shumë kohë të lirë, por edhe kur ke, e kalon me familjen ose duke parë televizor.

**2. Një individ i moshuar**

Ti je një burrë i moshuar, cili jeton vetëm në qytet. Fëmijët e tu jetojnë në një qytet tjetër dhe nuk vijnë shpesh për vizitë. Ti ke një celular smartphone, por nuk di shumë mirë ta përdorësh. Në të shumtën e rasteve, e përdor për telefonata. Ti nuk ke një kompjuter. Kohën e lirë e kalon duke lexuar gazetën ose duke punuar në kopësht.

**3. Një refugjat**

Ti je një refugjat në këtë shtet. Edhe pse mbërrite këtu një vit më parë, ende nuk e flet shumë mirë gjuhën. Ti jeton në një kamp refugjatësh.

**4. Një individ nga një komunitet minoritar**

Ti je pjesë e një komuniteti minoritar. Nuk e njeh shumë mirë gjuhën zyrtare të shtetit ku jeton. Shpesh, ti ndihesh i përjashtuar nga mundësia për pjesëmarrje në qytet si pasojë e barrierave të gjuhës. Gjithashtu, ti mendon se qeveria vendore nuk i merr komunitetet minoritare në konsideratë në proceset vendimmarrëse në qytet.

**5. Një individ që has vështirësi me teknologjinë**

Ti punon në një dyqan në qytet. Ti ke kompjuter dhe celular smartphone, por nuk je shumë i zoti me to. Je pak tip me të vjetrën, dhe parapëlqen ndërveprimet ballë për ballë. E ke pak të vështirë për t'u mësuar shpejt me teknologjitë e reja.

**6. Një individ me aftësi të kufizuara në shikim**

Ti je një person me aftësi të kufizuara në shikim. Ti punon si psikologe në një shkollë dhe jeton me motrën tënde por ajo punon me orare të gjata, kështu që nuk është shumë vërdallë. Ti ke dëshirë të marrësh pjesë në mënyrë më aktive në vendimmarrjen në qytet, por mendon se bashkia nuk i merr shumë parasysh këndvështrimet ndryshe të banorëve.

**7. Një profesore universiteti**

Ti je një profesore universiteti, në degën e shkencave politike. Ti je shumë aktive në çështjet politike dhe sociale të qytetit tënd dhe përpiqesh të informohesh për zhvillimet e tanishme në qytet. U entuziasmove shumë për platformën e re urbane online të prezantuar nga bashkia, por ti mendon se nuk ishte shumë e suksesshme. Komentet e bëra nga qytetarët në atë platformë nuk morën shumë reagime, dhe ti nuk vë re ndryshime në vendimmarrjen në qytet si rrjedhojë e këtyre komenteve.

**8. Një student**

Ti studion fotografi në një universitet në vend. Je aktiviste e të rinjtë e gjelbër dhe merr pjesë shpesh në aktivitetet e tyre.

**9. Individ me të ardhura të larta**


Ti vjen nga një familje me të ardhura të larta. Ti jeton në qendër të qytetit dhe punon si drejtore në një degë banke lokale. Të pëlqen të jesh e informuar gjatë gjithë kohës, kështu që ndjekja e lajmeve më të fundit është shumë e rëndësishme për ty. Ti i ndjek lajmet nëpërmjet internetit dhe ke abonim në platformat kryesore mediatike në vend.

**10. Individ me të ardhura të ulëta**

Ti vjen nga një familje me të ardhura të ulëta. Ti nuk ke kompjuter, e as celular smartphone. Zakonisht, informohesh për lajmet e fundit nga televizori, në mbremje. Shpesh, të duket sikur nuk mund të aksesosh çdo informacion lidhur me ngjarjet në qytetin tënd.

**11. Anëtare e këshillit bashkiak**

Ti je një anëtar/e e këshillit bashkiak. Ti kandidove si anëtare e pavarur në zgjedhjet e fundit dhe fitove. Ti ngre vazhdimisht zërin për të drejtat sociale dhe ke bërë të mundur zbatimin e shumë projekteve të reja në bashki.

**12. Individ që jeton në zona informale**

Ti jeton në zona informale. Ti zakonisht punon 10 orë në ditë tek një dyqan aty pranë. Nuk zotëron një kompjuter. Do të dëshiroje të merrje më shumë informacion për vendimet dhe nismat e qeverisë vendore, por e ke pak të vështirë të marrësh këtë informacion.

**13. Një person i sëmurë që ka nevojë të bëjë një vizitë tek doktor**

Ti vuan nga një sëmundje kronike. Të duhet të marrësh vazhdimisht ilaçe dhe ke nevojë për të takuar mjekun çdo gjashtë muaj. Shpesh, has vështirësi në vlerësimin e shërbimeve shëndetësore që ke nevojë, për shkak të proceseve tejet burokratike.

**14. Individ i komunitetit LGBT+**

Ti jë një individ i komunitetit LGBT+. Shpesh ndien se qeveria vendore nuk i përfshin të gjithë grupet në proceset vendim-marrëse. Ti dëshiron të luftosh për më shumë përfshirje dhe të drejta, por e ke shumë të vështirë të marrës informacion për qeverisjen lokale në qytetin tënd.

**15. Kryetarja e bashkisë**

Ti je kryetarja e bashkisë. Je rizgjedhur për një mandat të dytë. Gjatë këtij mandati, ti dëshiron të zbatosh më shumë projekte të qyteteve inteligjente dhe ke edhe mbështetjen e mazhorancës në këshill bashkiak.

**16. Pronar i një biznesi të vogël, që nuk di të përdorë shumë mirë platformat online**

Ti zotëron një biznes të vogël në qytet prej 10 vitesh tashmë. Kohët e fundit po has shumë vështirësi për të marrë tërë informacionin e nevojshëm për rregullat e bizneseve të vogla (de-tyrimet dhe të drejtat që të takojnë).

**17. Një person që sapo humbi punën dhe do të aplikojë për asistencë sociale**

Ti sapo humbe punën si infermier/e. Duket shumë e vështirë të gjesh një punë tjetër për momentin, prandaj ke vendosur të aplikosh për asistencën sociale. Por, aplikimi duhet bërë nërmjet internetit dhe ti nuk je aq i/e lumtur me këtë gjë. Informacioni nuk ishte shumë i qartë, dhe nuk kishte udhëzime. Gjithashtu, në bashki nuk të dhanë fare ndihmë për akisin në portal.

**18. Një individ para/tetraplegjik**

Ti je një individ para/tetraplegjik. Për shkak të ndryshimeve të fundit në bashkinë e qytetit, të gjitha aplikimet për shërbimet e ndryshme duhen bërë online. Vëllai yt po të ndihmon me aplikimin, por platforma shpesh paraqet probleme dhe do të doje më mirë të shkoje në zyrat e bashkisë për ta zgjidhur këtë çështje ballë për ballë.

**19. Pastrues/e**

Ti punon si pastrues/e. Sapo ke filluar një punë të re dhe duhet të dorëzosh disa dokumente tek punëdhënësi yt. Këto dokumente mund t'i marrësh vetëm në bashki, por për shkak të ndryshimeve të fundit, të duhet të bësh një aplikim online. U përpoqe të aksesojë platformën, por procesi ishte shumë i komplikuar dhe burokratik, kështu që thjesht hoqe dorë. E vetmja gjë që të duhej ishte një dokument, por nuk arrite dot ta marrësh!

**20. Një banor i paregjistruar në qytet**

Ti banon në këtë qytet, por për momentin ende nuk ke bërë regjistrimin. Statusi i rezidencës duhet të rinovohet çdo dy vite. Bashkia ka vendosur të bëjë disa ndryshime në procedurat për të cilën lexove online. Megjithatë, disa nga procedurat nuk janë shumë të qarta dhe nuk je i/e sigurt që mund të pyesësh për këto. Bashkia nuk ka dhënë kontakte për të bërë pyetje, apo hapësirë për të bërë komente.

### 21. Një individ që ka fëmijë që fillon shkollën këtë vit

Fëmija juaj fillon shkollën këtë vit. Është e nevojshme ta regjistroni në shkollë, por aplikimi mesa duket bëhet vetëm nëpërmjet internetit. Nuk jeni shumë familjar me mjetet digjitale dhe keni frikë se mos bëni ndonjë gabim.

### 22. Zhvillues

Ti je një zhvillues/e shumë i/e famshme në qytet. Me ndryshimet e zbatuara nga bashkia të duket pak konfuzuese, por skuadra jotë po përshtatet goxha shpejt me ndryshimet e fundit dhe gjithsesi, ti beson se nuk do jetë shumë e vështirë të mbash ritmin. Gjithashtu, gjërat duken shumë më mirë tani, sepse ke akses në shumë informacion që nuk e kishe më parë. Po mendon të përdorësh edhe vetë platforma të tilla për të reklamuar më shumë produktet e tua.

### 23. Një çift i ri që do të aplikojë për banesa sociale

Ju jeni një çift i ri. Ke dëgjuar se bashkia jep mbështetje financiare për strehim për familjet e reja. Megjithatë, procedurat duken goxha të vështira, dhe të komplikuar. Nuk jeni shumë familjar me mjetet digjitale, dhe keni pak frikë se mos nuk do të arrini të mbaroni aplikimin tuaj mirë. Bashkia nuk ka dhënë asnjë numër kontakti apo vend ku mund të bësh pyetje.

### 24. Një gazetar/e

Ti je një gazetar/e. Ke dëshirë të shkruash për çështjet urbane dhe mendon se pjesëmarrja në forumet e hapura do të të japë më shumë informacion dhe do të të ndihmojë për të krijuar më shumë kontakte. Po ashtu, po përpiqesh të marrësh më shumë të dhëna nga faqet e internetit me burim të hapur të bashkisë. Gjithsesi, ke përshtypjen se disa nga informacionet nuk janë tërësisht të besueshme dhe je i/e shqetësuar për çështjet e privatësisë së të dhënave në aksesin në internet të faqeve të qeverisë vendore.

2. Pjesëmarrësve iu jepet pak kohë për të lexuar rolin e tyre dhe për ta kuptuar atë. Pas kësaj, moderatorët japin disa pyetje udhëzuese që pjesëmarrësit të mund të reflektojnë mbi rolin e tyre dhe të ndërtojnë një përfytyrim të jetës së këtij karakteri në kokën e tyre **[10 minuta]**

Pyetje:

- Si ishte fëmijëria juaj? Në çfarë lloj shtëpie keni jetuar? Çfarë lloj lojrash keni luajtur? Çfarë pune bënë prindërit tuaj?
- Si është jeta juaj e përditshme tani? Cilat janë vendet ku shoqëroheni? Çfarë bëni në mëngjes, drekë dhe mbrëmje?
- Çfarë lloj stili jetese keni? Ku jetoni? Sa para fitoni çdo muaj? Çfarë bëni në kohën tuaj të lirë? Çfarë bëni për pushime?
- Çfarë ju gëzon dhe nga çfarë keni frikë?

Pasi pjesëmarrësit krijojnë vizionin për rolin e tyre, moderatorët i kërkojnë të qëndrojnë të heshtur dhe të rreshtohen pranë njëri-tjetrit.

3. Moderatorët tregojnë se ata do të përshkruajnë një ngjarje të caktuar dhe më pas do të lexojnë disa thënie/fjali të lidhura me këtë ngjarje. Nëse pjesëmarrësit besojnë se karakteri që ata luajnë në këtë lojë lidhet me këtë shprehje (me fjalë të tjera, nëse i përgjigjen me po fjalisë së thënë nga moderatorët) duhet të bëjnë një hap përpara. Përndryshe, ata duhet të qëndrojnë aty ku janë e të mos lëvizin. **[10-15 minuta]**

Ngjarja:

Bashkia e qytetit tuaj ka shpallur se do të digjitalizojë disa prej shërbimeve të tyre. Mund të aplikosh për këto shërbime nëpërmjet internetit dhe mund të marrësh gjithë informacionin po aty. Gjithashtu, tashmë ekziston edhe një aplikacion në celular ku mund të marrësh informacion për trafikun dhe mund të bësh ankesa për probleme të caktuara në lagjen tënde.

*Thëniet:*

1. Ti ndien se mund të shprehësh lehtësisht mendimet për vendimet në qytetin tënd;
2. Ti ndien se këndvështrimi yt merret parasysh në vendim-marrjet në qytet;
3. Ti mendon se mund të marrësh lehtësisht informacion për çështje të ndryshme në qytetin tënd;
4. Ti mendon se nevojat e tua janë pothuajse të plotësuara nga bashkia;
5. Ti ndien se mund të ushtrosh të drejtat e tua si qytetar;
6. Shërbimet në qytetin tënd janë mjaftueshëm të aksesueshme dhe ti mendon se ke mjetet e duhura për ta bërë këtë;
7. Ti mund lehtësisht të kuptosh dhe të përdorësh platformat e reja të bashkisë;
8. Ti mendon se është bërë shumë më e lehtë për të aplikuar për shërbime shëndetësore;
9. Ti ndien se të dhënat e qytetarëve përdoren në mënyrë të drejtë dhe të drejtat individuale mbrohen nga qyteti;
10. Ti ndien se bashkia ka ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të të përfshirë në proceset vendimmarrëse



4. Reflektim: moderatorët i ftojnë pjesëmarrësit të shënojnë pozicionet e tyre në fund të lojës.

5. Diskutim në grupe të vogla: Pjesëmarrësit ndahen në 5 grupe. Ndarja e grupeve bëhet sipas ngjyrës së letrës që ka çdo pjesëmarrës (ata me të njëjtën ngjyrë janë në grup bashkë). Secili grup diskuton një ose disa prej roleve: kush janë ata? si është jeta e tyre e përditshme? Më pas ata shkruajnë si mendojnë se një ditë në jetën e këtij karakteri mund të jetë. **[15 minuta]**

6. Diskutim në grup të madh. **[30 minuta]**

*Pyetje:*

- Si u ndietë përgjatë hedhjes së hapave përpara – ose jo?
- Për ata/ato që hodhën disa hapa përpara, në cilën pikë filluat të kuptoni se të tjerët nuk po lëviznin aq shpejt sa ti?
- A pati njeri ndjesinë se në disa momente të drejtat e tyre themelore njerëzore nuk u morën parasysh?
- A mund të gjeni cilat ishin rolet e njëri-tjetrit?
- Sa e lehtë apo e vështirë ishte të luaje një karakter tjetër? Si e përfytyruat karakterin e rolit që luajtët?
- A pasqyron kjo lojë, në njëfarë mënyre, shoqërinë reale? Në çfarë mënyre?
- Çfarë të drejtash njerëzore vihen në rrezik për secilin prej roleve? A mund të themi se të drejtat e tyre njerëzore nuk janë respektuar ose ata nuk kanë akses në këto të drejta?
- Si mendoni se projektet e qyteteve inteligjente ndikojnë në pabarazitë sociale?
- Si e përfytyroni jetën e përditshme të karakterit tuaj? A mund të përshkruani një ditë të jetës së tyre?
- Çfarë hapash mund të ndërmerren për të trajtuar këto pabarazi në “shoqërinë e re digjitale”?

**Këshilla:** Gjatë procesit të reflektimit e vlerësimit është e rëndësishme të eksplorohet si pjesëmarrësit njihen me karakterin rolin e të cilit/cilës duhet të luanin. A kanë patur ata/ato eksperiencë personale apo nëpërmjet burimeve të tjera (lajme, libra, apo tregime)? A janë të sigurt se informacioni dhe përfytyrimi për këtë personazh janë të besueshëm? Në këtë mënyrë mund të prezantoni konceptin e stereotipizimit dhe paragjyimit.

## DITA 3

### Tema:

Ku shkojnë paratë

Kohëzgjatja: 90 minuta

Numri i pjesëmarrësve: 20-25

Materialet: projektor, telefonë celular, disa kompjutera për punë në grup, kufje, stilolapsa, letra

Qëllimi: të zhvillojë tek pjesëmarrësit kuptimin e interesave kapitalistë pas qyteteve zgjuara dhe kush përfiton nga qytetet zgjuara



Metodologjia: prezantim (teori mbi temën), punë në grup me regjistrim podcast, prezantime në grup

Udhëzime:

1. Në fillim të sesionit moderatorët i kërkojnë pjesëmarrësve “Përse janë kompanitë e teknologjive të interesuara për zhvillimin e qyteteve?”. Moderatorët i ftojnë të gjithë të shprehin këndvështrimet e tyre dhe më pas të përgatisin një prezantim mbi historinë e këtyre çështjeve: kush janë lojtarët më të mëdhenj dhe sa të mëdhenj janë ata. **[20 minuta]**

2. Kërkim nëpërmjet podcast-eve të lidhur me temën e qyteteve inteligjente dhe ekonomisë: pjesëmarrësit ndahen në 3-4 grupe dhe secili grup merr një podcast për të dëgjuar. Pasi kanë dëgjuar një fragment të podcast-it pjesëmarrësit zhyten më thellë në temë pasi kanë bërë pak kërkim në internet mbi këtë çështje **[50 minuta]**

Podcast-et:

1) Jeta digjitale – Podcast i dizajnit dhe teknologjisë. Ankthi i ekonomisë së GIG

<https://podcasts.google.com/?feed=aHR0cDovL2ZIZWRzLnNvdW5kY2xvdWQuY29tL3VzZXJzL3NvdW5kY2xvdWQ6dXNlcnM6MTQ0NTQ5MzMvc291bmRzLnJzcw&episode=dGFnOnNvdW5kY2xvdWQsMjAxMDp0cmFja3MvNTQxMjcyMzk2&ved=-0CA8QzslCahcKEwjooenfr-DoAhUAAAAAHQAAAAQAQ> (03:34-8:27)

2) Jeta digjitale – Podcast i dizajnit dhe teknologjisë. Utopia-Tekno dhe Qyteti inteligjent Alfabet

<https://podcasts.google.com/feed/aHR0cDovL2ZIZWRzLnNvdW5kY2xvdWQuY29tL3VzZXJzL3NvdW5kY2xvdWQ6dXNlcnM6MTQ0NTQ5MzMvc291bmRzLnJzcw/episode/dGFnOnNvdW5kY2xvdWQsMjAxMDp0cmFja3MvMzQ0ODAlNTIiw> (4:48-09:02)

3) Yanis Varoufakis me profesor Noam Chomsky në NYPL, 16 Prill, 2016 | DiEM25

<https://www.youtube.com/watch?v=szlGZVrSAyc> (minuta 11.11-17.00)

Pyetje udhëzuese për diskutimet dhe prezantimet në grup:

- Cila është përshtypja juaj mbi atë çfarë është thënë?



- Cila është ideja kryesore që lidhet me temën tonë, paratë, qyteti dhe teknologjia?

Secili grup do të prezantojë podcast-in e tyre dhe do të diskutojë idetë e shprehura aty. **[20 minuta]**

**Tema:**

Çzhvillimi<sup>42</sup> dhe mjedisi

Kohëzgjatja: 75-90 minuta

Numri i pjesëmarrësve: 20-25

Materialet: shënues, stilolapsa, letra

Qëllimi: të eksplorojë sesi teknologjia mund të promovojë ekonominë e zhvillimit në qytete dhe si mund të përdoret nga komuniteti për të promovuar qëndrueshmëri

Metodologjia: prezantim ndërveprues në internet, kuize online dhe sondazhe, diskutim

Udhëzime:

1. Moderatorët përgatisin një prezantim online (nëpërmjet platformës Menti) që mbulon çështjet e mëposhtme: **[40 minuta]**

- Bazat e teorisë së çzhvillimit
- Çzhvillimi dhe teknologjia
- Çzhvillimi në qytete

Ndërkohë që bëhet prezantimi, pjesëmarrësit ftohen të marrin pjesë në disa kuize dhe sondazhe online si dhe të eksplorojnë raste studimore të lidhura me prodhimin e ushqimit, efikasitetin e qeverisjes publike, tranzicionin e energjisë dhe mobilitetit, dhe shëndeti publik në qytete **[20 minuta]**

2. Diskutim në grup / reflektim: pjesëmarrësit tregojnë përfytyrimin e tyre mbi çzhvillimin në kuadër të qyteteve inteligjente, reflektojnë mbi informacionet që iu dukën interesante gjatë prezantimit. **[15-30 minuta]**



## DITA 4

**Tema:**

Hartëzimi i njohurive dhe pavarësia e të dhënave

Kohëzgjatja: 90 minuta

Numri i pjesëmarrësve: 20-25

Materialet: shënues, stilolapsa, letra

Qëllime: të bëjë të mundur që pjesëmarrësit janë të ndërgjegjshëm për fuqinë e të dhënave dhe çfarë lloj të dhënash/njohurie aktorë të ndryshëm kanë nevojë/përpiqen të mbledhin në një qytet digjital


Metodologjia: punë në grup, diskutim

Udhëzime:

1. Moderatorët i prezantojnë projektin pjesëmarrësve **[00:05-00:20]**

Dreqërit e Schmoogle:

## Schmoogle Shmartest c(h)itty\*



## Kush jemi ne?

*Sidewalk Labs\*\** është një kompani fitimprurëse por e nxitur nga një mision i thellë, mbështetur nga Alphabet. Ky profil i vendos Sidewalk Labs në një pozicion veçanërisht të përshtatshëm për të marrë kthime afatgjata në investime, të kryejnë kërkim shkencor dhe punë zhvillimore më të fuqishme sesa zhvilluesi tipik, dhe të ndërtojë pjesëza të teknologjisë urbane shumë më thelbësore, që as tregu i lirë e as qeveria nuk mundet të bëjë, me qëllimin për të avancuar risitë nga të tjerët.

## Mbi projektin

Së bashku, ky ekip ka zhvilluar një qasje unike për "risitë urbane", përcaktuar gjerësisht si integrimi i përparimeve fizike, digjitale dhe të politikave në strukturë urbane për të përmirësuar cilësinë e jetës në qytete. Shumë më tepër sesa thjesht ndjekja e rasteve të izoluar të efikasiteteve të lidhura me "qytetet inteligjente", risitë urbane kërkojnë një qasje ndërdisiplinore të thelluar që vendoset në kryqëzimin e dy prej përcaktimeve të trendeve të shekullit 21: urbanizimi global dhe ndryshimi teknologjik.

Sigurisht, në propozimin e një projekti që përfshin teknologjinë digjitale si një mjet (midis shumë prej tyre) që ndihmon në nxitjen e risive, pyetjet në lidhje me mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave janë kritike. Sidewalk Labs pranon se informacioni i mbledhur në hapësirat publike duhet të vihet në përdorim për të mirën e përgjithshme-, e mbrojtur nga një proces i pavarur, transparent dhe i hapur për publikun, që kushdo të mund të punojë mbi to.

3. Një aftësi e pazakontë për të katalizuar zhvillimin ekonomik. Një aspekt i tretë që e bën Sidewalk Labs të veçantë është aftësia për të shfrytëzuar qasjen e saj në risitë urbane, si dhe marrëdhëniet e saj me Alphabet për të krijuar vende pune dhe industri të reja që çojnë në rritje ekonomike gjithëpërfshirëse - duke pranuar që të gjithë duhet të përfitojnë nga kjo qasje, duke planifikuar për prosperitet me barazi sociale. Google ka një histori të mirë-dokumentuar të veprimit si katalizator për zhvillimin e ekonomisë duke u zotuar të zgjerohet në rajon. Herë pas here, kur arrihet një masë kritike e të punësuarve në një qytet, kjo pasohet nga një rritje e konsiderueshme.

Ky është dhe momenti ku ne ju thërrasim ju, komunitetin!

- Ne duam që ju të jeni në qendër të këtij projekti!
- Si duhet të rregullohen të dhënat në të ardhmen për të krijuar risi gjithëpërfshirëse dhe vende pune?
- Ne duam ta përshtatim këtë projekt sipas nevojave tuaja dhe kjo është arsyeja pse ne duam të mësojmë më shumë për ju dhe ta vendosim komunitetin në zemër të projektit.

Ky është momenti për të dëgjuar zërin tuaj!

Na tregoni për të dhënat tuaja



*përmbledhja e prezantimit:*

Një kompani shumëkombëshe e bazuar në SHBA ka treguar interes për një ish-zonë industriale 12 akërshe (7 fusha futbollit) në zonën bregdetare të Schmoogle

Ata planifikojnë të investojnë 1.7 bilion euro në zhvillimin e kësaj zone si një "Qytet brenda qytetit", një zonë e cila do të shërbejë si një inkubator për teknologji të reja, që përfshijnë:

- Dhjetë ndërtesa të reja të zhvillimeve me përdorim miks, që përbëhet kryesisht prej mijëra njësisish banimi, si edhe hapësira tregtare dhe për zyra, e gjitha e bërë prej druri masiv
- Një propozim për të zgjeruar sistemin e tramit për t'i shërbyer lagjes së re
- Riprojektimi i rrugëve për të ulur përdorimin e makinave dhe të promovojë levizjen me biçikleta e në këmbë
- Vendosje e një Wi-Fi public, si edhe të sensorëve të tjerë për të mbledhur "të dhëna urbane" për të marrë vendime të mirëinformuara për strehimin dhe trafikun

- Propozim për të pakësuar gazrat serrë deri në 89 përqind
- Ndërtimi i zyrave të reja qendrore rajonale të kompanisë në këtë zonë

Brenda 20 viteve kompania pret të mbledhë 35 bilionë euro në investime private dhe mundësisht të krijojë 44 mijë vende pune. Gjithashtu, këto do të krijonin 4 bilionë në të ardhura prej taksash për qeverinë.

Pyetjet pasuese:

- Cilat janë dobitë e të dhënave, për çfarë të dhënash ka nevojë komuniteti?
- Çfarë lloj të dhënash mund t'i japim Schmoogle-it?

Aktori	Mbledh	Magazi- non	Përdor	Vizuali- zon	Akseson
Këshilltarë bashkiakë					
Organizata lokale të banorëve					
Punonjësit socialë në qeverinë lokale					
Bizneset vendase					
OJQ vendase të të drejtave njerëzore					

*Shembuj:*

Të ardhurat e qytetarëve, Popullsia, Tatimi i paguar sipas vendndodhjes, Inten-  
siteti i trafikut dhe lloji sipas zonës, Hapësirat e parkimit, Hapësira të gjelbërta,  
Info demografike sipas zonave, Modelet e konsumit, Parapëlqimet e votimeve,  
Rezultatet e votimit sipas zonave, Marrësit e ndihmës sociale, Ndërveprimet  
në internet të qytetarëve me qeverinë e tyre, Përdorimi i transportit publik, Të  
dhënat e krimeve, Të dhënat e cilësisë së ajrit, Modeli i përdorimit të energjisë

## 2. Të dhënat hyrëse për projektin [00:20-00:50]

Pjesëmarrësit ndahen në grupe. Atyre u kërkohet të kontrollojnë të dhënat që kanë, dhe të përgatisin përgjigje për këto pyetje:

- Çfarë të dhënash mund të jepen (të ardhurat, të dhënat demografike të përdoruesve, të dhëna sociale të komunitetit);
- Çfarë përfitimesh dhe disavantazhesh do të kishte ky projekt;
- Cilat do të ishin dobitë afatgjata e të dhënave që ky projekt mund të krijojë?

## 3. Produktet e projektit [00:50-01:20]

Pjesëmarrësit ftohen të shprehin mendimet dhe idetë e tyre në një diskutim.

*Pyetjet e diskutimit:*

- Cilat të dhëna duhet të jenë të fshehta dhe cilat duhet të jenë të hapura;
- Çfarë të dhënash duhen mbledhur, si mund të përdoren, kush do të përfitonte;
- Cilat të dhëna do të ndihmonin në pabarazitë, aksesin në shërbime;
- A do të mund shërbimet e përmirësuara dhe hapësirat publike të justifikojnë humbjen e të dhënave?
- A kemi zgjedhje për të mos ndarë të dhënat tona? (shembujt e Facebook, LinkedIn);
- Çfarë lloj të dhënash zotërojnë kompanitë e mëdha? (reflektim mbi punën në grup dhe çfarë lloj të dhënash janë kompanitë e mëdha të gatshme të japin);
- Çfarë kërkesash duhet që qyteti t'i vendosë projektit, a duhet ata të kufizojnë, rregullojnë mënyrën sesi ky projekt do të zbatohet?

## 4. Diskutimi pasues [01:20-01:30]

*Pyetjet për diskutim:*

- Çfarë lloj të dhënash kanë apo përdorin kompanitë private; a justifikohet kjo gjë?
- Cilët aktorë janë më të ndërgjegjësuar mbi pronësinë e të dhënave?
- Si mund të bëjmë që zhvillimi i projektit të ketë mbikëqyrje më të mirë demokratike?

**Tema:**

Klasifikimi/pikëzimi i qytetarëve


Kohëzgjatja: 90 minuta

Numri i pjesëmarrësve: 20-25

Materiale: laptop, udhëzues i printuar dhe kohështrirje për debatin

Qëllime: të prezantojë pjesëmarrësit me politika të ndryshme që mund të përdoren për të promovuar qeverisje më të mirë të të dhënave dhe qeverisje digjitale në qytetet e tyre

Metodologjia: debat



## Udhëzime:

1. Pjesëmarrësit ndahen në mënyrë rastësore në grupe interesi në parlamentin e qytetit. Njëri grup mbron thëniet pro e tjetri mban qëndrimin kundër. Pasi pjesëmarrësit janë ndarë, grupeve u kërkohet të krijojnë një emër për grupin e tyre. [10 minuta]

*Detyra e GRUPIT PRO:*

Të dashur parlamentarë, ju jeni një grup interesi në këshillin lokal që mbron qendrimin pro futjes së klasifikimit/pikëzimit të qytetarëve në bashkinë tuaj. Detyra juaj është të gjeni **argumente pro**, të bëni një deklaratë, dhe t'ia prezantoni qeverisë vendore (çdo prezantim vetëm 3 minuta).

Do të duhet të prezantoni një hyrje, e ndjekur nga një debat dhe një deklaratë përfundimtare. Kini parasysh se jeni të lejuar të bëni vetëm **argumente pro**. Gjatë debatit, vetëm një person për grup mund të ngrejë një argument.

*Detyrat e grupit kundër:*

Të dashur parlamentarë, ju jeni një grup interesi në këshillin lokal që mbron qendrimin **kundër** futjes së kategorizimit/pikëzimit të qytetarëve në bashkinë tuaj. Detyra juaj është të gjeni **argumente kundër**, të bëni një deklaratë, dhe t'ia prezantoni qeverisë vendore (çdo prezantim vetëm 3 minuta).

Do të duhet të prezantoni një hyrje, e ndjekur nga një debat dhe një deklaratë përfundimtare. Kini parasysh se jeni të lejuar të bëni vetëm **argumente kundër**. Gjatë debatit, vetëm një person për grup mund të ngrejë një argument.

2. Grupet kryejnë kërkim mbi pozicionin e tyre dhe përgatiten për debatin duke ndjekur pyetjet udhëzuese si më poshtë: [30 minuta]

*Pyetjet udhëzuese:*

- Çfarë nënkupton kjo gjë për qytetarët?
- Çfarë nënkupton kjo gjë për bashkinë?
- Nga ku vijnë burimet/paratë?

3. Grupet ftohen të bëjnë deklaratat e tyre hyrëse (10 minuta) të cilat do të pasohen nga një prezantim për çdo grup (3 minuta për çdo grup) **[16 minuta]**

4. Debat i hapur i moderuar nga anëtari i skuadrës organizatore. **[10 minuta]**

5. Grupet përgatiten për deklaratat përfundimtare (për 10 minuta) dhe do t'i prezantojnë në një tjetër raund prezantimesh: një prezantim për grup (3 minuta për prezantim). **[16 minuta]**

6. Pjesëmarrësit reflektojnë mbi debatin **[10 minuta]**

**Tema:**

A janë qytetet tona gati?

Kohëzgjatja: 90 minuta

Numri i pjesëmarrësve: 20-25

Materialet: stilolapsa, letra, letra shënimesh me ngjitës, 25 karta të kuqe e të gjelbra

Qëllimi: të ndihmojë pjesëmarrësit të analizojnë nëse qytete e tyre janë gati dhe nëse ato mund t'i përshtaten paradigmës së qyteteve inteligjente

Metodologjia: lojë me role, punë individuale, diskutim



## Udhëzime:

1. Loja në role: Moderatorët shpjegojnë rregullat e lojës. Pjesëmarrësit ulen në një rreth. Secili prej tyre ka një kartë të kuqe dhe të gjelbër për të votuar. **[10 minuta]**

2. Paskëtaj, moderatorët fillojnë të lexojnë deklaratat mbi qytetet inteligjente me zë të lartë, p.sh. "Në qytetin tim, qeveria vendore është e aftë të mbrojë privatësinë e të dhënave". Secili pjesëmarrës ngre kartën e kuqe ose të gjelbër në varësi të asaj çarë mendojnë për deklaratën në kontekstin e qytetit të tyre (e gjelbër=e vërtete dhe e kuqe=e gabuar). Përgjatë këtij procesi, pjesëmarrësit do të numërojnë përgjigjet e tyre pozitive (e gjelbër) dhe negative (e kuqe). **[30 minuta]**

## Dekaratat:

- Duke qënë se teknologjia ndikon mbi atë çka jemi dhe sesi jetojmë sëbashku, qyteti im bën të mundur që të ketë debat publik mbi qeverisjen demokratike
- Në qytetin tim, teknologjia dhe risitë marrin parasysh dhe zhvillohen krahas për krahas me vlerat dhe nevojat publike.
- Qyteti im promovon përshirjen e të gjithë aktorëve në zhvillimin dhe zbatimin e teknologjisë.
- Qyteti im mbështet risitë, laboratorët krijues<sup>43</sup>, dhe nxit qytetarët të ndërmarrin vetë masat e tyre përreth mjediseve ku jetojnë.
- Qyteti im përdor standarde të hapura për TIK dhe programe me burim të hapur.
- Qyteti im përdor teknologjinë për të sjellë qytetet sëbashku dhe për të promovuar takime dhe ndërlidhje mes tyre.
- Qyteti im i mbron qytetarët ndaj manipulimeve dhe bën të mundur që teknologjia të kontribuojë në një kulturë demokratike të gjallë.
- Qyteti mbron privatësinë dhe informacionin personal si edhe i jep qytetarëve kontroll mbi të dhënat e tyre.
- Qyteti im garanton që të dhënat e mbledhura nga osë në emër të qeverisë janë të disponueshme për këdo që të mund t'i aksesojë, përdorë, dhe t'i ndajë me të tjerë.
- Qyteti im bën të mundur që sistemet TIK të qeverisë respektojnë parimet e një administrate të mirë.
- Qyteti im angazhohet që të njohë të drejtën për korrigjimin qëndror të të dhënave: të gjitha të drejtat që një qytetar apo banor humbet për shkak të një akti administrativ duhet gjithashtu të jetë i kthyeshëm nga një akt i vetëm administrativ.
- Qyteti im ka algoritme të kontrolluar për paragjykim diskriminues, ndërsa vendimet e automatizuara janë të arsyetuara mirë në mënyrë që të mund të verifikohen nga qytetari (et) në fjalë.

- Qyteti im inkurajon infrastrukturën digjitale publike dhe ofron një platformë për ofruesit e shërbimeve, nismat e qytetarëve dhe bashkësitë urbane<sup>44</sup>.
- Qyteti im përdor tërë politikën e ndryshme për të përshpejtuar shpërhapjen e teknologjisë së gjelbër dhe bën të mundur që teknologjia të kontribuojë për qëndrueshmëri.
- Qyteti im angazhohet të shmangë varësinë e tepruar nga sistemet digjitale dhe të mbajë mundësi jo-digjitale për sisteme të tilla si ai i pagesës.
- Qyteti im investon në sigurinë kibernetike dhe vendos kërkesa të larta sigurie për furnizuesit e aplikacioneve digjitale.
- Qyteti im krijon hapësira publike të gjalla që ftojnë momente takimi dhe lëvizjve, dhe ku qytetarët nuk vëzhgohen vazhdimisht.
- Qyteti im njih të drejtën për një kontakt domethënës njerëzor brenda fushave të tilla si kujdesi shëndetësor dhe arsimit.
- Qyteti im bën të mundur që kontakti me qytetarët në zyrat qeverisëse, si online dhe offline, paraqet mundësinë për të çuar në ndryshime vendimmarrjesh në bashki.
- Qyteti im ka për qëllim të tejkalojë ndarjen digjitale dhe të japë shërbime bazike digjitale për njerzit me aftësi të ulëta të tyre.
- Qyteti im angazhohet për të luftuar ndarjen sociale dhe të sigurojë një shpërndarje të drejtë të të ardhurave, pasurisë dhe strehimit.
- Qyteti im zbaton politika të përshtatura posaçërisht sipas rastit për të mbrojtur vlerat publike.
- Qyteti im promovon një ekonomi platforme të drejtë duke mbështetur apo krijuar platforma bashkëpunuese dhe jo për përfitim tregtar.

3. Pasi të gjitha deklaratat janë lexuar, pjesëmarrsit ftohen të reflektojnë individualisht mbi rezultatet e tyre dhe të shkruajnë zgjidhje/vizione të mundshme për deklaratat që duhen trajtuar në qytetet e tyre. **[20 minuta]**

4. Diskutim. **[30 minuta]**

*Pyetjet për diskutim:*

- Çilat janë disa shembuj të mirë të veprimeve dhe nismave në qytet që mund të ndash me të tjerët (pra, aty ku ngrite letrën e gjelbër)?
- Cilat mendoni se janë pengesat kryesore për të arritur veprimet e përshkuara në deklaratat e mëparshme në kontekstin e qytetit tuaj?
- Cili nga aktorët mendoni se luan rol kryesor në bërjen e një qyteti rezistent dhe inteligjent? Cilit prej tyre i mungon qëndrimi aktiv dhe zëri?
- Cilat janë mekanizmat politikë që në mendimin tuaj mund të jenë të dobishme në trajtimin e deklaratave të shënuara me të kuqe në kontekstin vendor dhe mbarëvajtjen/promovimin e të gjelbrave në nivel kombëtar?
- Çfarë deklaratash/indikatorësh do të shtonit në këtë listë për të shënjuar/përkufizuar qytetin tuaj si inteligjent dhe rezistent?
- Cila do të ishte thirrja juaj për veprim ndaj qeverisë së qytetit për adresimin e sfidave në lidhje me rezistencën e qytetit, afatshkurtër dhe afatgjatë?
- Cilat janë fushat (ekonomia, mjedisi, qeverisja, shoqëria) që do të fokusoheshit së pari dhe para së gjithash? Shpjegoni përzgjedhjen tuaj.
- A mendoni se qyteti juaj është gati?

### **Tema:**

Pikënisja e shkrimit të Manifestos

Kohëzgjatja: 90 minuta x 3 sesione

Numri i pjesëmarrësve: 20-25


Materialet: stilolapsa, tavolina, tabela flipcharts, printime

Qëllimi: të sigurojë një hapësirë që pjesëmarrësit të mund të skicojnë ndryshimet në kontekst për sa i përket konceptit të Qytetit Inteligent mes qyteteve të Europës Lindore dhe Perëndimore dhe bazuar në atë, të hartojnë një listë kërkesash sesi aktivitetet për qytetet inteligjente të mund të zbatohen në qytetet e Europës Lindore.

Metodologjia: Kafeneja e Botës

Udhëzime:

1. Kafeneja e botës: Moderatorët fillojnë duke prezantuar metodologjinë e Kafenesë Botërore, vendosjen e kontekstit dhe ndarjen e rregullave të sjelljes së Kafenesë. **[10 minuta]**





Mjedisi:

- 1) Tavolina e përfshirjes
- 2) Tavolina e qeverisjes.
- 3) Tavolina e mjedisit.
- 4) Tavolina e ekonomisë.
- 5) Tavolina e Kartës së Qytetit Inteligjent.

2. Procesi fillon me 4-10 minutat e para të prezantimeve (e drejtuar prej një moderatoreje/mikpritëse) në grupet e vogla të 4-5 njerëzve të ulur përreth tavolinës. Në fund të 10 minutave, çdo anëtar i grupit lëviz në një tavolinë të re. Moderatorët i udhëzojnë pjesëmarrësit duke bërë pyetje reflektuese dhe duke përmendur mesazhet kyç nga çdo session, ndërkohë që pjesëmarrësit reflektojnë mbi atë çka ata mësuan gjatë ditëve paraardhëse. **[40 minuta]**

3. Moderatorët prezantojnë rezultat e Kafenesë Botërore (ide të që u shkruan/përmendën nga pjesëmarrësit në fushat e ndryshme tematike). Paskëtaj, pjesëmarrësit ndahen në disa grupe për të shkruar manifeston. Secili grup do të punojë për vizionin dhe kërkesat në kontekstin e temës së dhënë nga Kafeneja Botërore. **[10 minuta]**

Moderatorët bëjnë një prezantim të hyrjes së shkrimit të manifestos (thelbi, struktura, qëllimi). Në fund të prezantimit, pjesëmarrësve u jepet një listë e shkurtër me pika për të mbajtur mend ndërkohë që punojnë për manifeston. **[30 minuta]**

## DITA 5

**Tema:**

Prezantimi dhe votimi i manifestos

Kohëzgjatja: 90-120 minuta

Numri i pjesëmarrësve: 20-25

Materialet: laptopë

Qëllimi: Të japë një mundësi që pjesëmarrësit të mund të praktikojnë miratimin demokratik të manifestos

Metodologjia: prezantim, votim

Udhëzime:

1. Moderatorët paraqesin një përmbledhje të sesionit për pjesëmarrësit dhe diskutojnë qëllimin e këtij procesi demokratik, formën e amendimeve dhe ku të fokusohen gjatë prezantimit **[15 minuta]**

2. Prezantimi i manifestos: pjesëmarrësit prezantojnë sesionet e tyre përkatëse të manifestos. Pjesa tjetër e manifestos do të prezantohet nga moderatorët. **[25 minuta]**

3. Amendimet: Moderatorët shpjegojnë si amendimet do të funksionojnë (llojet, mjetet e përdorura). Më pas, pjesëmarrësit do të kenë kohë për të lexuar dokumentin me kujdes dhe të hartojnë amendimet e reja. **[30 minuta]**

4. Votimi dhe përshtatja. **[50 minuta]**



**Tema:**

Vlerësimi

Kohëzgjatja: 90 minuta

Numri i pjesëmarrësve: 20-25

Materialet: stilolapsa, formularë vlerësimi të printuara, letra dixit (ose ndonjë letër tjetër vizualisht të bukura)

Qëllimi: të krijojë një hapësirë që pjesëmarrësit të mund të reflektojnë mbi trajnimin dhe eksperiencën e tyre përgjatë tij

Metodologjia: pyetësor, aktivitetet përmbyllës

Udhëzime:

1. Pjesëmarrësit plotësojnë një pyetësor. **[30 minuta]**

Pyetjet e pyetësorit:

1. Si do ta vlerësonit programin dhe aktivitetin në përgjithësi? Çfarë mendimi ke për rrjedhën e sesioneve?
2. Si do ta vlerësonit metodologjinë e përdorur në këtë aktivitet? A ishin metodat e përdorura të përshtatshme për nevojat tuaja të të mësuarit?
3. A mendoni se metodat ishin mjaftueshëm të larmishme?
4. Cili ishte sesioni juaj i preferuar dhe përse?
5. Cili ishte sesioni më pak i preferuar prej jush dhe përse?
6. Si do ta vlerësonit procesin e zhvillimit të manifestos? A keni plan për ta përdorur manifeston; a do ia prezantoni organizatës tuaj?
7. Si do të vini në përdorim njohuritë e fituara gjatë kësaj jave? A keni ndonjë ide që ju erdhi gjatë kësaj jave? Na tregoni më shumë!
8. A jeni të kënaqur nga puna e ekipit organizator gjatë aktivitetit? A mendoni se ekipi organizues ofroi mbështetjen e duhur për nevojat e ndryshme të të mësuarit të pjesëmarrësve dhe punuan për të krijuar një mjedis për të shkëmbyer ide dhe për të mësuar që i përshtatet nevojave të të gjithëve? Si do ta

vlerësonit pjesëmarrjen tuaj në këtë aktivitet? A jeni i kënaqur me atë që keni mësuar dhe kontributin tuaj në përvojat e të nxëniet të të tjerëve?

9. Si do të reflektonit tani mbi frikërat dhe pritshmëritë që kishit në fillim të javës?

10. Si do ta vlerësonit dinamikën e grupit dhe atmosferën e përgjithshme në grup gjatë kësaj jave?

11. A jeni ndjerë i lirë të shprehni mendimin tuaj gjatë këtyre ditëve? A mendoni se personi përgjegjës i ndërgjegjësimit në skuadrën organizatore ndihmoi për të krijuar një hapësirë të sigurt për pjesëmarrësit? A keni sugjerime për të krijuar një mjedis më të sigurt?

12. A jeni të kënaqur me organizimin logjistik (hosteli, vaktet, dhe vendndodhja)? A mendoni se kishit mjaftueshëm informacion përpara mbërritjes tuaj për sa i përket teknikaliteteve?

13. Sa informacion kishit për punën e CDN përpara aktivitetit?

14. A mendoni se njiheni më mirë me CDN tani sesa përpara se të vini në këtë aktivitet?

15. Ndonjë gjë më shumë për të shtuar?

2. Mbyllje emocionale (loja me letra dixit): pjesëmarrësit ulen në një rreth dhe marrin një letër me thënie që reflektojnë ndjësitet dhe përvojat e tyre përgjatë projektit. **[20 minuta]**

## KUIZ- SA INTELIGJENT ËSHTË QYTETI JUAJ?

Duke lexuar për veçoritë inteligjente në qytete, të bën të mendosh për qytetin tënd, apo jo? Bëj këtë kuiz për të parë në cilën pikë qyteti juaj është dhe përdor përgjigjet për t'u frymëzuar për të vepruar dhe punuar kundrejt një realiteti urban më demokratik, të qëndrueshëm, dhe të barabartë.

\*

A – Po/Gjithnjë

B – Deri diku/Jo krejtësisht

C – Aspak

Nuk jeni të sigurt sesi t'i përgjigjeni disa pyetjeve? Kërko në internet, pyet miqtë e tu dhe/ose aktivistë të tjerë, e fillo diskutimin. Të jesh i vetëdijshëm mbi rrethanat e tua politike është hapi i parë për të ndryshuar qytetin tënd!

### Pyetjet:

1. Qyteti im bën të mundur që ka mjaftueshëm debat publik dhe qeverisje demokratike

A B C

2. Në qytetin tim teknologjia dhe risitë marrin parasysh dhe shkojnë krahas për krahas me vlerat e nevojat publike

A B C

3. Qyteti im mbron privatësinë dhe informacionin personal si dhe i jep qytetarëve kontroll mbi të dhënat e tyre

A B C

4. Qyteti im është i angazhuar për të luftuar ndarjen sociale dhe bën të mundur ndarjen e drejtë të të ardhurave, pasurisë dhe strehimit

A B C

5. Qyteti im nxit vendosjen e infrastrukturës digjitale në pronësi publike e cila u shërben ofruesve të shërbimeve, nismave të qytetarëve, dhe bashkësive urbane

A B C

6. Qyteti im përdor mjete politike për të përshpejtuar shpërndarjen e teknologjisë së gjelbër dhe bën të mundur që teknologjia të kontribuojë në qëndrueshmëri

A B C

7. Qyteti im ka për qëllim të tejkalojë ndarjen digjitale dhe të sigurojë një shërbim bazik digjital për njerëzit me aftësi digjitale të kufizuara

A B C

**A - 3 pikë**

**B - 2 pikë**

**C - 1 pikë**

**Rezultatet:****19-21 pikë**

Urime! Sipas rezultateve tuaja, qyteti juaj është një qytet inteligjent! Megjithatë, ka ende vend për përmirësim. Edhe kur duket sikur çdo gjë është mirë – duhet të jemi të vëmendshëm dhe të sigurojmë që qeveritë tona nuk po dalin nga udha e duhur.

**14-19 pikë**

Nuk është aq keq! Qyteti juaj ka disa karakteristika të zgjuara por mund të jetë duke dështuar për sa i përket “komponentit njerëzor”, Ndërkohë që është e rëndësishme që qytetarët të përfshihen në nivele të ndryshme të pjesëmarrjes, vendim-marrje dhe debat mes qyteteve, qeveritë ndonjëherë nuk i bëjnë proceset transparente dhe të lehta për t’u angazhuar. Kontrolllo çfarë po ndodh dhe ku duhen bërë ndryshime.

**7-14 pikë**

Epo mire. Bazuar në rezultatin tuaj, qyteti juaj nuk po ecën aq mirë.

Por, mos u dëshpëro! Ti nuk je vetëm, shumë janë duke e gjetur veten në një realitet të vështirë urban. Anëtarësohuni në një grup aktivistësh të Gjellbër (nëse nuk jeni pjesë e ndonjë) dhe mendoni së bashku për mundësitë për të vepruar kundër padrejtësive me të cilat përballeni si qytetarë! Shikoni këshillat e fushatës në këtë botim për frymëzim dhe fat të mirë!

**AUTORËT****Daria Smagina**

Daria Smagina është një antropologe dhe urbanist sociale nga Shën Petersburgu, Rusi. Ajo ka marrë pjesë për here të parë në aktivitetin e CDN në Stamboll në 2018, ku u ndje e frymëzuar nga aktivistët e gjellbër dhe e shtyrë për t’u regjistruar në aktivitetet e ardhshme të CDN kush-tuar temave të urbanizimit alternativ dhe çështjeve gjinore. Ajo u përfshi në mënyrë aktive në planifikimin dhe zbatimin e trajnimit rajonal të grupit të punës RUMB “Hapat Urbanë për të Ardhme të Qëndrueshme - ndërtimi i aktivizmit të rinisë në Europën Lindore” të mbajtur në Bjellorusi. Sot, Daria studion përtrashëgimi kulturore në Universitetin e Bolonjës, përkthen artikuj të GEF, shkruan shënime të zjarra për qytetet dhe zhvillon aftësitë e saj të ilustrimit.

**Liudmila Gavrilenko**

Liudmila Gavrilenko është përfshirë në aktivitetet e Grupit të Punës të Urbanizimit Alternativ të CDN që prej vitit 2016 pas sesionit të studimit “Riparo qytetin!”, ku ajo ishte pjesëmarrëse. Në vitin 2018, ajo u diplomua në universitetin shtetëror të arkitekturës dhe ndërtimit Novosibirsk me një diplomë Bachelor në Arkitekturë. Aktualisht, ajo punon në sektorin e arsimit në Kolumbi dhe në kohën e saj të lirë është një aktiviste e gjellbër. Pasionet e tjera të saj janë ecja malore, eksplorimi i natyrës dhe fotografia.

**Manjola Logli**

Manjola Logli është një arkitekthe nga Tirana, Shqipëria. Ajo e filloi angazhimin e saj me CDN në tetor 2020, si pjesë e trajnimit ndërkombëtar “Tejkalo paradigmat: Zbatimi i teknologjive të reja në qytete” në tetor 2018. Ajo është diplomuar në Departamentin e Arkitekturës të Universitetit Epoka në Shtator 2020 me rezultate të shkëlqyera në gradën master. Fushat e saj të interesit shtrihen në mjedisin dhe sjelljet e përdoruesit, mirëqenien e përdoruesit dhe ndërveprimin midis dizajnit dhe qëndrueshmërisë. Ajo beson në fuqinë e ndryshimit të sjellë prej arkitektëve, për të përmirësuar jetën e njerëzve duke krijuar udhëzime të ndryshme të dizajnit të qëndrueshëm dhe duke kontribuar për një botë ku arkitektura e gjellbër arrin një vend mbizotërues. Gjithashtu, ajo synon ë të zgjerojë vizionin e saj duke qënë pjesë e mjediseve të larmishme kulturore. Si një ish-studentë shkëmbimi ndërkombëtar ajo ka patur disa përvoja të shkëmbimit kulturor në SHBA. Manjollës i pëlqen të udhëtojë, lexojë, dhe të shohë bejsboll, ku ekipi i saj i preferuar i bejsbollit është *Minnesota Twins*.

## EKIPI ORGANIZATOR



**Erisa Nesimi**

Erisa është një entuziastë urbane nga Tirana, Shqipëria. Ajo filloi angazhimin e saj me CDN në 2018, si pjesë e Trajnimit "Hapat urbanë për një të ardhme rezistente" në Stamboll dhe vazhdoi si anëtare e grupit të punës së Urbanizimit Alternativ. Erisa ka studiuar Menaxhim dhe Zhvillim Urban në Universitetin Erasmus Rotterdam. Aktualisht, ajo po punon në fushën e Lëvizshmërisë së Qendrueshme Urbane në Tiranë. Në kohën e saj të lirë, Erisës i pëlqen të lexojë, të bëjë fjalëkryqe dhe të bëjë ecje malore. Ajo është gjithashtu një fanse filmash.



**Bianca Creutz**

Bianca ka studiuar shkenca shoqërore dhe punon në Berlin. Ajo është e interesuar në risitë urbane dhe sesi teknologjitë e reja mund të përdoren në dobi të qytetarëve. Bianca ka organizuar shumë projekte mbi aktivizimin rinor dhe qytetet, e lidhur me qëndrueshmërinë, teknologjinë, dhe pjesëmarrjen qytetare. Ajo është një anëtare e grupit të punës të Urbanizimit Alternativ. Bianca dashuron çiklizmin, pëlqen arkitekturën dhe artet.



**Justine Pantelejeva**

Justine është një planifikuese urbane nga Riga, Letoni e cila është e lumtur të quajë veten një "alterurbie"<sup>45</sup> që në 2016 kur iu bashkua grupit të punës së CDN Urbanizimi Alternativ. Kur Justine filloi si një aktiviste për të rinjtë në qytete, ajo përfundoi në anën tjetër, duke u zgjedhur rishtazi si anëtare e këshillit bashkiak të Rigës. Tani, ajo do i kthejë fjalët në vepra dhe do japë shembuj sesi mund ta bëjë qytetin më gjithëpërfshirës, të gjelbër dhe miqësor ndaj të rinjve.



**Luka Gudek**

Luka është një aktivist i gjelbër nga Kroacia, që jeton në Belgjikë. Ai ka filluar aktivizimin e tij në emisionin e Radios studentore 'A gaje su kitovi?' (Ku janë balenat?) në 2016, e vazhduar me CDN, duke punuar në fushën e urbanizimit alternativ dhe çzhvillimit. Që prej 2020 ai punon tek Federata e të rinjve të gjelbër europianë si asistent projekti. Sot, ai është i sapodiplomuar në Shkenca Politike, dhe ka për qëllim të sjellë idetë e gjelbra radikale në Europën Perëndimore dhe të zhvillojë politika të gjelbra mbi eksplorimin e hapësirës. Në kohën e tij të lirë, ai eksploron trillime të shkencave politike dhe historinë e eksplorimit të hapësirës së ishujve Kroate.



**Hanna Pishchyk**

Hanna jeton dhe studion në Minsk, Bjellorusi. Aktualisht është duke ndjekur studimet në Komunikim Ndërkulturor ndërkohë që po ndjek Universitetin Për Marrëdhënie me Publikun. Ajo është e interesuar për temat e edukimit global, edukimit digjital, dhe qeverisjen e internetit dhe është pjesë e disa nismave lokale e ndërkombëtare që trajtojnë këto çështje. Ajo u përfshi me CDN në 2019 kur mori pjesë seminarin "Interneti ashtu siç e duam" dhe më pas iu bashkua grupit të punës Digital [x].



**Elena Petrovska**

Elena është një entuziaste e re e Gjelbër, e bazuar në Beograd. Aktualisht, ajo po studion Shkenca Mjedisore dhe angazhimi i saj me të Gjelbrit filloi në 2018, kur ajo iu bashkua grupit lokal të aktivistëve- Të Rinjtë e Gjelbër Serbë. E përkushtuar për të ndihmuar në forcimin e lëvizjes së Gjelbër në gjithë mënyrat e mundshme, në fillim të 2020, Elena iu bashkua Komitetit Ekzekutiv të CDN dhe në vjeshtë ajo iu bashkua zyrës së CDN, si asistente projekti. Në kohën e saj të lirë, Elena shoqërohet me aktivistët e së Premtes për të ardhmen<sup>46</sup> me të cilët ajo eksploron ide për mundësitë e sjelljes së Ndryshimet Klimaterike nën vëmendjen e realitetit të tyre vendor.



**Masha Pashkova-Dzneladze**

Masha është koordinatore projekti e CDN. Ajo filloi angazhimin si aktiviste tek Të rinjtë e Gjelbër Gjerogjianë në 2012 dhe më pas ishte anëtare e Komitetit Ekzekutiv të CDN, përgjegjëse për grupin e punës të Urbanizimit Alternativ. Fushat e saj të interesit përfshijnë të drejtat digjitale, çështjet gjinore, klima, edukimi dhe anti-kapitalizmi. Mashës i pëlqen të lexojë letërsi trilluese dhe të vizatojë.



## LIDHU ME NE:

Fondacioni i Gjelbër European:



[www.gef.eu](http://www.gef.eu)



[GEF\\_Europe](#)



[GreenEuropeanFoundation](#)

Rrjeti për Bashkëpunim i Zhvillim i Europës Lindore:



[www.cdnee.org](http://www.cdnee.org)



[CDNEE](#)



[cdn\\_ee](#)



[cdnee](#)



[Cooperation Development Network Eastern Europe](#)